

RAPORT

i

VLERËSIMIT TË JASHTËM INSTITUCIONAL

DHE PROGRAMOR

TË UNIVERSITETIT EPOKA

Grupi i vlerësimit të Jashtëm:

Thoma Korini,	kryetar
Sotir Dhamo,	anëtar
Neritan Shkodrani,	anëtar
Aleksandër Xhuvani,	anëtar
Sulo Hadëri,	anëtar
Drini Salko,	anëtar
Mimoza Kasimati,	anëtare
Petrit Nathanaili,	anëtar

Mars 2011

Tabela e lëndës

Tabela e lëndës.....	2
I. Hyrje	4
II. Procesi dhe metodologjia	5
III. TE DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR INSTITUCIONIN	6
IV. MISIONI DHE QELLIMET E UNIVERSITETIT EPOKA.....	8
V. MENAXHIMI DHE QEVERISJA.	11
VI. GARANTIMI I CILËSISË.....	13
VII. STANDARDET AKADEMIKE	18
VIII. INFRASTRUKTURA E TË MËSUARIT.....	26
IX. BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE TREGUN E PUNËS.....	32
X. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	34
XI. ANEKSE	38

SHKURTIME

FAI	Fakulteti i i Arkitekturës dhe Inxhinierisë
FSEA	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
SWOT	(Strength, Weakness, Opportunities, Threats) Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Oportunitet dhe Kërcënimet)
KVAPC	Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë.
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
RVJ	Raporti i Vlerësimit të Jashtëm

I. Hyrje

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë për të bërë vlerësimin e jashtëm institucional dhe programor të Universitetit Epoka. Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit (statuti, rregullorja, etj), dosjet e programeve të studimit, tre regjistrat bazë të përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, etj. Po ashtu, GVJ pati mundësinë të bisedojë me rektorin, drejtuesit dhe anëtarët e trupave kolegjiale, stafin akademik, studentët, punonjësit e sekretarisë mësimore dhe kancelarin. Vizita u bënë në mjediset e universitetit, përfshirë bibliotekën, sallat e kompjuterëve dhe laboratorët .

Vlerësimi institucional u përqendrua në aspektet ligjore dhe strukturore të universitetit, në planet strategjike të zhvillimit të tij, në statutin, rregulloren, në ndarjen e përgjegjësi, në ngritjen e sistemeve të garantimit të cilësisë, në infrastrukturën mësimore, në shërbimet për studentët, në sistemet e menaxhimit të informacionit, komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore. Vlerësimi i programeve të studimit u fokusua në analizën e programeve të studimit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj.

Universiteti Epoka ka **dy fakultete**: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Ai ka gjithsej 514 studentë nga të cilët 356 në ciklin e parë të studimeve dhe 158 në ciklin e dytë të studimeve (të dhënat maj 2010).

Aktualisht ka 92 pedagogë (nga të cilët 64 pedagogë me kohë të plotë) dhe një staf administrativ prej 27 vetash. Universiteti ka në strukturën e vet edhe një numër Qendrash Kërkimore (kryesisht të integruara në fakultetet përkatëse) si:

- Qendra e Studimeve Europiane
- Qendra Kërkimore për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit
- Qendra për Kërkime dhe Aplikime
- Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë
- Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës.

Universiteti Epoka me strukturat dhe infrastrukturën mësimore siguron një lidhje shumë të mirë midis mësimdhënies dhe kërkimit, çka është edhe një ndër kërkesat bazë që duhet të përmbushin institucionet që ofrojnë programe mësimore të të dy cikleve e që synojnë të angazhohen edhe në ciklin e tretë.

Bazuar në problematikën e analizuar dhe në *“Udhëzuesin për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë”* publikuar nga Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), shtator 2005; dhe në *“Standarde*

dhe Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë”, Shoqata Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), miratuar në shkurt 2005 në Mbledhjen e Ministrave të Arsimit në Bergen, Norvegji, GVJ e ka strukturuar raportin e tij të vlerësimit të jashtëm në katër aspekte kryesore të cilat janë:

(1) garantimi i cilësisë, (2) standardet akademike, (3) infrastruktura e të mësuarit, dhe (4) bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun dhe tregun e punës.

Këto katër aspekte paraprihen nga një shpjegim i metodologjisë së ndjekur si dhe nga parashtrimi i kontekstit institucional, ndërsa pasohen nga Konkluzionet dhe Rekomandimet e GVJ.

II. Procesi dhe metodologjia

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte **Raporti i Vlerësimit të Brendshëm**, i hartuar në Maj 2010 nga vetë institucioni. Ky raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Epoka për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti, po ashtu, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër dokumentesh shtesë si dhe u administruan *Rezultatet e Pyetësorëve* të studentëve. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga *Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 15, datë 4.4.2008 “Për organizmin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, Udhëzimi Nr. 30, datë 26.09.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti juridik për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve si dhe programeve të studimeve “Master i Nivelit të Dytë”*. Të gjitha këto materiale u vunë në dispozicion nga APAAL në mbledhjen e konstituimit të grupit.

Në takimin e parë të tij pasi ishte njohur në mënyrë individuale me këto materiale, ekipi diskutoi gjerësisht mbi *Raportin e Vlerësimit të Brendshëm* dhe, i ndihmuar nga stafi i APAAL, hartoi një program takimesh që do të realizoheshin gjatë vizitave në Universitetin Epoka.

GVJ e vizitoi Universitetin në mënyrë të organizuar në datat 9-23 dhjetor 2010. Secili prej anëtarëve të grupit ka pasur mundësinë të vizitojë njësitë e ndryshme të universitetit edhe në mënyrë individuale.

GVJ zhvilloi diskutime me rektorin, dekanët, stafin akademik të departamenteve si dhe me pedagogë të veçantë. GVJ u ndal në detaje të funksionit të sekretarisë mësimore të Universitetit si dhe kontaktoi me kancelarin, me të cilin u ndal në detaje të administrimit të jetës së universitetit. Ekipi vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh dhe u administrua një pyetësor (sipas modelit të APAAL). Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura

dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

III. TE DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR INSTITUCIONIN

Universiteti ka filluar procesin mësimor në vitin 2007 me dy fakultete: Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative.

Edhe pse Universiteti Epoka është bazuar në sistemin amerikan të arsimit të lartë, ai ka adoptuar në të njëjtën kohë edhe kreditet ECTS, të cilat përbëjnë një element kyç në procesin e Bolonjës. Gjithashtu, arsimi në gjuhën angleze në Universitetin Epoka lehtëson lëvizjen e studentëve të universitetit në kuadër të EHEA-së, si dhe atë të studentëve të huaj drejt Universitetit Epoka.

Programet e studimit të ofruara nga Universiteti Epoka janë:

Programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë:

- Arkitekturë (4 vite akademike);
- Inxhinieri Ndërtimi (4 vite akademike);
- Inxhinieri kompjuterike (4 vite akademike);
- Ekonomiks (4 vite akademike);
- Finance-Banke (4 vite akademike);
- Administrim Biznesi (4 vite akademike);
- Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (4 vite akademike).

Programet e Studimit të ciklit të dytë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet Diplomë e Nivelit të Dytë:

- DND në Arkitekturë (2 vite akademike);
- DND në Inxhinieri Ndërtimi: Profili Inxhinieri e Strukturave (2 vite akademike)
- DND në Inxhinieri Ndërtimi: Profili Menaxhimi i Ndërtimeve (2 vite akademike)
- DND në Inxhinieri Kompjuterike (2 vite akademike)
- DND në Finance dhe Bankë (2 vite akademike)
- DND në Administrim Biznesi (2 vite akademike)
- DND në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (2 vite akademike)

Programet e Studimit të ciklit të tretë në formën e studimeve me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master i Nivelit të Dytë (MND):

- MND në Arkitekturë (1 vit akademik)
- MND në Inxhinieri Ndërtimi (1 vit akademik)
- MND në Inxhinieri Kompjuterike (1 vit akademik)

- MND në Financë dhe Bankë (1 vit akademik)
- MND në Administrim Biznesi (1.5 vite akademike)
- MND në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (1 vit akademik)
- MND në Studime Europiane (1 vit akademik)

Gjithashtu, Universiteti Epoka ofron forma të kualifikimit të vazhdueshëm nëpërmjet trajnimeve me certifikatë.

Programet e studimeve në Universitetin Epoka janë duke u pershtatur me *Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 9741, datë 21.05.2007 i ndryshuar*, i cili përcakton programet e studimeve “Master i shkencave” dhe “Master profesional” si programe studimi të ciklit të dytë.



Strukturat, studentët dhe stafi:

Struktura akademike e Epoka përbëhet nga:

1. **Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAI)**

1. Departamenti i Arkitekturës
2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike

2. **Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSEA)**

1. Departamenti i Ekonomiksit
2. Departamenti i Administrim Biznesit
3. Departamenti i Financë Bankës

4. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

3. Qendrat Kërkimore

1. Qendra e Studimeve Europiane
2. Qendra Kërkimore për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit
3. Qendra për Kërkime dhe Aplikime
4. Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë
5. Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës.

Çdo fakultet ka **3 deri në 4 njësi bazë** (departamente) nga 3 të kërkuara minimalisht nga ligji. Në shërbim të tyre janë edhe Qendrat Kërkimore të cilat garantojnë mësimdhënien nëpërmjet kërkimit shkencor dhe shërbejnë për të nxitur pjesëmarrjen në kërkim shkencor si të stafit akademik të Universitetit Epoka ashtu edhe të studentëve.

Në vitin akademik 2009-2010, numri i stafit me kohë të plotë ishte 64 dhe me kohë të pjesshme 28. Pra përqindja e stafit akademik me kohë të plotë është 69.6%, ndërsa e atij me kohë të pjesshme 30.4%. Nga totali prej 92 i stafit akademik të Universitetit Epoka, 48 (52.2%) zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor”, ndërkohë që 44 anëtarë të stafit akademik (47.8%) nuk e kanë këtë gradë, por shumica prej tyre ka përfunduar studimet Master. Kjo masë garanton edhe përmbushjen e standarteve që lidhen me kualifikimin shkencor-akademik të stafit.

Numri i personelit administrativ dhe ndihmës është 27 punonjës të cilët qëndrojnë në raport 1:3.4 me stafin akademik. Numri total i studentëve në të dy Fakultetet është 514 dhe raporti me stafin akademik është 5.6:1. Kurse raporti i studentëve me stafin administrativ është 19:1 (RVB).

IV. MISIONI DHE QELLIMET E UNIVERSITETIT EPOKA

Nga shqyrtimi i dokumentacionit themelor të Universiteti Epoka, del e qartë se **strategjia** e tij është përqendruar në tre drejtime kryesore: mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe kontributi për shoqërinë.

Misioni i Universitetit Epoka është transformimi në një institucion mësimor-kërkimor me influencë e inovativ, në shërbim të vlerave humane thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe kontributit me njohuri në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore.

Objektivat e Universitetit Epoka e tij janë përqendruar kryesisht në këto drejtime:

- Të krijojë, të transmetojë dhe të zhvillojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor me qëllim zhvillimin e shoqërisë,
- Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në të gjitha nivelet e studimit;
- Të ndihmojë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe madje pretendohet në nivel botëror;

- Të ofrojë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë;
- Të kontribuojë në rritjen e standardeve demokratike të shoqërisë dhe me përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë;
- Të kryejë studime dhe thellime në fusha të veçanta;
- Të ofrojë specializim dhe kualifikim të mjaftueshëm.

Duke themeluar një sistem të menaxhimit të njohurive, në përputhje me parimet e njohura universale, Universiteti Epoka së bashku me stafin akademik dhe ndihmës ka një strukturë dinamike organizative.

Vlerat themelore të Universitetit Epoka konsistojnë në:

- Besimin në universalitetin e arsimit dhe kërkimit shkencor
- Respektimin e normave dhe rregullave ligjorë universale
- Dhënia prioritet identitetit institucional
- Adoptimi i një administrimi gjithpërfshirës, transparent;
- Komunikimi interaktiv me komunitetin, transformimi në pioner dhe model të mësimdhënies dhe kërkimit në nivel lokal e ndërkombëtar;
- Shdërrimin në një institucion të fokusuar mbi studentin;
- Të qenit i hapur ndaj të resë;
- Të qenit në kërkim të ekselencës;
- Drejtimi i punimeve kërkimore origjinale.

Universiteti Epoka është një universitet dinamik, me një rritje të qëndrueshme në pajtim me politikat në vijim:

- Politika e promovimit;
- Politika e Arsimit dhe trajnimit
- Politika e kërkimit shkencor;
- Politika e burimeve njerëzore;
- Politika e Mjedisit;
- Politika e kontributit social.

Qellimet strategjike të Universitetit Epoka janë konceptuar duke u mbështetur në individualitetin institucional të universitetit si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2008-2013 të Republikës së Shqipërisë, strategjitë e përcaktuara nga Fondacioni Europian mbi Menaxhimin e Cilësisë si dhe strategjitë e miratuara nga Bordi i Vlerësimit të Arsimit të Lartë pjesë e Këshillit të Arsimit të Lartë të Republikës së Turqisë dhe mund të përmbliken në sa vijon:

- Të sigurojë përshtatshmërinë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore esenciale në realizimin e misionit, strategjive dhe objektivave;

- Të jetë një universitet i përshtatshëm dhe efektiv gjatë realizimit të misionit, strategjive dhe objektivave sipas mundësive dhe burimeve dhe në marrëdhënie me personat e interesuar dhe kualifikimin e stafit dhe të studentëve;
- Të jetë një universitet efektiv dhe i menaxhueshëm, me një numër të përshtatshëm të studentëve dhe punonjësve, me zonat përkatëse të shërbimit;
- Të jetë një universitet në rritje me cilësi të lartë, i preferuar në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të jetë një universitet pioner në dhënien dhe përmirësimin e shërbimit arsimor nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe mësimdhënies së mbështetur në internet;
- Të jetë një universitet ku zhvillohen aktivitete kërkimore dhe zhvillimore dhe prodhohen, shpërndahen dhe ndahen njohuri me natyrë universale;
- Të jetë një universitet me një rol aktiv në zhvillimin shoqëror, kulturor dhe ekonomik, si dhe në shpërndarjen e njohurive në rajon;
- Përdorimi efektiv i shërbimeve administrative dhe mbështetëse me qëllim arritjen e objektivave strategjike;
- Të krijojë një kulturë të menaxhimit të qëndrueshëm të strategjive dhe proceseve, të cilët kanë përdorim transparent dhe eficient të burimeve;
- Të jetë një universitet i cili mbështet zhvillimin e karakteristikave personale, lidhshimit dhe kulturës së menaxhimit dhe që i jep prioritet kënaqësisë së studenteve dhe punonjësve;
- Të jetë një universitet që përdor me efektivitet dhe efikasitet cilësinë dhe karakteristikat institucionale, monitoron aktivitetet dhe rezultatet e tyre me përmirësim dhe zhvillim të vazhdueshëm;
- Të jetë një universitet që plotëson misionin e arsimit të lartë në dimensionin e tij universal kombëtar e rajonal.

Konteksti i themelimit të Universitetit Epoka, referencat brenda dhe jashtë vendit. Universiteti Epoka është i organizuar dhe operon si një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë. Universiteti Epoka është themeluar mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.281, datë 12.03.2008 “Për Liçensimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Privat Epoka”, si dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave Nr.908, datë 26.08.2009 si dhe Nr.90..., datë 10.02.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimit në Institucionin Privat të Arsimit të Lartë Epoka”. Universiteti drejtohet nga Shoqëria “Turgut Ozal”, e cila ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Tiranës.

Universitetit , më 16 janar 2010, iu akordua çertifikata ISO 9001-2008 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë për shërbimet e ofruara në nivelin e studimeve universitare dhe pasuniversitare, ndërsa vijon procesi i çertifikimit ISO 14001-2004 mbi Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe OHSAS 18001 mbi Sistemet e Sigurisë në Punë dhe të Shëndetit.

Universiteti Epoka është bazuar në sistemin amerikan të arsimit të lartë, ndërsa procesi mësimor zhvillohet në gjuhën angleze.

Universiteti Epoka ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshesh me universitete në Shqipëri, Ballkan Europë dhe SHBA.

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Gjatë vizitave në Universitetin Epoka, GVJ mësoi se RVB ishte rezultat i një procesi bashkëpunues. Nga diskutimet me anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm, GVJ mësoi se vlerësimi kishte qenë një proces sa transparent, aq dhe bashkëpunues. Vërehet se ky proces bashkëpunimi pasqyron mënyrën e hapur dhe konsultative të punës në këtë institucion, në përgjithësi. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është një paraqitje e plotë dhe e korekte e strategjisë dhe mënyrës së funksionimit të Universitetit Epoka. Raporti është një dokument i organizuar shumë mirë dhe shumë i dobishëm falë një balancimi të matur dhe të kujdesshëm midis përshkrimeve, argumentimeve, të dhënave tabelore të shumta, gjykimeve e vlerësimeve si dhe një shkalle të lartë hapejeje dhe transparence. Bazuar në gjetjet faktike dhe verifikimin e të dhënave gjatë vizitës në Universitet, GVJ arrin në përfundimin se Universiteti Epoka ka ngritur një bazë shumë të mirë të dhënash që do t'i shërbejë për të hartuar treguesit e saktë të monitorimit të progresit nga njëri vlerësim tek tjetri, i brendshëm apo i jashtëm qoftë. GVJ dëshiron të verë në dukje se gjykimet dhe vlerësimet e GVB i shërbyen si një bazë shumë e mirë për diskutimet me strukturat dhe stafin e Universitetit.

V. MENAXHIMI DHE QEVERISJA.

Organet vendimmarrëse

Njësitë qeverisëse të Universitetit Epoka janë: Këshilli i Lartë, Senati, Këshilli i Administrimit të Universitetit, Këshilli i Etikës si dhe Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë.

Këshilli i Lartë është njësi vendimmarrëse kolegjiale më e lartë e Universitetit, i cili ka një autoritet ligjor. Këshilli i Lartë mbikqyr dhe kontrollon aktivitetet të cilat janë të lidhura me administratën, financën, ekonominë dhe veçoritë menaxhuese të Universitetit Epoka.

Senati është një njësi vendimmarrëse kolegjiale e Universitetit Epoka. Ai përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, planet e programet mësimore, koordinon, drejton dhe kontrollon aktivitetet e mësimdhënies dhe ato kërkimore, vlerëson efektivitetin e tyre dhe vendos mbi probleme të rëndësishme arsimore dhe kërkimore të institucionit.

Këshilli Administrativ i Universitetit është një njësi vendimmarjeje kolegjiale, i cili përbëhet nga Rektori, Zv.Rektori, dekanët e fakulteteve dhe tre anëtarë të stafit akademik të zgjedhur nga Senati. Funkcionet e tij kanë të bëjnë me një sërë problemesh të menaxhimit kryesisht në aspektet ekonomike të Institucionit.

Këshilli i Etikës, i cili diskuton mbi problemet etike të jetës së studimeve të larta dhe bën propozime tek Rektori për këto çështje. Këshilli i etikës ekzaminon dhe merr vendime mbi çështje të stafit administrativ, akademik dhe studentëve në lidhje me etikën.

Autoritetet menaxhuese të Universitetit:

Rektori, Zv.Rektorët, Dekanet e fakulteteve si dhe Kancelari i Universitetit.

Struktura akademike e Universitetit Epoka përbëhet nga **tre njësi kryesore**:

- 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierise (FAI)**
- 2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (FSEA)**
- 3. Qendrat Kërkimore**

Fakultetet, si njësi kryesore të Universitetit Epoka, koordinojnë zhvillimet arsimore, kërkimore dhe kulturore në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit duke ofruar programe universitare të llojeve dhe niveleve të ndryshme në fund të të cilave përftohet një diplomë. **Dekani**, si autoritet drejtues kryesor i një fakulteti, i cili drejton dhe kontrollon gjithë punën mësimore dhe shkencore, emërohet me propozim të Rektorit dhe miratim të Këshillit të Lartë me të drejtë riemërimi. Si organe drejtuese dhe administrative të fakulteteve të Universitetit Epoka janë **Këshilli i Fakultetit**, i cili përfaqëson një organ kolegjal vendimmarrës që përcakton veprimtarinë e planifikuar të mësimdhënies dhe fushës kërkimore të fakultetit në bazë të propozimeve të departamenteve dhe Këshilli Administrativ i Fakultetit, i cili, si organ kolegjal vendimmarrës përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit.

Fakultetet përbëhen nga **departamentet**, si njësi bazë mësimore shkencore që përfshin fusha kërkimi dhe grupe të mësimdhënies homogjene në disiplinat përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Hapja, shkrirja ose mbyllja e departamenteve në Universitetin Epoka bëhet me propozim të Senatit dhe me miratimin e Këshillit të Lartë. Autoriteti më i lartë drejtues i departamentit është Përgjegjësi i Departamentit, i cili përzgjidhet nga Dekani mes anëtarëve të brendshëm të stafit akademik të departamentit, miratohet nga Rektori dhe emërohet me vendim të Këshillit të Lartë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje. Përgjegjësi i Departamentit është përgjegjës për veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në çdo nivel të departamentit dhe për drejtimin e rregullt dhe efikas të çdo aktiviteti brenda tij.

Në strukturën e fakulteteve bëjnë pjesë edhe **Qendrat Kërkimore Zhvillimore** të cilat kryejnë veprimtari shkencore dhe mësimore duke u angazhuar kryesisht në aktivitetet mësimore dhe shkencore të lidhuara me ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. **Qendrat Kërkimore Zhvillimore** të universitetit Epoka konsistojnë në 5 njësi: (i) Qendra e Studimeve Europiane, (ii) Qendra Kërkimore për Termetet dhe

Teknologjitë e Ndertimit, (iii) Qendra për Kërkime dhe Aplikime, (iv) Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë dhe (v) Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës.

Edhe drejtuesi i Qendrës Kërkimore Zhvillimore përzgjidhet nga personeli i brendshëm i Fakultetit dhe caktohet me propozin të Rektorit dhe miratimin e Këshillit të Lartë për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Drejtuesit e departamenteve dhe të qendrave kërkimore zhvillimore janë pedagogë me grada shkencore (minimumi i konstatuar është grada Doktor). Trupa pedagogjike dominohet nga pedagogë me grada e tituj (55% e pedagogëve me kohë të plotë kanë minimumi gradën Doktor). Po ashtu, pedagogët e ftuar, në shumicën e tyre janë me tituj e grada shkencore. Pjesa dërmuese e stafit akademik të Universitetit Epoka janë të huaj, me kualifikim të lartë dhe me një përvojë të gjatë akademike.

Funksionimi i gjithë strukturave të Universitetit Epoka si dhe raportet ndërmjet njësive përbërëse përcaktohen në rregulloret përkatëse.

VI. GARANTIMI I CILËSISË

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë

Një element i rëndësishëm në drejtim të garantimit të cilësisë është funksionimi i **Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë**. Ky këshill, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga të paktën një Zv/Rektor, dekanet e fakulteteve, kancelari, përgjegjësi i sekretarisë mësimore, një ekspert i huaj dhe një përfaqësues nga organizma studentore, ka përgjegjësi për të siguruar cilësinë e brendshme të Universitetit Epoka.

Funksionimi i këtij këshilli bëhet mbështetur në direktivën *“Mbi Vlerësimin Akademik dhe Përmirësimin e Cilësisë në Universitetin Epoka”* miratur nga Senati dhe Këshilli i Lartë. Qëllimi i kësaj direktive ka qenë përcaktimi i parimeve mbi vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit, hulumtimit dhe çdo shërbim tjetër të ofruar nga Universiteti, krijimi, zbatimi, zhvillimi dhe vlerësimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në kuadër të institucionit.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë e KVAPC janë si më poshtë:

- Koordinimi i procesit të planifikimit strategjik të Universitetit, kryerja e çdo aktiviteti të lidhur me vlerësimin, përmirësimin e cilësisë dhe çertifikimin e cilësisë së nivelit të shërbimeve akademike dhe administrative në kontekstin e planit strategjik dhe objektivave të Universitetit, si dhe të bëjë publike rezultatet e këtyre veprimtarive;
- Kryerjen e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe në këtë kontekst, përgatitja e raportit të vetëvlerësimit (vlerësimi i brendshëm) apo sigurimin që ky raport është përgatitur nga njësitet e tjera;

- Në rast të kontraktimit të një organi/agjencie për të kryer procesin e vlerësimit të jashtëm, të bëjë përgatitjet e nevojshme dhe të japë çdo mbështetje të nevojshme për vlerësimin e jashtëm;
- Ndarja në njësi të tjera akademike, çdo përmirësim cilësie të çdo aktiviteti që konsiderohet si një shembull i frytshëm;
- Koordinimi i themelimit të standardeve të kontrollit të brendshëm të Universitetit në përputhje me parimet e përcaktuara në aktet ligjore, përgatitja e Planit të Veprimit për Kontroll të Brendshëm dhe në qoftë se gjykohet e nevojshme, përcaktimi i standardeve të reja në Universitet;
- Përcaktimi i misionit, vizionit dhe gjendjes aktuale të Universitetit, përcaktimi afatshkurtër, afatmesëm dhe objektivat strategjike afatgjata;
- Përcaktimi i situatës dhe treguesve të zonave strategjike dhe temave;
- Përgatitja e programeve strategjike që rrjedhin nga projektet dhe aktivitetet tjera;
- Përcaktimi i objektivave dhe strategjive të Universitetit;
- Sigurimi i orientimit të aktiviteteve dhe veprimeve që rrjedhin nga plani strategjik i Universitetit;
- Zhvillimi i monitorimit të rregullt të cilësisë dhe aktivitetet e përmirësimit të Universitetit;
- Përgatitja e sugjerimeve në lidhje me miratimin e treguesve të rinj themelore dhe të përbashkët si dhe matja e ekzekutimit që konsiderohen si të nevojshme në lidhje me përmirësimin e cilësisë dhe të aktiviteteve të planifikimit strategjik në njësitë akademike dhe administrative.

Sipas RVB, në kuadrin e krijimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitet, duke filluar nga semestri i vjeshtës së vitit akademik 2008-2009, e gjithë puna e stafit akademik është vlerësuar nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si dhe kënaqësinë e përgjithshme të studentëve përsa i përket çdo lënde të dhënë nga pedagogu përkatës. Studentët mund të shprehin kënaqësinë ose pakënaqësinë e tyre në lidhje me kategoritë përkatëse duke ruajtur konfidencialitetin e plotë. Përgjigjet e marra nga studentët janë analizuar dhe janë marrë gjithashtu edhe rezultatet përkatëse. Rezultatet e performancës janë shpërndarë nga Rektori për instruktorët në fjalë, si dhe për krerët e departamenteve përkatëse. Fshtësia e këtij informacioni është e mbrojtur në të gjitha fazat e nxjerrjes së rezultateve, shpërndarja e korrespondencës në njësitë në fjalë, personat, si dhe në arkivimin e korrespondencës. Rezultatet e anketave të vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës sigurojnë të dhëna sasiore të rëndësishme që janë marrë në konsideratë në lidhje me rinovimin e kontratave me stafin akademik, si dhe në caktimin e këtij personeli në lëndët përkatëse.

Planet dhe programet mësimore.

Universiteti Epoka është i ndërtuar në bazë të sistemit amerikan dhe kohëzgjatja normale e studimeve është 4 vjet me kohë të plotë.

Ngarkesa mësimore në këto katër vite më e pakta është 140 kredi ose 240 ECTS për çdo program studimi të nivelit të parë. Stafi i huaj dhe ai shqiptar është totalisht i dedikuar për mirëfunksionimin e programeve

të studimit, gjithashtu ata janë të kualifikuar me përvoja të ndryshme në shumë institucione të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.

Universiteti EPOKA që në fillim i ka përgatitur kurrikulat sipas sistemit mësimor amerikan dhe përshtatur me sistemin mësimor evropian. Përgatitja e kurrikulave është bërë me konsultimin dhe kontributin e stafit si me kohë të plotë, dhe atij me kohë të pjesshme, bazuar në përvojat e tyre të mëparshme.

Programet e studimit, të miratuara dhe në proces zbatimi, u përgjigjen kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (posaçërisht neneve 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të këtij ligji), si dhe kërkesave të Udhëzimit të MASH Nr.15 datë 04.04.2008 (posaçërisht krerëve VII, VIII dhe IX të tij). Gjithashtu, gjykojmë se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e nderkombëtare. Sikurse përcaktohet edhe në statut, programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme, dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat bashkëpunohet.

Plani Mësimor në Universitetin Epoka përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, ku parashtrohet në mënyrë të sintetizuar emërtimi i programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve; tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave; kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas aktiviteteve formuese të saj; karakteristikat e tezës së diplomës. Plani mësimor është objekt rishikimi dhe vlerësimi periodik.

Në dosjen e plotë të programeve të studimeve të ciklit të parë të Universitetit Epoka, pas një hyrjeje ku jepet informacion i përmbledhur për programin dhe planin mësimor dhe parimet mbi të cilat ata janë ndërtuar, për vitet e studimit, kreditet, karakteristikat e diplomës, etj., parashtrohen qëllimi dhe objektivat kryesore të programit. Më tej, bazuar në kërkesat e akteve normative por edhe në “përshkruesit e Dublinit”¹ që dallojnë nivelin e njohurive dhe aftësive që duhet të zotërojnë studentët në përfundim të cikleve përkatëse të studimit, analizohen rezultatet e pritura nga studentët. Në këtë kuadër shtjellohen, në mënyrë të shkallëzuar, parashikimet për njohuritë e fituara, për aftësitë e përgjithshme për të vepruar, aftësitë për të vepruar në fusha të veçanta, për aftësitë për punë kërkimore-shkencore, dhe aftësitë për të komunikuar. Për secilin prej këtyre shkallëve të njohurive dhe aftësive të fituara, përshkruhen metodat dhe instrumentet kryesore që do të përdoren, si dhe elementët kryesorë të procesit të vlerësimit. *GVI është i mendimit se shtjellimi i kujdesshëm që i është bërë këtij dimensionit në gjithë programet e studimit,*

¹ Në kuadër të reformimit të arsimit të lartë në hapësirën evropiane bazuar në marrëveshjen e Bolonjës, janë përcaktuar edhe “Përshkruesit e Dublinit” (“Dublin’ descriptors”), ku përshkruhen kërkesat për njohuritë dhe aftësitë që duhet të zotërohen në përfundim të secilit cikël të studimit në kuadër të arsimit të lartë.

përfaqëson në vetvete një përvojë pozitive të njësisë, që mund t'u shërbejë edhe njësive të tjera të arsimit të lartë, publike apo private.

Më tej, në dokument përshkruhen struktura dhe kushtet e programit studimor, nivelet, modulet, kreditet. Kohëzgjatja e studimit është 4 vjet, e ndarë në 8 semestra, me nga 15 javë secili. Në çdo semestër ofrohen një numer lëndësh, të cilat mund të jenë lëndë të detyrueshme, apo me zgjedhje, sikurse përcaktohen në planin mësimor. Për çdo lëndë janë përcaktuar kreditet e fituara (bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, në kërkesat e modelet e paraqitura në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008, dhe duke reflektuar kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës), duke respektuar raportin: 1 kredit = 25 deri 30 orë ngarkese mësimore, ku përfshihen orët në auditor dhe jashtë tij. Në çdo vit fitohen 60 kredite, duke nënkuptuar 1500-1800 orë ngarkese mësimore brenda dhe jashtë shkollës. Për të katër vitet e studimit, studenti duhet të fitojë 240 kredite. Në përfundim të lëndëve të parashikuara në planin mësimor, studentët duhet të mbrojnë tezën e diplomës, të përgatitur përgjatë semestrit të fundit (të tetë) të studimeve.

Ndër të tjera, në këtë pjesë të dokumentit të programit të studimit nënvizohet detyrimi i pjesëmarrjes së studentëve në leksione dhe seminare, deri në masën 75% të totalit të orëve në auditor, që të lejohet futja e tyre në provimin përfundimtar të çdo lëndë.

Programi vazhdon më tej me parashtrimin e planit mësimor, duke paraqitur lëndët sipas semestrave dhe duke dhënë për çdo lëndë orët totale, ndarë në leksione dhe seminare, kreditet përkatëse, dhe orët javore. Gruplëndët e ofruara gjykojmë se janë në përputhje me qëllimin, objektivat dhe njohuritë e aftësitë që kërkohen të fitojë studenti. Edhe renditja e tyre sipas semestrave e viteve të studimit gjykojmë se ndihmon në komplementimin dhe konsolidimin e njohurive dhe aftësive të fituara. Alokimi i krediteve dhe ndarja e lëndëve në semestra është bërë duke mbajtur parasysh klasifikimin e tyre në lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakteristike të programit, lëndë formuese të ngjashme ose integruese me ato të programit, lëndë opsionale, lëndë që përfshihen në grupin gjuhë të huaja, informatikë, praktika mësimore, etj. Nga informacioni i marrë nga njësia dhe llogaritjet e bëra, del se përndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve u përgjigjet kërkesave të Udhëzimit të MASH, Nr. 15, datë 04.04.2008 "*Për organizimin e studimeve në insitucionet publike të arsimit të lartë*" (Kreu VII, pikat 4 dhe 5, dhe shtojca 1). Lëndët karakteristike të programit kapin rreth 50% të totalit të krediteve, pasuar nga lëndët e formimit të përgjithshëm, lëndët formuese të ngjashme, e kështu me radhe. Vështruar sipas viteve të studimit, del se lëndët e formimit të përgjithshëm shtrihen kryesisht në vitin e parë dhe në vitin e dytë. Lëndët karakteristike të programit përkatës janë shpërndarë në të tre vitet e para të studimit, por në pjesën më të madhe në vitin e tretë dhe sidomos të katërt.

Programet e lëndëve: Çdo lëndë e programit të studimit zhvillohet në përputhje me programin e vet mësimor. Edhe në hartimin e programeve të lëndëve, duket që është bërë një punë e kujdesshme nga ana e njësive: ato janë të plota, u përgjigjen kërkesave të rregulloreve përkatëse, janë të qarta dhe orientuese

për studentët. Programet e lëndëve janë të formalizuar sipas një strukture standarde. Në faqen e parë jepet emërtimi i lëndës, viti akademik dhe semestri, orari kur zhvillohet lënda, orari i konsultimeve, emri i lektorit dhe i drejtuesit të seminarit, dhe adresa e institucionit. Më pas përshkruhen objektivi dhe misioni i lëndës, pasuar me përshkrimin e formave kryesore të mësimdhënies (leksione, seminare, etj.). Vend i veçantë u kushtohet objektivave specifike të lëndës dhe përfitimeve të pritshme të studentit. Përshkruhet ngarkesa mësimore e lëndës, ndarë në leksione dhe seminare dhe metodologjia e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, dhe paraqitet literatura e detyrueshme dhe e këshillueshme.

Programi vazhdon me paraqitjen e planit të leksioneve, ndarë me tema dhe çështje sipas çdo jave. Në plan parashikohet edhe koha kur do të mbahen provimet e pjesshme dhe provimi përfundimtar. *Mendojmë se programi duhet të japë më të detajuar edhe planin e seminareve, ndërtuar përsëri sipas temave dhe çështjeve përkatëse të parashikuara për çdo javë, përfshirë edhe provimet e pjesshme apo detyrimet e tjera të studentëve.*

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë - përmbledhje

Sipas raportit të vetëvlerësimit, në Universitetin Epoka sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij.

Nga ana e vlerësueses u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.

- Në mënyrë institucionale janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të kandidateve për t'u përfshirë në personel akademik.
- Në periudhën 2007-2010 asistenca për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zëra me rritje të qëndrueshme në buxhetin e institucionit.
- Universiteti Epoka ka vendosur kriteret për kontrollin e hyrjeve në universitet dhe ka të specifikuar kriteret në lidhje me cilësinë e notës. Gjithashtu ka përcaktuar kriteret të qarta cilësore për vazhdimin e mardhënies së studentit me institucionin deri në marrjen e diplomës përkatëse.
- Në fakultete është i institucionalizuar procesi i marrjes së feedback-ut nga studenti. Duke filluar nga viti shkollor 2008-2009 organizohen për çdo semestër pyetsorë për lëndët dhe mënyrën e shpjegimit. Rezultatet e tyre të përpunuara kanë një mënyrë të përcaktuar trajtimi, me qëllim informimin e palëve për kontroll dhe përmirësim. Ky feedback shërben dhe për vendimmarrje në lidhje me vazhdimësinë e mardhënies së pedagogut me institucionin.

Në rregulloren e studimeve një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve. Forma e vlerësimit të dijeve të studentëve për çdo lëndë është e përcaktuar në syllabuset e programit të studimit, ku në një masë të konsiderueshme të vlerësimit përfundimtar (pothuajse 50%) e zë vlerësimi që merr studenti për elementët e lëndës përkatëse si dhe vlerësimet e marra në kontrollet e ndërmjetme. Në arkivën e departamenteve ruhen për një kohë të përcaktuar të gjitha kontrollet e kryera të studentit,

procesverbalet e mbajtura nga ana e pedagogëve në lidhje me vlerësimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të studentit duke siguruar një gjurmueshmëri të qëndrueshme në të gjitha hallkat e mekanizmit të vlerësimit të ngritur, për të eliminuar çdo lloj inflacioni institucional të notës.

Së fundi, GVJ dëshiron të vërë në dukje se nga bisedat me drejtuesit e departamenteve, fakulteteve dhe me stafin akademik në tërësi, u evidentua vetë-dijësimi institucional për nevojën e përpunimit të vazhduar të proceseve të garantimit të cilësisë. Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive të institucionit ndaj menaxhimit të cilësisë tani e në të ardhmen.

VII. STANDARDET AKADEMIKE

Nga raporti i vlerësimit të brendshëm bëhet e qartë se Universiteti Epoka synon në arritjen dhe mbajtjen e standarteve të larta akademike në përputhje me misionin e Universitetit. Elementë kyç të këtyre parimeve përfshijnë qartësinë dhe saktësinë e përcaktimit dhe komunikimit të standardeve akademike të Universitetit Epoka, nëpërmjet proceseve të tilla si politikat e pranimit të studenteve, përcaktimi i kërkesave të qarta për rekrutimin e stafit akademik, për mbështetjen e tij me programe kualifikuese, përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies, proceset gjithëvjetoje dhe shumëplanëshe të vlerësimit të balancuar, sistemeve të administrimit të dokumenteve, etj.

Standardet e programeve.

Programet e studimit janë riorganizuar sipas tipeve të veprimtarive:

- Veprimtari formuese që lidhen me **formimin e përgjithshëm (bazë)** për programin e studimit;
- Veprimtari formuese që **karakterizojnë** përkatësinë e programit të studimit;
- Veprimtari formuese të ngjashme ose/dhe **integruese** me disiplinat karakterizuese, që lidhen kryesisht me formime/ndërdisciplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj;
- Veprimtari formuese **të zgjedhura** nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;
- Veprimtari formuese të fokusuar drejt përfundimit të aftësive shtese si aftësi informatike dhe kompjuterike, aftësive prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë **hyrjen në tregun e punës**, sikurse dhe aktivitete formuese që lidhen me praktikën profesionale pranë kompanive të ndryshme, administratës publike, enteve private apo publike, urdhrave apo kolegjeve profesionale, bazuar në marrëveshje të përbashkëta për këtë qëllim;
- Veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e **tezës së diplomës**.

(Për këtë kategorizim është referuar Udhëzimi MASH nr.15 , dt 04.04.2008).

Lëndët me zgjedhje seleksionohen nga studentet nga një listë që ofrohet kryesisht në vitet 3 dhe 4 të studimit, ndërsa lëndët e formimit të përgjithshëm dhe lëndët e formimit bazë grupohen kryesisht në vitet e para të studimit.

Metodat e mësimdhënies.

Format e mësimdhënies në këtë program janë të organizuara në formën e leksioneve, seminareve, prezantimeve, punëve laboratorike, angazhim jashtë auditorit në formën e detyrave të kursit dhe projektet. Literatura e çdo lënde dhe cilësia e saj është treguar në programet e çdo lënde, të cilët janë përgatitur nga lektori përkatës i lëndës mësimore. Pjesa më e madhe e literaturës së përdorur është e huaj, sepse gjuha e mësimdhënies është anglishtja dhe momentalisht nuk gjendet literaturë e botuar në anglisht në Shqipëri. Dizajni bazë i programit përmban të dhëna mbi departamentin, lektorin dhe orarin, asistentin kërkimor të qenit e detyrueshme apo me zgjedhje, përmbajtjen, objektivat, temat vijuese, kërkesat, libër mësimi, referenca të tjera, punë laboratorike, përdorimi i kompjuterit, të tjera.

Në ndihmë të procesit të mësimdhënies janë laboratorët me kompjutera si dhe paisja e sallave të leksionit me projektorë dhe smart boardet. Lidhjet me internet, pajisjet kompjuterike për stafin e studentët janë bashkëkohore dhe në nivele më se të pranueshme por me trend rritës në të ardhmen e afërt dhe afat mesme. Kudo në ndërtesën e universitetit ka internet wireless dhe salla kompjuterike moderne për studentët. Në koridore janë vendosur kompjutera ku studentët kanë akses në intranetin e universitetit.

Stafi akademik.

Stafi akademik i angazhuar në këtë programet e studimit të Universitetit Epoka është një staf shumë cilësor. Pjesa e dërmuese e stafit mësimdhënës në këtë program janë të huaj, të kualifikuar e me përvojë të gjatë akademike.

Kontratat e punës në Universitetin Epoka janë hartuar në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i amenduar nga ligji nr. 8085, datë 13.03.1996, i amenduar nga ligji nr. 9125, datë 29.07.2009, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore për marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, si dhe në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë", i amenduar nga ligji nr. 8536, datë 18.10.1999 dhe ligji nr. 8781, datë 03.05.2001 dhe ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore për Arsimin e Lartë Privat, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.281, datë 12.03.2008, me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Arsimit të Lartë Privat "Universiteti Epoka" dhe rregulloret e tjera.

Kontratat e punës në Universitetin Epoka janë ndarë në tre lloje:

- Staf akademik me kohë të plotë
- Staf akademik me kohë të pjesshme
- Staf administrativ

I gjithë stafi akademik me kohë të plotë është i angazhuar vetëm te Universiteti Epoka, kurse stafi me kohë të pjesshme vjen nga institucione dhe universitete të tjera dhe në përputhje me marrëveshjet që janë bërë

me institucionet nga ata vijnë, ky staf mund të angazhohet në procesin e mësimdhënies së disa lëndëve specifike.

Procesi i rekrutimi të stafit menaxhohet nga Këshilli i Administrimit të Universitetit, i cili shpall vendet e lira, llojin e vendit të lirë (me kohë të plotë ose të pjesshme), si dhe të gjitha karakteristikat dhe kushtet e tjera të nevojshme që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për një vend të lirë pune, në të cilin kërkohet titulli Doktor, Docent, Profesor i Asociuar dhe Profesor. Kohëzgjatja e shpalljes së vendit të lirë është të paktën 15 ditë. Në të njëjtën kohë, procedurat dhe data e mbylljes së aplikimeve shpallen në mënyrë të qartë.

Me qëllim vlerësimin e punimeve shkencore të kandidatëve të cilët kanë kaluar vlerësimin paraprak dhe kushtin e gjuhës, Këshilli i Administrimit të Universitetit ngre brenda dy javëve një komision, i cili përbëhet nga tre profesorë të fushës përkatëse. Brenda një muaji, Rektori i dërgon komisionit dosjet e kandidatëve me qëllim vlerësimin të tyre dhe hartimin e raporteve përkatëse. Në rast se për një vend të lirë pune ka më shumë se një kandidat, komisioni përgatit një raport me shkrim për secilin kandidat në të cilin përcakton qartë se cili është kandidati fitues sipas komisionit. Pas marrjes së raporteve me shkrim nga komisioni, Rektori ia përcjell ato Këshillit të Lartë të institucionit. Këshilli i Lartë i Universitetit zgjedh njërin nga kandidatët duke marrë parasysh raportin e paraqitur nga Komisioni, si dhe duke argumentuar zgjedhjen e bërë.

Për t'u emëruar në pozicionin e profesorit me kohë të plotë, përveç kushteve që zbatohen për emërimin e personave në pozicionin e profesorit të asociuar, aplikohen edhe kushtet e mëposhtme:

- a) Të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune në fushën përkatëse pas emërimit në pozicionin e profesorit të asociuar (tre nga të cilat duhet të jenë në universitet);
- b) Të ketë punime dhe publikime shkencore të nivelit ndërkombëtar, ndërsa në disiplinat me punë zbatuese, duhet të ketë projekte zbatuese të kryera në praktikë.

Përcaktimi i kushteve të kontratës së punës bëhet nga ana e Rektorit me miratimin e Këshillit të Lartë.

Cilësia e stafit konfirmohet edhe nga komentet e studentëve që konsitojnë: stafi akademik i huaj i angazhuar në mësimdhënie vjen nga 15 universitete të ndryshme, në lëndët aplikative angazhohet staf akademik shqiptar, në kontratën e stafit akademik është një klauzolë ku brenda 1 viti pedagogu duhet të marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare dhe të botojë një artikull në një revistë shkencore dhe për të realizuar këtë pikë të kontratës institucioni subvencionon me një shumë të caktuar në vit si dhe përmbushja e kësaj pike të kontratës dhe vlerësimi nga studentët merren parasysh për rinovimin e kontratës, egzistenca e rregullit që një pedagog të japë 2-3 lëndë në vit, pedagogët janë të lirë që të ndryshojnë përmbajtjen e programeve por duhet gjithmonë t'i përmbahen strukturës së programit e cila është standarde, egzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit me 30 universitete të ndryshme, kriteri që minimumi i kualifikimit të pedagogëve që angazhohen në mësimdhënie është masteri dhe për kontrollin rigoroz të punimeve të kursit për të shmangur kopjimet.

Siç e kemi përmendur edhe më lart, numri total i stafit akademik në Universitetin Epoka është 92 dhe nga këta, 48 (52.2%) zotërojnë më së paku gradën shkencore "Doktor", ndërkohë që 44 anëtarë të stafit

akademik (47.8 %) nuk e zotërojnë gradën shkencore “Doktor”, por pjesa më e madhe e tyre ka përfunduar studimet Master.

Përqindja e stafit me kohë të plotë është 69.6 % (numri i stafit me kohë të plotë është 64) dhe përqindja e stafit me kohë të pjesshme është 30.4 % (numri i stafit me kohë të pjesshme është 28).

Në Universitetin Epoka ka kritere të qarta për aplikimin për vende të lira të punës, punësimin dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik, duke marrë në konsideratë punimet shkencore të kandidatëve dhe eksperiencën në punë.

Gjithë aktiviteti akademik i kandidatëve vlerësohet me një sistem pikësimi ku merren parasysh, artikujt, prezantimet, librat, përkthimet, redaktimi dhe arbitrimi, referencat, aktiviteti mësimor, këshillimi për tezat, projekte kërkimore të përfunduara, çmime të ndryshme, detyra administrative etj.

Mosha mesatare e stafit mësimdhënës është 35 vjeç, ndërsa përqindja e femrave në stafin akademik është 18% dhe e meshkujve 82%.

Edhe për marrjen në punë, ngarkesën mësimore, cilësinë dhe kontrollin e kandidatëve për staf ndihmës ka kritere të përcaktuara qartë. Kandidati për staf ndihmës (asistent kërkimor) duhet të jetë i diplomuar të paktën nga një program Master (Diplomë e Nivelit të Dytë ose Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë.) Emërimi i stafit ndihmës bëhet mbas kërkesës me shkrim të departamenteve përkatëse, vendimit të Këshillit Administrativ të Fakultetit përkatës, propozimit të Rektorit drejtuar Këshillit të Lartë të Universitetit dhe miratimit nga ana e këtij të fundit.

Asistenët e kërkimit kontribuojnë në aktivitetet e edukimit të Universitetit. Ata bëjnë detyra të tilla, si: konsulentë të studentëve, mbikëqyrës në provime, si dhe ndihmojnë gjatë orëve të mësimit dhe laboratorit.

Ngarkesa e punës është rregulluar në kontratën e punës së tij me Universitetin në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e Republikës së Shqipërisë.

Pranimi i studentëve.

Universiteti Epoka synon në arritjen dhe mbajtjen e standardeve të larta akademike, në përputhje me misionin e Universitetit, gjithashtu synon në rekrutimin e studentëve të cilët do të impenjohen dhe do të kontribuojnë në rritjen e nivelit intelektual dhe jetës kulturore të komunitetit të Universitetit. Universiteti synon në arritjen e këtyre qëllimeve nëpërmjet promovimit të marrëdhënieve mes Universitetit dhe shkollave të mesme dhe nëpërmjet inkurajimit të aplikimeve nga ata nxënës të cilët mbartin motivim për edukim dhe rritje të cilësive të tyre akademike. Universiteti Epoka vlerëson në mënyrë të drejtë dhe me transparencë aplikimet nga të gjithë kandidatët, pa dallime racore, etnike, kombëtare, fetare, pamundësi fizike dhe moshe.

Universiteti kryen një vlerësim të përvitshëm të principeve dhe procedurave të pranimit, duke u bazuar në përvojën e përfituar. Pranimi i studentëve kryhet në bazë të rregullave të përcaktuara nga Senati dhe në bazë të Statutit, Rregulloreve dhe Udhëzimeve.

Procesi i pranimit të kandidatëve drejtohet nga Zyra e Promovimit, Përzgjedhjes dhe Pranimit të Studentëve.

Vlerësimi i aplikimeve të kandidatëve kryhet individualisht për çdo person. Kandidatët duhet të kenë cilësinë e duhur për t'ju përgjigjur kërkesave të Universitetit dhe për të përmbushur kriteret specifike të departamentit përkatës në të cilin kanë aplikuar.

Aplikimet vlerësohen në momentin që do të jetë përmbushur i gjithë dokumentacioni i kërkuar. Rezultatet e provimeve ndërkombëtare si SAT, YÖS dhe lista e notave të arsimit të mesëm janë ndër dokumentet kryesore që kërkohen të paraqiten.

Në vlerësimin e çdo kandidati konsiderohen kryesisht kriteret e mëposhtme:

- Rezultatet e provimeve të detyrueshme të Maturës Shtetërore;
- Rezultatet e provimeve me zgjedhje të Maturës Shtetërore;
- Rezultate dhe nota të marra të cilat lidhen me departamentin ku ka aplikuar;
- Cilësia e kurrikulave të arsimit të mesëm të kandidatit;
- Vlerësimet akademike në vite;
- Renditja në shkollën ku ka përfunduar arsimin e mesëm;
- Nota mesatare;
- Aftësia për të qenë i suksesshëm në fushën e kërkuar (e vërtetuar me çertifikata të ndryshme apo aktivitetete jashtë shkollore);
- Letra reference apo informacioni i lëshuar nga mësuesi kujdestar (ose drejtori i shkollës përkatëse)

Universiteti Epoka pranon një numër të kufizuar studentësh për çdo Fakultet (departament) duke synuar përgatitjen e tyre me cilësi. Kandidatët që preferojnë të vazhdojnë në një prej programeve të ciklit të parë të ofruar nga Universiteti Epoka, mund të regjistrohen me një prej mënyrave të mëposhtme:

- Fitues në Provimin e Pranimit të Universitetit Epoka
- SAT: jo më pak se 1500 pikë nga 2400 maksimalja e pikëve
- Pikët e Maturës Shtetërore: jo më pak se 5000 pikë
- YOS: jo më pak se 55 pikë nga 80 maksimalja e pikëve
- Mesatare mbi 8.00 të shkollës së mesme.

Numri i pranimeve bazohet në kapacitetin aktual të fakulteteve dhe në normat e stardardet e kërkuara nga MASH. Kandidatët shqiptarë janë pranuar në rend zbritës bazuar në rezultatet e provimit të hyrjes apo mesatares së shkollës së mesme. Kandidatët e huaj pranohen me vendim të Senatit bazuar në propozimin e Fakulteteve për kuotat e studentëve të huaj, duke vlerësuar suksesin e arritur në provime të ndryshme në vendet e tyre.

Studentët e pranuar i nënshtrohen provimit të gjuhës angleze të mbajtur nga Universitetit Epoka, në mënyrë që të verifikojë nivelin e mjaftueshëm të anglishtes.

Studentët të cilët në provimet ndërkombëtare, si provimi i TOEFL, kanë marrë IBT 68, CBT 190, PBT 520 pikë, në provimin akademik IELTS janë vlerësuar me notën 5.5, Cambridge (CPE) Nota C dhe lart e më sipër dhe janë të pajisur me çertifikatat përkatëse, mund të fillojnë programin mësimor universitar pa u futur në provimin e gjuhës.

Studentët të cilët nuk kalojnë provimin e gjuhës angleze duhet të ndjekin programin përgatitor të gjuhës angleze.

Procesi i regjistrimit finalizohet në momentin kur kandidati nënshkruan Marrëveshjen e Regjistrimit me Universitetin dhe me përfundimin e procedurave të regjistrimit, kandidati fiton statusin e studentit me të drejta të plota. Dokumentat, datat përfundimtare dhe procedurat e regjistrimit shpallen nga Këshilli

Administrativ i Universitetit. Gjatë periudhës së studimeve, studenti është i detyruar të zbatojë rregulloret dhe udhëzimet e Universitetit.

Informacioni i nevojshëm mbi principet, procedurat dhe kriteret e pranimit për çdo program publikohet në faqen e internetit të Universitetit, në afatet përkatëse kohore. Informacionet publikohen rregullisht në mënyrë që kandidatët të njoftohen mbi kriteret e pranimit dhe referencat që kërkon për aplikantët.

Vlerësimi i dijeve të studentëve.

Vlerësimi sasior i studentëve në Universitetin Epoka bëhet në bazë të sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së.

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator dhe atelie, praktikat, punimet në terren, seminare dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor.

Forma e kontrollit të dijes bëhet përmes sistemit të vlerësimit me elemente të shumëfishtë.

Forma e provimit

Provimet pëgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë, me kusht që ai/ajo ta theksojë atë në formën e informacionit për lëndën (planit) brenda dy javëve pas fillimit të lëndës. Provimet janë organizuar dhe kryer nga pedagogët e lëndëve. Në rastet kur pedagogu përgjegjës nuk është i pranishëm në ditën e provimit, mbikëqyrja e provimit do të përcaktohet nga kreu i njësisë akademike përkatëse me rekomandim të pedagogut të lëndës.

Ankimi kundër rezultatit të provimit

Studenti mund të bëjë ankesë në lidhje me rezultatin e një provimi përfundimtar brenda një jave nga data e publikimit të rezultateve, duke paraqitur një ankesë në Sekretarinë Mësimore. Ankesa shqyrtohet më parë ngaurvejuesit e lëndës në lidhje me ndonjë gabim në grumbullimin e pikëve. Këshilli Administrativ i Fakultetit merr vendim lidhur me ankimin e paraqitur në vijim, me propozim të Departamentit, ku subjekti ka paraqitur ankesë.

Kërkimi Shkencor. RVB tregon se Universiteti Epoka inkurajon aktivitetet kërkimore shkencore. Të gjitha politikat lidhur me kërkimin shkencor janë të rregulluara në Direktivën e “Inkurajimit të Kërkimeve Shkencore në Universitetin Epoka”.

Pedagogët e brendshëm janë të angazhuar në punën shkencore nëpërmjet kërkimit dhe botimeve si :

- Botime në Revistat shkencore të universitetit dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit
- Konferencat shkencore, të organizuara nga vetë institucioni dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Botimet shkencore. Universiteti inkurajon pedagogët e brendshëm të botojnë libra shkencor. Këto punime janë autentike me kriterë akademike të rrepta.

Kërkimi shkencor në Universitetin Epoka zhvillohet kryesisht në kuadrin e qendrave kërkimore, të cilat kanë misionet e objektiva të përcaktuara qartë e mbështeten nga një buxhet kërkimor i konsiderueshëm.

Në mënyrë të përmbledhur, mbështetur në raportin e GVB, Qendrat kërkimore të Universitetit Epoka mbulojnë fushat e kërkimit shkencor si vijon:

Qendra e Studimeve Europiane: Misioni i kësaj qendre është për të përparuar të kuptuarit e ngjarjeve që formojnë Europën bashkëkohore përmes zhvillimit të individit, i cili kështu mund të realizojë reduktimin e tij të mundshëm dhe për të përmirësuar jetën e tij, zhvillimin e shoqërisë, me nxitjen e demokracisë, duke ulur pabarazinë midis individëve dhe promovimin e diversitetit kulturor dhe zhvillimin e ekonomisë, duke siguruar që forca punëtore të korrespondojë me evolucionin e marrëdhënieve europiane.

Qendra Kërkimore për Tërmetet dhe Teknologjitë e Ndërtimit: e pari i këtij lloji në Shqipëri, ndërtuar vetëm për ekspertimin në inxhinieri ndërtimi dhe kryerjen kërkimore në ndërtim. Dëmet nga tërmetet në zonat urbane vijnë si pasojë e mospërshtatshmërisë së aspekteve strukturore dhe ndërtimore të godinave të banuara. Menaxhimi i rrezikut dhe reduktimi i rreziqeve mund të arrihet nga një kontroll më i rreptë në projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës në zonat urbane dhe strukturat rezidenciale.

Qendra për Kërkime dhe Aplikime ka për qëllim të zhvillojë kërkimet dhe projektet aplikuese për disa sektorë problematikë në Shqipëri dhe të sugjerojë disa zgjidhje konkrete dhe rekomandime që rrjedhin nga besimi i përbashkët nga ana e autoriteteve menaxhuese të Universitetit, veçanërisht të arsimit që kanë përgjegjësi shoqërore ndaj njerëzve, ekonomisë dhe biznesit në mjedisin e qytetit ku ata operojnë dhe përtej. Si hap i parë, ka qenë planifikuar zhvillimi i një analize të sektorit të ekonomisë shqiptare. Pas analizës, plane konkrete do të zhvillohen për secilin sektor, të tilla si: arsimi publik, shëndetit publik, transportit, telekomunikacionit, turrje, ushqim, tekstil, ndotja, urbanizimi, zhvillimi rajonal dhe rural, varfëria, ekonomia e tregut, çështjet ligjore, etj.

Qendra e Kërkimit dhe Aplikimit mbi Menaxhimin e Cilësisë: ka si objektiva ndjekjen e çdo zhvillimi në fushën e arsimit të lartë, analizën e ndikimit të dinamikave të jashtme në dinamikën e brendshme të institucionit si dhe raportimi i rezultateve; planifikimin dhe zbatimin e projekteve të kërkimit dhe aplikimit mbi cilësinë dhe akreditimin; Planifikimi, zbatimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare mbi cilësinë dhe akreditimin; organizimin e seminareve trajnuese kombëtare dhe ndërkombëtare mbi cilësinë dhe akreditimin; sigurimin e përhapjes në Universitet të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të menaxhimit total të cilësisë; ngritja e bazave të të dhënave, bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit brenda dhe jashtë vendit si dhe kryerja dhe mbështetja e publikimeve; matjen dhe vlerësimin e çdo veprimtarie akademike, administrative dhe sociale të institucionit me qëllim informimin e autoriteteve drejtuese të Universitetit, etj.

Qendra e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës funksionet kryesore të së cilës janë organizimi i seminareve dhe kurseve me qëllim zhvillimin e individit, institucionit ose organizatës; shërbimi i këshillimit në lidhje me transferimin e ideve dhe praktikave të reja tek strukturat dhe individët e institucionit; realizimi i projekteve në fusha të ndryshme të ekspertizës si dhe lehtësimi i procesit të punësimit të të diplomuarve dhe menaxhimi i marrëdhënieve me të diplomuarit nga Universiteti.

Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit Epoka gjatë periudhës 2007-2010, ka publikuar artikuj në revista të ndryshme shkencore, libra konferencash, gazeta, etj., që mund të përmbledhen në mbi 13 botime shkencore dhe 25 prezantime në konferenca ndërkombëtare.

Duhet theksuar se gjithë stafi akademik është i motivuar për kërkimin shkencor dhe kjo për vetë klauzolat e kontratës së punësimit.

Gjithashtu Stafi i Universitetit Epoka në këtë periudhë relativisht të shkurtër ka realizuar një numër projektesh si dhe ka organizuar një numër jo të vogël aktiviteteve shkencore nga të cilat mund të përmendim:

- Themelimi i Labororit për Tërmetet dhe Teknologjinë e Ndërtimit (buxheti 80 000 euro)
- Themelimi i strukturës së informatizimit të Universitetit Epoka (buxheti 30 000 euro)
- Krijimi i software-it të automatizimit në kampus (buxheti 30 000 euro)
- Konferenca e parë Ndërkombëtare për Menaxhimin dhe Ekonomiksin (ICME 2008)
- Konferenca e parë ndërkombëtare mbi Studimet Ballkanike (ICBS 2008)
- Konferenca e dytë ndërkombëtare mbi Studimet Europiane (ICES 2009)
- Seminari ndërkombëtar mbi Tërmetet dhe Strukturat, Qershor 2009
- Konferenca ndërkombëtare “Pas Amnezisë - të mësohet nga ndërtimet urbane islamike mesdhetare”, Mars 2009
- Seminar me prof. Nicholas Pano, Profesor Emeritus i Historisë, Universiteti Western Illinois me teme: “Rezultatet e zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, Nëntor 2008.
- Konferencë e organizuar në bashkëpunim me Kompaninë Maccaferri “Zgjidhje inovative për infrastrukturën, aplikime gjeoteknike dhe hidraulike”, Nëntor 2008.
- Konferenca me temë “Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO: Një rrugë e gjatë, por e suksesshme”, 20-21 maj 2009
- Konferenca ndërkombëtare mbi cilësinë dhe akreditimin e arsimit të lartë, 2 prill 2010
- Pjesëmarrja si partnerë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Etj.

Standardet akademike – përmbledhje

GVJ konstaton se GVB ka bërë një vlerësim të saktë të kapaciteteve të tij për të menaxhuar standardet e programeve të veta. GVJ konstatoi se Universiteti Epoka i kushton vëmendje arritjes dhe mbajtjes së standardeve të larta akademike në përputhje me misionin e Universitetit si dhe komunikimit të këtyre standardeve në mënyrë sa më qartë e të plotë, si tek stafi akademik ashtu edhe tek studentët. Pranimi dhe vlerësimi i studentëve bëhet konform Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Rregullores së Universitetit, e cila i kushton vëmendje të posaçme objektivitetit të vlerësimit të dijes nga ana e pedagogëve.

Universiteti Epoka ka përcaktuar qartë kërkesat dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik, për mbështetjen e tij me programe kualifikuese, përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies, proceset gjithëvjetoare dhe shumëplanëshe të vlerësimit të balancuar, sistemeve të administrimit të dokumenteve, etj.

Mbështetja e procesit mësimor nga një veprimtari kërkimor në rritje kontribon në rritjen e cilesisë së përgatitjes së studenteve dhe në zhvillimin e kapaciteteve të tyre inovative.

Shkalla e lartë kualifikimit e stafit akademik dëshmon për një vlerësim të prioriteteve në drejtim të përgatitjes së specialistëve me një nivel bashkëkohor dijesh e shprehish.

Pjesëmarrja efektive e studentëve në proces sigurohet duke e kompozuar notën në disa kategori, për të cilat studenti duhet të përgjigjet gjatë simestrit. Në program janë parashikuar kohë të posaçme për feedback dhe ndihmë nga pedagogu i lëndës.

GVJ konstaton se tezat paraqiten në përputhje me programin e lëndëve përkatëse, me nivel të arsyeshëm vështirësie.

Procesi mbështetet në literaturë në gjuhën angleze, me libra origjinalë të autorëve të njohur të fushave përkatëse. Në ndonjë rast mësimdhënësit janë edhe autorë, por kryesisht punohet me libra të autorëve të njohur të fushës përkatëse.

Funksionimi i laboratorëve në Universitet mundëson që një pjesë e ligjëratave, veçanërisht për departamentet e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, mbahen në laboratorët përkatës, duke përdorur pajisjet e nevojshme. Kështu, duke përfitur nga mundësitë e aplikimit të ofruara nga këta laboratorë, lektorët përkatës mund të integrojnë lehtësisht rezultatet e kërkimit shkencor me procesin mësimdhënës.

Një kujdes i veçantë i tregohet zhvillimit të praktikave dhe stazheve verore duke ofruar mundësinë e zhvillimit të tyre në kompani të rëndësishme e të mirënjohura në Shqipëri si dhe jashtë saj.

Gjatë programit të praktikës, studentët fitojnë shumë përvojë dhe njohuri praktike. Studentët mësojnë në praktikë sistemin e punës dhe organizimin e kompanive në aspektin organizativ dhe të aktivitetit prodhues ose të shërbimit. Gjithashtu, arrijnë të krijojnë marrëdhënie midis " kolegësh " gjatë programit. Studentët e Universitetit Epoka gjatë praktikave, krijojnë shumë lidhje të vlefshme me specialistë që punojnë në fushat në të cilat ata janë të interesuar të punojnë në të ardhmen.

Për më tepër, programi i praktikave verore përdoret si një shans për të treguar ide apo qëndrime të studenteve në lidhje me çështje të ndryshme, komunikim direkt me specialistë të huaj, iniciativë, punë në grup, koordinim dhe vetëbesim. Të gjitha këto cilësi janë faktorë themelorë dhe thelbësorë për secilin në një treg pune konkurrues. Për studentët që janë ende të pasigurt për atë që ata duan të ndjekin si një karrierë, Programi i Praktikave të Verës është një mënyrë shumë e mirë për të zbuluar talentin apo preferencat individuale. Të qenurit në gjendje për të pasur një përvojë pune para diplomimit nga universiteti u jep studentëve një avantazh të theksuar në krahasim me ata të diplomuar që nuk e kanë një mundësi të tillë. Tregu i punës është gjithmonë në kërkim të kandidatëve që kanë cilësi dhe përvoja shtesë për pozicionet e punës që ata ofrojnë. Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të angazhuar në këto praktika i zhvillojnë ato jashtë Shqipërisë duke u kompletuar edhe me një eksperiencë ndërkombëtare në fushat përkatëse.

VIII. INFRASTRUKTURA E TË MËSUARIT

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kreu dy vizita në mjediset universitare. Konstatimi i tij është se mjediset aktuale janë moderne dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Po ashtu zhvillimi prespektiv i infrastrukturës ndërtimore synon ta shndërrojë Universitetin Epoka në një pol të zhvillimit të dijes. Infrastruktura ndërtimore mbështetet nga një infrastrukture moderne laboratorike e shërbimesh si dhe nga një infrastrukturë njerëzore cilësore dhe të përkushtuar. Kjo infrastrukturë përfshin

politikat e rekrutimit të stafit dhe ato të zhvillimit profesional. Këto shërbime përfshijnë: shërbimet IT, Bibliotekën, shërbimet për studentët, mbështetjen me tutor, Qendrën e Formimit të Vazhduar dhe Planifikimit të Karrierës, etj.

Mjediset.

Objektet e Universitetit Epoka janë konstruktuar në një mënyrë bashkëkohore me materiale cilësore, duke plotësuar kushtet higjienosanitare për studentët, personelin akademik dhe administrativ. Materialet e përdorura nuk përmbajnë elementë të rrezikshëm për shëndetin dhe akustika e mjediseve është e përshtatshme për procesin mësimor. Në ambjentet e Fakulteteve ka salla të mëdha leksionesh, salla për seminarët, zyra të pajisura shumë mirë për punonjësit akademikë, për punonjësit ndihmës dhe mbështetës, salla për kompjuterat, ku ofrohet shërbimi i internetit për studentët dhe për stafin akademik, bibliotekë dhe sallë leximi, etj.

Universiteti Epoka për vitin akademik 2010-2011 është zhvendosur kryesisht në ambientet e reja të kampusit universitar që ka filluar të ndërtohet në vitin 2009. Ka hyrë në funksionim ndërtesa e parë në kampus, e cila përfshin ambiente mësimdhënieje, zyra moderne si dhe një kafeteri dhe mensë (sipërfaqe e brendshme prej rreth 6200m²). Ndërkohë, ndërtimi i ndërtesave të tjera pritet të materializohet në disa faza brenda një periudhe afatshkurtër.

Shërbimet IT.

Në Universitetin Epoka, infrastruktura teknologjike dhe teknologjitë e informacionit përdoren në nivelin më të lartë. Në këtë kontekst, standardet më të larta janë dhënë në hapësirën e mbyllur të Universitetit. Hapësirat janë me ajër të kondicionuar. Përveç tabelës normale, përdoret tabela elektronike (inteligjente) në një auditor dhe në një klasë. Në çdo vend ku zhvillohet procesi mësimor ka kompjuter, internet dhe videoprojektor. Shërbimi wireless i internetit ofrohet në godinën e universitetit, si dhe në kopshtin rreth saj.

Automatizimi e shërbimeve të Universitetit përbën një nga elementët më të rëndësishëm të arsimit. Prandaj, prioritet i është dhënë punës së automatizimit në Universitetin Epoka. Instalimi i softuerit, automatizimi i nevojshëm në lidhje me të dhënat interaktive, sistemet e informacionit të studentëve, web, e-mail, rrjet dhe nevojat e tjera të teknologjisë së informacionit, të gjitha këto janë realizuar me mbështetjen e Universitetit Fatih (Turqi).

Universiteti Epoka disponon një sistem informacioni - Information Systems Center (ISC) i cili është funksional që prej vitit 2009.

Në ditët e sotme, është në dispozicion një sistem qendror kompjuterik i zgjeruar. Sistemi i shërben mësimin, dhe kërkimit shkencor, duke plotësuar nevojat në nivel shumë të mirë. Jashtë sallës së Sistemit ISC, 97 kompjutera janë alokuar për stafin dhe studentët:

- a) Numri i përgjithshëm i kompjuterëve që janë vendosur në Universitetin Epoka është 97. Nga këta, 94
- b) janë kompjutera dhe 3 kompjutera laptop.

- c) 24 kompjuterë janë vendosur në laboratorin kompjuterik të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike.
- d) përveç kësaj, një laborator kompjuterik është dhënë për studentët që do të përdoret në kohë të lirë.
- e) Ka një kompjuter për pesë studentë, si dhe një kompjuter për çdo akademik dhe staf administrativ në Universitet.

Kompjuterët në dispozicion të studenteve përmbajnë parametrat e duhur për një përdorim të programeve më të specializuara profesionale, dhe me një cilësi mjaft të mire. Secili nga studentet pajiset me “user-name” dhe “pass-word” personal, që lejon hyrjen në sistemin e dokumenteve personale për secilin dhe mund të gjejnë aty dokumentet e tyre individuale.

Zyra e IT e Universitetit Epoka ka krijuar një arkivë elektronike përveç asaj fizike ekzistuese. Kjo gjë bën të mundur garantimin e një marrëdhënieje akoma me interaktive midis pedagogeve që depozitojnë materialet për studentët (leksione) dhe studentëve të cilët tërheqin në çdo kohë këto materiale si dhe depozitojnë detyrat e tyre të kursit apo materiale të tjera të përgatitura prej tyre.

Biblioteka . Biblioteka e Univeritetit Epoka ka një sipërfaqe të konsiderueshme ku përfshihet fondi i librave, revistave dhe materialeve të tjera, si dhe sipërfaqja e studimit në dispozicion të studentëve dhe stafit. Biblioteka ka një larmi librash të degëve të ndryshme (me mbi 200 tituj/profil) dhe disponon botime të kohëve të fundit me një fond në zhvillim të vazhdueshëm.

Gjatë vitit akademik 2008-2009 u shpenzuan 40 000 euro nga buxheti për blerjen e librave e të tjera materiale të bibliotekës. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti akademik, Universiteti është bërë një anëtar i bazës së të dhënave të EBSCOhost, që ofron konsultim për 39.397 tekste online. Personeli dhe studentët e Universitetit Epoka kanë akses në burime të siguruara nga EBSCOhost nga çdo kompjuter, pasi të kenë marrë një fjalëkalim nga administrata e Bibliotekës. Kredia për vitin akademik 2008-2009 (libra, multimedia, rezervat, abonimi i revistave, etj.) ishte 600 duke arritur në rreth 1500 lloje të ndryshme të librave (e përgjithshme, referenca dhe libra të rrallë, revista shkencore, etj.) në bibliotekë. Megjithatë, aksesit në shumë revista të përgjithshme dhe akademike, revista dhe tekste, mund të sigurohet nëpërmjet të dhënave EBSCOhost.

Mbajtja dhe shpërndarja e informacionit. Universiteti Epoka boton rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor, rreth programeve të ofruara, pritshmëritë e rezultateve të tyre, kualifikimet e marra, mësimdhënien, të mësuarit dhe procedurat e vlerësimit të përdorura, si dhe mundësitë e nxënies në dispozicion të studentëve.

Të dhënat e studentëve, stafit dhe publikut sigurohen nga zyrat e mëposhtme:

Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Protokollit, e cila menaxhon të gjithë korrespondencën e jashtme dhe të brendshme të Rektoratit. Në të njëjtën kohë, në bazë të kalendarit të hartuar në fillim të çdo viti akademik, kjo zyrë njofton të gjithë anëtarët e organeve kolegjiale vendimmarrëse të Universitetit për kohën dhe vendin ku do të mbahen mbledhjet respective, si dhe për rendin e ditës së tyre. Zyra e Protokollit dhe Komunikimit gjithashtu harton vendimet e marra gjatë këtyre takimeve dhe siguron

nënshkrimin e procesverbaleve të mbledhjeve nga anëtarët përkatës. Pas përfundimit të kësaj faze, ajo shpërndan vendimet për njësitë përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve që përfshihen në vendime ose thjesht për informacion.

Zyra e Marrëdhënieve me Mediat dhe Publikun është përgjegjëse për shpërndarjen e informacionit mbi çështjet e lidhura me Universitetin. Zyra është përgjegjëse për koordinimin e kërkesave për informacion të mediave, intervista, komunikata për shtyp, njoftime publike, fjalime nga autoritetet e Universitetit, shpalljen e aktiviteteve dhe për nxitjen dhe lehtësimin e shpërndarjes për mediat të njoftimeve, urdhrave, etj. në lidhje me aktivitetin e Universitetit. Zyra e Marrëdhënieve me Mediat dhe Publikun administron informacionin e botuar në faqen e internetit të Universitetit Epoka.

Zyra e Shëndetit, Kulturës dhe Sporteve mban rrjedhë të komunikimit të drejtpërdrejtë me studentët, duke organizuar takime të veçanta gjatë tërë vitit akademik, zhvillimin e sondazheve dhe publikimin e rezultateve të tyre. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e shënimeve akademike të tilla si përpunimi i transkripteve, verifikimi i regjistrimit, mbajtja e shënimeve në bazën e të dhënave të studentëve, përpunimi i listave të klasës dhe aplikimi i diplomimit.

Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të Universitetit Epoka, si dhe menaxhon dhe vazhdimisht përditëson bazën elektronike të të dhënave mbi stafin e Universitetit.

Zyra e Financës administron të gjithë informacionin e nevojshëm mbi pagesën dhe çështjet e financiare që i interesojnë stafit dhe studentëve të Universitetit Epoka.

Qendra e Sistemeve të Informacionit (QSI) ofron bibliotekë online, shërbime të informacionit dhe dokumentacionin e nevojshëm në universitet. Kjo qendër planifikon infrastrukturën e informatikës së Universitetit, garanton sigurinë, si dhe vazhdimin e funksioneve të saj. Gjithashtu siguron një përdorim efektiv, ligjor dhe të gjerë të shërbimeve të informacionit për studentët dhe personelin. QSI planifikon serverat dhe shërbimet e kablllove të Universitetit. Përgatit web faqen e Universitetit dhe automatizimin e programeve.

Informacioni në Universitetin Epoka është i shpërndarë duke përdorur kanalet e mëposhtme:

Verbal: Të gjitha zyrat janë përgjegjëse për të dhënë informacion të detajuar mbi Universitetin, aktivitetet e departamenteve, gjithashtu ruajnë integritetin dhe konfidencialitetin e institucionit në çështje specifike.

Me shkrim: Informacioni me shkrim lëshohet me kërkesë të personit në fjalë ose për shkak se çështja është e lidhur me studentë të veçantë, anëtarë të stafit akademik ose njësi universitare.

Elektronike: Informacioni është i shpërndarë duke përdorur webmail, në këtë kontekst baza e të dhënave e-mail-i është mbajtur e përditësuar. Në fillim të këtij viti akademik, Universiteti Epoka ka instaluar programin e automatizimit, përbërë nga Sistemi i Informacionit i Sekretarisë Mësimore (SISM) që është një sistem interaktiv ku studentët dhe stafi mund të kryejnë pjesën më të madhe të procedurave me anë të kompjuterëve.

Faqja SISM mund të arrihet në <https://sais.epoka.edu.al> ose thjesht duke ndjekur linkun e SISM të pranishëm brenda lidhjeve të shpejta në web faqen e Universitetit Epoka. Nga faqja hyrëse, duke përdorur Student ID (ose emrin) dhe fjalëkalimin, studentët dhe personeli mund të hyjnë në faqen e tyre SISM. Faqja

SISM përfshin informacionin e mëposhtëm në lidhje me informacione kredenciale, mesazhe, regjistrimin, kurse, etj. Në të njëjtën kohë, programi i automatizimit të Universitetit Epoka përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët, stafin dhe infrastrukturën fizike të Universitetit.

Duke përdorur linkun, studentët, stafi akademik dhe ai administrativ mund të ketë hyrje në informacionin e mëposhtëm:

LIDHJE AKADEMIKE: (Kurse, Lista ime javore, Datat e provimeve, Programi, Formulari me rezultatet e kurseve, Shërbimi i mesazhit)

KËSHILLUESE/REGJISTRIMET E LËNDËVE: (Lista e studentëve, Informacion vetjak, Notat e përkohshme, Frekuentimi, Lista javore, Transkripti i notave, Llogaritja e notës, Programi mësimor, Kurse që duhet të ndiqen, Kurset e zgjedhura/Konfirmim regjistrimi, Formulari i regjistrimit në kursit, Afishime nga departamentet, Kërkim studentësh, Përcaktimi i Këshilltarit etj.)

CV/PERFORMANCA: (Shikim paraprak i CV-së, Redaktimi i CV-së)

KËRKESA: (Inventari, Qendra e thirrjeve, Biblioteka, Kërkesë ndjekja)

ADMINISTRATIVE: (Menaxhimi i dokumentave dhe formularëve, Konfirmimi i kërkesave, Kërkimi i kursit dhe menaxhimi i seksionit, Kuotat e kurseve, Kontakti i stafit, Statistika, Menaxhimi i proceseve, Statistikat e programeve mësimore, etj.)

TË SHUMANSHME: (Qendra e shkarkimeve, Dokumenta dhe formularë, Inventarë, Programet javore të studentëve, Ditëlindjet e stafit, Ditëlindjet e studentëve, Kodet dhe konfigurimet, etj.)

Shërbime të tjera për studentët. Studentët kanë në dispozicion një *qendër për shumëfishimin* e leksioneve dhe printimin e materialeve të ndryshme që ndihmojnë procesin mësimor. *Sekretaria Mësimore* krahas punës së saj kryen njoftime të ndryshme për studentë dhe pedagogë. Universiteti ka *shërbimin e mencës* për plotësimin e nevojave ditore të studentëve dhe stafit në universitet. Universiteti ka parashikuar edhe infrastrukturën dhe sistemin e sigurisë dhe të emergjencave në rast nevojë.

Për shkak të mekanizmit të automatizimit, në infrastrukturën teknologjike dhe teknologjitë e informacionit, është e sigurtar një web dhe llogari e-mail për të gjithë studentët, që mund të informohen ku mund të ndjekin leksionet, për mungesat, datat e provimeve, të bëjnë regjistrimin e kurseve dhe të mbajnë kontakt me këshilltarët e tyre dhe pedagogët.

Këshillimi i studentëve.

Projekti "Mentorship"

Universiteti Epoka ka ndërmarrë dy iniciativa mbi këshillimin e studentëve të saj. Iniciativa e parë parashikon që studentët e vitit të parë do të marrin ndihmë në formë këshillimi dhe udhëzimi prej studentëve të viteve të larta të cilët janë zgjedhur mentor. Ndërkohë, iniciativa e dytë synon një kalim sa më efektiv të studentëve në prag të diplomimit në jetë profesionale nëpërmjet ndihmës dhe udhëzimeve të Mentorëve të Kualifikuar.

Studentët Mentorë

Qëllimi parësor i programit është që të mundësojë të gjithë studentët e rinj që fillojnë studimet të kenë një periudhë të qetë tranzicioni, duke iu përshtatur ambientit sfidues akademik dhe shoqëror të Universitetit Epoka në semestrin e tyre të parë. Gjatë Programit të Orientimit në fillim të semestrit të parë, çdo Studenti Mentor të përzgjedhur i ngarkohen për të këshilluar dymbëdhjetë studentë të të njëjtit departament ose të disiplinave të ngjashme. Të gjithë studentëve të rinj do t'u ofrohet një mbështetje e fortë nga Studentët Mentorë duke filluar nga dita e tyre të parë në Universitetin Epoka deri në ditën e fundit të semestrit të parë, duke lehtësuar jetën sociale të tyre në universitet.

Studentët Mentorë janë të zgjedhur nga vitet e fundit, dalluar për personalitetin e pjekur, ndjenjën e përgjegjësisë, aftësinë për të treguar empati dhe duhet të kenë mesatare të përgjithshme jo më pak se 2.50, gjithashtu pa dënime disiplinore. Studentëve Mentorë, para se të fillojnë, u kërkohet që t'u nënshtrohen disa trajnimeve, si: orientim lidhur me pritshmërinë ndaj punës së tyre, një trajnim do të jetë administrativ dhe një trajnim eksperimental rreth komunikim efektiv, dhe më pas ata marrin mbikëqyrjen e grupeve të vogla gjatë kohës së shërbimit. Projekti `Mentorship` është gjithashtu për Studentët Mentorë një mundësi për të mësuar më shumë për veten dhe të tjerët, për të zhvilluar përgjegjësinë, besimin dhe ndërvlerësinë, duke u ofruar atyre një themel të fortë në marrëdhëniet personale.

Mentorët e Kualifikuar

Mentorët e Kualifikuar janë individë të zgjedhur nga Universiteti, të cilët vullnetarisht ofrojnë mbështetje profesionale përmes kontakteve e takimeve shoqërore me studentët, të cilët u janë dhënë në ngarkim në bazë të profesionit të tyre. Përgjegjësia kryesore e Mentorit të Kualifikuar është të ndihmojë studentët për të gjetur apo praktikë profesionale gjatë periudhës së verës dhe mundësi punësimi pas diplomimit.

Infrastruktura e mësimdhënies- përmbledhje

Misioni i Universitetit Epoka mbështetet nga një infrastrukturë mësimdhënieje që është efektive, efiçente dhe plotësisht në shërbim të nevojave të studentëve. Në Universitetin Epoka, infrastruktura dhe fasilitetet lidhen ngushtë me fuqizimin e studentëve për të menaxhuar zhvillimin e tyre arsimor, personal dhe profesional. GVJ pati mundësinë ta verifikojë këtë në mjediset e universitetit, në dokumentacionet e vënë në dispozicion dhe nëpërmjet diskutimeve me studentët dhe stafin të cilët përforcuan faktet që përmban RVB në lidhje me infrastrukturën mësimore. Shërbimet akademike të këtij institucioni janë të mirëfinancuara dhe studentët kanë akses në sisteme funksionale që mbështesin formimin e tyre dhe përfitojnë nga një gamë e gjerë materialesh mësimore. Në mënyrë të veçantë është impresionuese gama e gjerë e fasiliteteve të mbështetura në internet dhe akses i pakufizuar kohor që iu është lejuar studentëve dhe stafit.

IX. BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE TREGUN E PUNËS

Bashkëpunimet kombëtare

Që prej themelimit të tij, krijimi i një bashkëpunimi të ngushtë me universitetet e tjera publike dhe private të Shqipërisë ka përbërë një qëllim të Universitetit Epoka. Për këtë qëllim, një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) është nënshkruar me Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, i cili parashikon shkëmbimin e stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve për perioda deri në një vit akademik, bashkë-organizimit të konferencave, seminareve dhe ngjarjeve të ngjashme, bashkëpunimi në çështjet kulturore dhe sportive, etj. Në këtë kontekst, edhe lektorë nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës janë të angazhuar në procesin e mësimdhënies në Universitetin Epoka.

Në të njëjtën kohë, një memorandum është nënshkruar me Institutin e Gjeoshkencave të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku, përveç pikave të përmendura më sipër, i është vënë theks edhe zbatimit të projekteve kërkimore të përbashkëta ndërmjet Institutit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAE) të Universitetit Epoka. Në këtë kontekst, në qershor 2009, një seminar mbi Tërmetet dhe Strukturat u bashkë-organizua nga Instituti dhe FAE, me pjesëmarrjen e akademikëve dhe studiuesve të shumtë nga të dy institucionet. Njëkohësisht, lektorë nga Universiteti Politeknik i Tiranës janë të angazhuar edhe në procesin e mësimdhënies në Universitetin Epoka.

Për më tepër, Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie miqësore me universitetet e ndryshme private që operojnë në Shqipëri, duke i ftuar përfaqësuesit e tyre në të gjitha konferencat ndërkombëtare, seminarët dhe veprimtaritë e organizuara nga Universiteti. Përveç kësaj, stafi akademik i universiteteve të tjera publike dhe private ka mundësinë e aksesit të lirë në bazën e të dhënave elektronike EBSCOhost nga objektet e bibliotekës.

Bashkëpunimet ndërkombëtare

Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me universitete të tjera si në rajon dhe më gjerë. Kështu, deri më tani, universiteti Epoka ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume mirëkuptimi (MoU) me universitetet dhe institucionet e mëposhtme të arsimit të lartë:

- 1) Universiteti i Teksasit në Austin – SHBA
- 2) Universiteti Shtetëror Sam Houston – SHBA
- 3) Universiteti i Teknologjisë, Zyrih – Zvicër
- 4) Universiteti Sulejman Demirel – Turqi
- 5) Universiteti i Trakjas – Turqi
- 6) Universiteti i Gaziantepit- Turqi
- 7) Universiteti Amerikan i Emirateve – Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe
- 8) Universiteti Ndërkombëtar i Ballkanit – Maqedoni
- 9) Universiteti Ndërkombëtar BURCH – Bosnje dhe Hercegovinë
- 10) Universiteti Mesdhetar – Mal i Zi
- 11) Universiteti i Kaukazit – Azerbajxhan
- 12) Universiteti Ndërkombëtar i Detit të Zi – Gjeorgji

13) Universiteti Sulejman Demirel – Kazakistan

14) Universiteti Ndërkombëtar i Atatürkut-Alatoo – Kirgizistan

15) Universiteti Ishik, Erbil – Irak

16) Universiteti Politeknik i Barit - Itali

17) Universiteti Leeds –Angli (*nënshkruar në një nga ditët e vizitave të GVJ në Universitetin Epoka*).

Këto MoU parashikojnë bashkëpunime ndërmjet universiteteve në lidhje me shkëmbimin e stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve për periudha deri në një vit akademik, bashkë-organizimin e konferencave, seminareve dhe ngjarjeve të ngjashme, bashkëpunimin në çështjet kulturore dhe sportive, etj.

Marrëdhëniet me tregun e punës

Që nga themelimi i Universitetit, i është vënë rëndësi zbatimit të procesit të mësimdhënies, që do t'u mundësojë studentëve të krijojnë lidhje me kërkesat e tregut vendas të punës, duke filluar nga studimet e tyre universitare. Në këtë drejtim, rëndësi e veçantë i është dhënë organizimit të praktikave për studentët në institucione të ndryshme publike, si dhe në kompani private si brenda dhe jashtë Shqipërisë, kryesisht gjatë sezonit të verës.

Gjatë vitit akademik 2007-2008, 28 studentë, ose rreth 50% e komunitetit të studentëve më pas ka marrë pjesë në praktikë, ndërsa gjatë vitit akademik 2008-2009, 75 studentë që përbëjnë rreth 34% të numrit të përgjithshëm të studentëve këtë vit akademik, ka marrë pjesë në praktika të organizuar nga Universiteti. 45 studentë morën pjesë në praktika të organizuara në Shqipëri, ndërsa 30 studentë morën pjesë në partneritetet e organizuara në kompani të shumta private në Turqi.

Në të njëjtën kohë, Qendra e Planifikimit të Karrierës është themeluar në kuadër të Zyrës së Shëndetit, Kulturës dhe Sporteve, në mënyrë që të orientojnë studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe në opinionin e tyre të karrierës. Një nga fushat kryesore të punës së Qendrës së Planifikimit të Karrierës ka qenë organizimi i programeve të praktikës së lartpërmendur, si dhe organizimin e programeve të ndryshme trajnimi për studentët e Universitetit Epoka për t'i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t'i ndihmojnë ata në karrierën e tyre të ardhshme profesionale.

Bashkëpunimi, marrëdhëniet me publikun dhe tregun e punës- përmbledhje

Nga RVB del qartë se Universiteti Epoka është i angazhuar në zhvillimin e një bashkëpunimi të gjithanshëm me institucione të arsimit të lartë si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave me të mira në drejtim të formimit të studentëve dhe kerkimit shkencor në kuadrin e realizimit të misionit të tij institucional.

Mësimdhënia në gjuhën angleze lehtëson mjaft komunikimin dhe shkëmbimet me universitete të tjera jashtë Shqipërisë, duke mundësuar formimin e studentëve jo vetëm për tregun kombëtar, por edhe atë rajonal e më gjere.

X. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Misioni i Universitetit Epoka është transformimi në një institucion mësimor-kërkimor me influence e inovativ, në shërbim të vlerave humane thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe kontributit me njohuri në nivel ndërkombëtar; përgatitjes së individëve me ndjeshmëri sociale, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat rajonale dhe botërore.

Universiteti Epoka ka ngritur dhe po zgjeron zhvillimin e një infrastrukture bashkëkohore e cila do të jetë në shërbim të misionit të tij dhe kombinuar me nivelin cilësor të mësimdhënies e zhvillimin e kërkimit shkencor do ta kthejë atë në institucion elitar të arsimit të lartë në Shqipëri.

GVJ konstatoi një angazhim të përkushtuar në drejtim të cilësisë konkretizuar nëpërmjet institucionalizimit të elementëve të sistemit të sigurimit të cilësisë si dhe ngritjes e funksionimit të një sistemi të plotë të dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet, në përputhje me standardet përkatëse:

- Në mënyre institucionale janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të kandidatëve për t'u përfshirë në personel akademik.
- Asistenca për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zëra me rritje të qëndrueshme në buxhetin e institucionit.
- Universiteti Epoka ka vendosur kriteret për kontrollin e hyrjeve në universitet dhe ka të specifikuar kriteret në lidhje me cilësinë e notës. Gjithashtu ka përcaktuar kriteret të qarta cilësore për vazhdimin e mardhënies së studentit me institucionin dëri në marrjen e titullit të studimit.
- Në fakultete është i institucionalizuar procesi i marrjes së feedback-ut nga studenti.
- Një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve duke harmonizuar mjaft mirë format e ndryshme të kontrollit.

Programet e studimeve të ciklit të parë janë ndërtuar duke respektuar jo vetëm në aspektin formal, por në praktikë kërkesat ligjore dhe kërkesat që burojnë nga misioni dhe objektivat e tyre. Të gjithë elementët e realizimit të programeve duke filluar që me planet mësimore, mësimdhënjen, stafin akademik, kërkimin shkencor dhe infrastrukturën janë në nivele të mira dhe optimale dhe japin garanci për realizimin e tij.

Kërkimi shkencor në rritje dhe hapja ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar përbën një vështrim strategjik të mirëpërcaktuar dhe do të kontribojë në rritjen e cilësisë së përgatitjes së studentëve, rritjen e kualifikimit të stafit si dhe në krijimin e një kompetence në fusha të caktuara të ekspertizës tekniko-shkencore.

Lidhja me tregun e punës nëpërmjet kontakteve të fituara gjatë praktikave profesionale si dhe të ftuarve nga ndërmarrjet e ndryshme brenda e jashtë vendit përbën një premisë të mirë për përgatitjen e studentëve me njohuri të thella e të aftë për t'ju përshtatur këtij tregu.

GVJ gjatë misionit të vlerësimit konstatoi se Universiteti Epoka në një kohë relativisht të shkurtër ka realizuar gjithë bazën e nevojshme për një zhvillim të sukseshëm në vijim duke garantuar cilësinë, transparencën, standartet e mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimit brenda vendit, në rajon e më gjerë. Në këtë mënyrë do të bëjë të mundur realizimin e synimit të tij për t'u kthyer në një pikë referimi për arsimin e lartë privat jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj.

Nga sa më sipër GVJ shprehet unanimitet dhe pa rezerva për akreditimin e Universitetit Epoka duke shprehur bindjen për kontributin e tij të paneglizhueshëm në një përgatitje cilësore teknike e profesionale si dhe në drejtim të përmirësimit të standarteve të demokracisë e qytetërimit në Shqipëri.

PIKA PËR T'U PËRSHËNETUR

- 1) Një mision dhe objektiva të qarta zhvillimi;
- 2) Mësimdhënie në anglisht krijon mundësi për një mbështetje të procesit mesimor me tekste bazë me një nivel të lartë të shkruara nga autorë të njohur. Gjithashtu, studentët që gjatë kryerjes së studimeve universitare ambientohen me termat teknike në gjuhën angleze e cila është bërë tashmë një gjuhë e domosdoshme për jetën profesionale.
- 3) Cilësi e lartë e kurrikulave të ofruara të programit të studimit të cilat jo vetëm janë hartuar mbi bazën e përvojës amerikane (tashme e provuar si mjaft e suksesshme) por edhe transmetohen për studentët nga një staf akademik mjaft cilësor. GVJ është i mendimit se një nga përparësitë e kurrikules së ofruar për studimet universitare është edhe shtrirja e saj në katër vite akademike. Kjo bën që studenti të marrë jo vetëm më shumë njohuri (rreth 240 kredite) por të ketë edhe një përvetësim më të qëndrueshëm të dijeve të marra.
- 4) Infrastrukturë e përshtatshme dhe ambiente komode që ndihmojnë në realizimin me cilësi të programeve të studimit. Implementimi i planit për ndërtimin e kampusit qendror brenda një periudhe të shkurtër tregon se Universiteti EPOKA ka përparësi rritjen e vazhdueshme të cilësisë të mësimdhënies, pavarësisht kostos që paguan për t'a arritur atë.
- 5) Ofrimi i një sistemi nxites bursash;
- 6) Ndërtimi i një sistemi të plotë dhe efektiv të informacionit;
- 7) Politika të dizenuara për ndjekjen e studentëve edhe pas diplomimit;
- 8) Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit;
- 9) Orientimi nga klienti (ka përjasje bashkëkohore në komunikimin pedagog-student, mësimdhënie bashkëkohore etj);
- 10) Sistem i brendshëm efikas i kontrollit të cilësisë së mësimdhënies;

- 11) Element shumë pozitiv në aspektin e cilësisë është certifikimi me standardin ISO 9001: 2008 mbi sistemet e menaxhimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë, sikurse edhe vazhdimi i procesit për certifikimin me ISO 14001 dhe 18001 OHSAS

PIKA QË KËRKOJNË MË SHUMË VËMENDJE

- 1) Harmonizimi më i mirë i sistemit amerikan të përdorur me atë europian në kuadër të procesit të Bolonjës;
- 2) Forcimi i mëtejshëm i lidhjeve me grupet e interesit dhe tregun e punës për të tërhequr kontributet e tyre në lidhje me kualifikimet e ofruara nga Universiteti Epoka;
- 3) Zgjerimi i kompletimit të bibliotekës me literaturë më të larmishme e me tirazh më të lartë;
- 4) Stimulimi më i mirë i punës individuale të studentit gjatë zhvillimit të procesit mësimor duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë, eseve të ndryshme, projekteve individuale e në grup etj.
- 5) Rritjen e pjesëmarrjes në projekte shkencore si brenda vendit ashtu edhe jashtë.
- 6) Ndërtimi i bazave të shëndosha për implementimin e sukseshëm të ciklit të tretë (doktorata).
- 7) Rritja e mobilitetit të studentëve nëpërmjet përfshirjes në programe të ndryshme europiane.
- 8) Menaxhimin e kujdesshem të ciklit të dytë të studimeve (Master) në raport me njohuritë dhe nivelin e arritur nga cikli i parë.

REKOMANDIME

Mësimdhënia

- Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa e mësimdhënjes nga profesorët e huaj
- Të shikohet mundësia për ofrimin e mësimdhënjes pjesërisht në gjuhën shqipe
- Të intensifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të pranuar, duke përdorur politika më efektive marketingu,
- Numri i përgjithshëm i disiplinave, kryesisht i atyre me zgjedhje të jetë më i kufizuar dhe i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentët të jenë më komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.
- Puna individuale e studentëve duhet të stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve të ndryshme.
- Shtimi i numrit të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar një mbulim të plotë dhe më të mirë të procesit mësimor.
- Rekomandohet që të dhënat e perfituara nga KVAPC të analizohen dhe të bëhen pjesë më e drejtpërdrejtë e menaxhimit akademik dhe administrativ të IAL.
- Nje dimensionim edhe më i qartë i programeve të lëndëve teknike i gershetuar edhe me përvojat e përparuara europiane.
- Një profilizim më i qartë i stafit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies.

- Kompaktesime eventuale të planeve mësimore duke evituar lëndët me më pak se 5 kredite.

Bashkëpunimet

- Të vazhdohet puna e nisur me bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke insitucionalizuar ato me marrëveshje të qëndrueshme edhe në trojet shqiptare
- Te rritet bashkëpunimi me ndërmarrjet prodhuese lider në drejtimet përkatëse si brenda vendit ashtu edhe në rajon.

Kërkimi shkencor

- Të hartohen programe të plota të kërimit shkencor dhe të zgjerohet pjesmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare.

Infrastruktura dhe lehtësirat

- Literatura shkencore vendase dhe e huaj në bibliotekë është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.
- Të ndërtohen ambjente sportive.

XI. ANEKSE

ANEKS 1: ANALIZA SWOT (RVB)

Pikat e forta

I. Menaxhimi

- Metoda e menaxhimit gjithëpërfshirës
- Komunikim i hapur me autoritetet menaxhuese
- Konfidenca e stafit në autoritetet menaxhuese
- Tendenca e autoriteteve menaxhuese për të qenë të hapur të kundrejt risive

II. Procesi i mësimi dhe stafi akademik

- Arsimim cilësor
- Mësimdhënie 100% në anglisht
- Shumëllojshmëri programesh studimi
- Cilësia e kurrikulave të ofruara të programeve të studimit
- Metoda ndërdisiplinore në procesin e mësimi
- Disponimi i programeve inxhinierike në universitet
- Funksionimi i programit përgatitor të gjuhës angleze
- Implementimi i programeve për rritjen e stafit të ri akademik
- Nivel i lartë i performancës në procesin e mësimi
- Staf akademik cilësor
- Staf akademik me përvojë ndërkombëtare
- Lidhja e fortë e stafit akademik me institucionin
- Vlerësimi i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët
- Disponimi i laboratorëve të përdorur në procesin mësimor dhe kërkimor
- Rritja e numrit të programeve kërkimore financuar nga burime të brendshme dhe të jashtme
- Vlerësimi i saktë dhe i drejtë i performancës së studentëve
- Procesi i përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve
- Ofrimi i bursave të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentët e suksesshëm
- Cilësi e mirë e pjesës më të madhe të studentëve të regjistruar
- Organizimi i vazhdueshëm i konferencave ndërkombëtare,seminarëve dhe ngjarjeve të ngjashme shkencore.
- Shumëllojshmëria e kombësive të studentëve
- Përdorimi i literaturës bashkëkohore të autorëve dhe i burimeve të tjera të botuara
- Përdorimi i pajisjeve teknologjike moderne (projektorë, smart board) në procesin e mësimdhënies

III. Infrastruktura, ambienti i punës dhe kushtet

- Pozicioni në kryeqytet i kampusit qëndror

- Implementimi i planit për ndërtimin e kampusit brënda një periudhe të shkurtër kohore
- Abonimi i universitetit në baza të ndryshme të dhënash të bibliotekave elektronike
- Lehtësira të shumta mbi aksesin e informacionit dhe në burimet elektronike të informacionit
- Marrëdhënie dhe komunikim cilësor ndërmjet stafit
- Kushtet e përshtatshme fizike në ambientin e punës
- Hapësira të mëdha të gjelbra në ndërtesën kryesore aktuale

IV. Marrëdhëniet mes Universitetit dhe industrisë/shoqërisë

- Marrëdhënie cilësore me institucionet publike dhe sektorin privat
- Lidhje të ngushta dhe bashkëpunim me administratën lokale dhe organizatat joqeveritare
- Organizimi dhe implementimi i programeve trajnuese

V. Marrëdhëniet me BE dhe shtetet e tjera

- Liderhip në programet e shkëmbimit të studentëve midis universiteteve shqiptare dhe të huaja
- Staf akademik me përvojë dhe nivel të lartë suksesi në përfitimin nga projektet e ofruara të BE
- Marrëdhënie të institucionalizuara me universitetet e huaja

VI. Imazhi i Universitetit Epoka dhe satisfaksioni i palëve të interesuara

- Ekzistenca e imazhit pozitiv përballë institucioneve të jashtme
- Ekzistenca e imazhit pozitiv përballë publikut shqiptar
- Satisfaksion i lartë i studentëve nga Universiteti Epoka
- Mbështetja e stafit akademik dhe administrativ për përmbushjen e misionit të universitetit
- Satisfaksioni i stafit akademik nga universiteti, fakultetet dhe departamentet
- Satisfaksioni i stafit përsa i përket punës së tyre dhe marrëdhënieve me autoritetet drejtuese
- Bashkëpunim i konsoliduar me profesionistë në treg

Pikat e dobëta

I. Menaxhimi

- Vështirësi në lidhje me institucionalizimin dhe periudhën e tranzicionit për shkak të themelimit rishtazi të Universitetit
- Vështirësitë menaxheriale që rrjedhin nga diversiteti kulturor i stafit të universitetit
- Vështirësitë që rrjedhin nga kryerja e pjesës më të madhe të proceseve dhe operacioneve të punës në më shumë se një gjuhë dhe në pjesën më të madhe, në gjuhë joamtare
- Mungesa e përvetësimit të plotë të kulturës institucionale nga të gjitha njësitë e universitetit

II. Niveli i përdorimit të burimeve dhe mjeteve

- Burime të kufizuara financiare të Universitetit Epoka për shkak të shpenzimeve të larta gjatë fazës së themelimit

- Mbështetje e kufizuar financiare në lidhje me zhvillimin e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore
- Shërbime të kufizuara në sektorin e shëndetit, ushqimit dhe aktiviteteve sportive për studentët
- Akses i kufizuar mbi financimet e BE-së për shtetet jo anëtare dhe shtetet kandidate në BE
- Informacion i kufizuar për mundësitë e financimit të jashtëm

III. Procesi i mësimi dhe stafi akademik

- Nivel i ulët i njohurisë së gjuhës angleze nga ana e një pjese të studentëve
- Udhëzime dhe shërbime konsultimi të kufizuara për studentët
- Mungesë e një numri të konsiderueshëm të numrit të stafit mësimdhënës ndihmës
- Përpjekje të kufizuara për sigurimin e mbështetjes nga burime të jashtme për zbatimin e projekteve kërkimore
- Fonde të kufizuara për studentët e doktoraturës jashtë vendit

IV. Marrëdhënia me shoqërinë dhe aksionerët

- Mungesa e përvetësimit të mjaftueshëm nga të gjitha njësitë e objektivave të universitetit për të qenë të hapur ndaj institucioneve të jashtme dhe publikut të gjerë
- Mungesë e promocionit të mjaftueshëm të universitetit ndaj publikut të gjerë dhe grupeve të synuara
- Mungesa e njohjes së gjuhës shqipe nga pjesa më e madhe e stafit të huaj, që pengon ndjekjen e rregullt të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend

Shanset

- Numri i madh i studentëve shqiptarë që studiojnë në SHBA, Europë dhe në universitetet e shteteve të tjera të zhvilluara
- Anagazhimi i autoriteteve të Universitetit Epoka për të siguruar mbështetje dhe lehtësira për studentët dhe stafin që largohet dhe vjen
- Rritja graduale e numrit të programeve të ofruara nga universiteti
- Inicimi i programeve të doktoraturës
- Aprovimi i aplikimit ndaj programit FP7 dhe nisja e implementimit
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese
- Implementimi i lëvizjes së lirë të stafit dhe studentëve përmes përfshirjes në TEMPUS, CEEPUS, Erasmus Mundus, Bazileus, Socrates dhe programit FP7
- Rritja e një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet
- Rritja e vetëdijes së stafit dhe studentëve për rëndësinë e sigurisë së cilësisë
- Përmirësimi i kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm
- Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim drejt kërkimit
- Prezantimi i programeve të studimit në distancë
- Implementimi i programeve studimore double dhe minor në Universitet

- Prezantimi i programeve studimore duale në bashkëpunim me universitete të njohura jashtë shtetit
- Lidhja ndërmjet kurrikulave, kompetencave të fituara nga studentët dhe kërkesës së tregut
- Rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm
- Zhvillimi i infrastrukturës së të mësuarit on-line

Kërcënimet

- Rritja e globalizimit e shoqëruar me rritje të konkurrencës në tregjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë
- Ndikimi i krizës financiare globale në burimet financiare të publikut të gjerë dhe universitetit
- Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë
- Barra fiskale për universitetet private
- Numri i madh i universiteteve private në Shqipëri
- Të dhënat joreale të tregut të arsimit në Shqipëri
- Konkurenca jo e drejtë në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri

ANALIZA E PROGRAMEVE TE STUDIMIT :

1-Programi i studimit ne Arkitekture :

Departamenti i Arkitekturës

Misioni dhe objektivat e programit të studimit Arkitekturë

Qëllimi dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra dhe afatmesme dhe afatgjata

Universiteti Epoka ofron në fushën e Arkitekturës:

Programe studimi të ciklit të parë në Arkitekture në formën e studimeve me kohë të plotë në 4 vite akademike në përfundim të të cilave lëshohet diplomë e nivelit të parë DNP (Bachelor);

Programe studimi të ciklit të dytë në Arkitekture në formën e studimeve me kohë të plotë në 2 vite akademike në përfundim të të cilave lëshohet diplomë e nivelit të dytë DND (Master of Architecture)

Programe studimi të ciklit të tretë në Arkitekture në formën e studimeve me kohë të plotë në 1 vit akademik në përfundim të të cilave lëshohet diplomë Master i nivelit të dytë MND (Master of Second Level in Architecture)

Misioni i programit është të trajnojë profesionistë të kualifikuar me njohuri teorike dhe praktike në fushat estetike, teknike, ekologjike, ekonomike, kulturore, historike, sociale, mjedisore dhe kërkesa të tjera të nevojshme; si edhe aftësi për të punuar në projekte ndërdisiplinore.

Ky sistem studimi i programeve, sikurse pohohet edhe në RVB është konform me ato të sistemit Amerikan, si edhe të vendeve të tjera dhe nuk është ende i përshtatur me ndryshimet ligjore të sistemit shqiptar dhe atij Evropian të studimeve sipas programeve të studimit 3+2 ose 5 vite të integruar studimi me titujt Bachelor, MSC, etj. dhe studime të ciklit të tretë për doktoraturë. Megjithatë për të lehtësuar njehsimin me sistemin Shqiptar dhe me atë Evropian, kreditet janë llogaritur jo vetëm sipas sistemit Amerikan por edhe sipas atij Evropian. Studimet zhvillohen në gjuhën Angleze.

Nga këto tre cikle studimi në fushën e arkitekturës janë efektiv cikli i parë me 59 studentë dhe MND me 12 studentë.

Rekomandohet përshtatja me sistemin Evropian dhe atë Shqiptar për të lehtësuar integrimin e studentëve brenda zonës Evropiane, sikurse edhe për të eficientuar vitet e studimit nga ana e studentëve dhe shoqërisë në tërësi. Kjo do të kërkojë një proces të rishikimit të gjithë programit të studimeve i cili për një shtrirje pesëvjeçare, ose të segmentuar në dy cikle studimi do të duhet të parashikojë raporte specifike midis komponentëve kryesorë të edukimit në fushën e arkitekturës.

RVB nuk jep ndonjë qëndrim apo analizë në lidhje me përshtatjen e programit katër-vjeçar të studimit në programe sipas legjislacionit Shqiptar dhe Evropian në sistemin 3+2; ose 5 vite të integruar studimi. Edhe

pse në intervistat me titullarët e fakultetit të Inxhinierisë së ndërtimit dhe arkitekturës duket se ky është një opsion.

Struktura organizative e IAL, e njësive përbërëse dhe menaxhimi i tij

(E parë në raport kjo me arkitekturën)

Struktura didaktike e njësisë

Programi i studimit për arkitekturë mbulohet nga Departamenti i Arkitekturës që është njëri prej tre departamenteve në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Dy departamentet e tjera janë: Departamenti i inxhinierisë së Ndërtimit dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Në këtë fakultet bën pjesë gjithashtu edhe një njësi kërkimore: Qendra për Tërmetet dhe Teknologjinë e Ndërtimit.

Pranimet, Shpërndarja e studenteve në kurset dhe vitet e studimit, Ecuria e studimeve dhe kalueshmëria Numri total i studentëve të pranuar për studime në arkitekturë është 61. Nga këta 34 të pranuar në vitin 2009-2010 dhe 27 në vitin 2008-2009. Mesatarja e tyre në hyrje është mbi 8, që është një tregues shumë i mirë. Nga këta deri në vitin e hartimit të RVB, 59 prej tyre vazhdojnë ende studimet (të dhëna 12 maers 2010).

Nota mesatare e kalimit për vitin 2008-2009 ka qenë 2.23 dhe 2.03 përkatësisht në semestrat e vjeshtës dhe të pranverës (RVB fq, 52). Kalueshmëria në përqindje nuk është dhënë. Do të ishte më e përshtatshme që baza krahasimore e mesatares hyrëse dhe mesatares në fund të vitit akademik të jepej me sistemin prej 10 pikësh në mënyrë që të thjeshtësohet krahasimi dhe të ndiqet më mirë ecuria. Është e rekomandueshme që të përpunohen edhe të dhëna pjesore lidhur me cilësinë e notës dhe kalueshmërinë edhe në sezonet e përsëritjes së provimeve.

Në departamentin e arkitekturës aplikohen parakushtet në pranim.

Programi i studimit, organizimi i kurrikulave, Procesi i Bolonjës dhe kreditit

Qëllimi i programeve të studimit,

Bazuar në të dhënat e RVB Universiteti Epoka bazohet në sistemin Amerikan me kohëzgjatje normale të programeve 4 vjeçare me kohë të plotë. Ngarkesa mësimore në këto katër vite është 140 kredi amerikane ose 240 ECTS.

Llogaritja e ECTS ndjek udhëzimin 15 Dt. 04.04. 2008 për organizimin e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. 1 ECTS = 25 orë brenda dhe jashtë auditorit. Sasia e ECTS është e proporcionuar në mënyrë të drejtë me sasinë e orëve të zhvilluara brenda dhe jashtë auditorit. Me përjashtim të një rasti kur duket se sasia e krediteve është më e lartë në raport me numrin e orëve brenda dhe jashtë në auditor. (Kodi i lëndës ARCH311, FQ 171)

Përmbajtja e programeve

Misioni i programit të studimit është shprehur me gjerësinë e duhur që përmban profesioni i arkitektit duke përfshirë njohuri teorike dhe praktike të fushave estetike teknike, ekologjike, ekonomike, kulturore, historike, sociale mjedisore dhe të tjera. si edhe aftësi për të punuar në projekte ndërdisiplonore. Në lidhje me strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata këto nuk janë qartësisht të dallueshme në RVB

Si pasqyrohen këto në planin mësimor?

Ky është një rast tipik kur programi i studimeve në arkitekturë është pjesë e universitetit politeknik dhe kurrikula e studimit ka një drejtim të theksuar teknik dhe inxhinierik. Në këtë kuptim kurrikula e studimit mund të synojë të balancojë më mirë lëndë të karakterit teknik me ato të karakterit konceptual, artistik, analitik të lidhura drejtpërdrejtë me arkitekturën; sikurse edhe me lëndë nga shkencat humane sociale e mjedisore në mënyrë që të arrihet formimi i plotë për arkitektët sikurse është shkruar në misionin e programit të studimit nga vetë IAL. Kjo rregullohet deri në një farë mase nga fakti që universiteti ofron një liste të gjerë të lëndëve me përzgjedhje, por këto janë përsëri kryesisht të karakterit teknik.

Në përputhje me misionin e programit të studimit të paraqitur në RVB, kurrikula mund të marrë parasysh përfshirjen e një variacioni më të madh të lëndëve me karakter nderdipslinor nga fushat e përmendura në misionin e programit të studimit. Kjo mund të mbahet parasysh veçanërisht gjatë hartimit të kurrikulave të studimeve nëse do të kalohet në programe me sistemin 5-vjeçar apo 3+2.

Sylabuset për çdo disiplinë janë të paraqitura qartë dhe me elementët e nevojshëm për informimin e studentëve. Përveç elementeve që shprehin modalitetet e organizimit semestral të lëndës si numrin e orëve teorike apo praktike në çdo javë, kreditet, kodin e lëndës, etj. ato përmbajnë edhe temat që do të trajtohen nga ana e pedagogut si edhe literaturën e nevojshme.

Organizimi i vitit mësimor, semestrat,

Viti mësimor është i organizuar nëse 2 semestra. Bazuar në sistemin Amerikan semestrat kryesorë janë ato të vjeshtës dhe të pranverës. Secili prej semestrave ka kohëzgjatjen prej 15 javësh.

Stafi mësimdhënës dhe mbështetës

Struktura e stafit mësimor dhe mbështetës në kurrikulën e Arkitekturës dhe Raportet staf mësimor / staf ndihmës / student; Nevojat për staf; Shkalla e kualifikimit të stafit, Cilësia e stafit, Marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit

Arkitektura është një departament në fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit. Numri total i stafit mësimdhënës me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme bazuar në të dhënat e paraqitura nga RVB për departamentin e arkitekturës është 12; ndërsa numri i studentëve 60. Numri i studentëve për një pedagog (përfshi edhe ata me kohë të pjesëshme) qëndron në raportin 1:5. Numri i stafit me kohë të plotë për departamentin e Arkitekturës është 9. Numri i studentëve për një pedagog (vetëm ata me kohë të plotë) qëndron në raportin 1:6,6. Në të dy rastet kemi një raport mjaft të mirë dhe të balancuar.

Ndër këta pedagogë katër janë me tituj: 1 Prof dhe 4 Prof Asoc si edhe 6 të tjerë me M.Arch. Stafi me kohë të plotë është i angazhuar vetëm në Universitetin Epoka, ndërsa stafi me kohë të pjesshme vjen nga universitete të tjera në përputhje me marrëveshje me këto institucione.

Shpërndarja e ngarkesës

Bazuar në të dhënat e ofruara nga RVB tek ngarkesa mësimore për çdo javë për secilin pedagog, rezultojnë se për çdo javë mësimore në semestrin e vjeshtës realizohen në total 60 orë mësimore nga 6 pedagogë me kohe te plote kundrejt 22 orëve të zhvilluara nga 3 pedagogë me kohë të pjesshme (raporti 1:2.7 në favor të pedagogëve me kohë të plotë). Ngarkesa e mesatarizuar javore sikur çdo pedagog i brendshëm të zhvillonte të njëjtën sasi orësh do të ishte 10 orë mesatare javore, ndërsa ajo reale varion nga 3 orë për pedagogun me më pak ngarkesë në 20 orë javore për pedagogun më të ngarkuar.

Ndërsa në semestrin e pranverës realizohen në total 72 orë mësimore nga 8 pedagogë me kohe te plote kundrejt 20 orëve nga 3 pedagogë me kohë të pjesshme (raporti 1:3,6). Ngarkesa e mesatarizuar javore sikur çdo pedagog i brendshëm të zhvillonte të njëjtën sasi orësh do të ishte 9 orë mesatare javore, ndërsa ajo reale varion nga 3 orë për pedagogun me më pak ngarkesë në 15 orë javore për pedagogun më të ngarkuar.

Raporti i orëve midis pedagogëve me kohë të plotë dhe atyre me kohë të pjesshme duket mjaft i arsyeshëm në të dy semestrat. Por shpërndarja e ngarkesës midis pedagogëve mund të jetë më e balancuar në semestrin e vjeshtës.

Kritere të rekrutimit të stafit

Për rekrutimin e stafit ka procedura të shkruara të cilat përfshijnë që nga shpallja e njoftimeve për vendet e lira të punës, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, e deri tek ngritja e komisionit të vlerësimit, përbërja e tij, organet që marrin vendim si edhe shpallja e rezultatit dhe kontraktimi.

Mësimdhënia

Organizimi, Format e mësimdhënies

RVB tregon dy mënyra të mësimdhënies: Teorike ku përfshihen leksionet; dhe praktike ku përfshihen seminarët, labororet dhe praktikat

Nga planet mësimore duket se raporti midis oreve praktike dhe atyre teorike është i balancuar.

Kërkimi shkencor

Politika e kërkimit, Botimet në vite, Projektet e fituara dhe të realizuara, Pjesëmarrja në aktivitete brenda dhe jashtë vendit, Aktivitete të organizuara nga njësi, Bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, Lidhja e kërkimit me mësimdhënien

Në IAL sikurse raportohet në RVB ka një politikë të kërkimit shkencor. Po ashtu ekziston qendra kërkimore e cila ka disa njësi. Sa i takon departamentit të arkitekturës kjo lidhet më shumë me “qendrën kërkimore për tërmetet dhe teknologjinë ndërtimore”. Kjo qendër sikurse raportohet ka qëllime dhe objekte të mirëartikulurara, por nuk jepen rezultate konkrete të këtyre kërkimeve, apo botime në lidhje me arkitekturën; ndërsa ka publikime të mjaftueshme në lidhje me tema nga inxhinieria e ndërtimit. Në këtë drejtim mund të konsiderohet si një hap shumë i mirë themelimi i laboratorit për tërmetet dhe teknologjinë ndërtimore. Funksionimi i laboratorëve mundëson që një pjesë e ligjëratave të mbahen në laboratorët përkatës. Në lidhje me sa më sipër do të ishte e rekomandueshme që IAL në të ardhmen të shfrytëzojë më mirë njësinë kërkimore si edhe bazën laboratorike për punime konkrete shkencore sidomos të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e arkitekturës dhe jo vetëm të inxhinierisë.

Në lidhje me temën e tërmeteve është organizuar seminar ndërkombëtar mbi tërmetet dhe strukturat. Po ashtu është organizuar edhe seminari me temë “të mësohet nga ndërtimet urbane islamike mesdhetare”.

IAL ka një sistemin shumë të mirë për kriteret e vlerësimit akademik të aktivitetit individual. Ky vlerësim bëhet përmes një sistemi pikësh të bazuar në kriteret. Ky sistem përdoret edhe si kriter për punësim.

Procedurat e pranimit të studentëve dhe zbatimi i tyre, Statistika

Në RVB pohohet se pranimi i studentëve bëhet mbi bazën e rregullave të përcaktuara nga Senati dhe në bazë të statutit, Rregullores dhe udhëzimeve. Ky proces drejtohet nga Zyra e Promovimit të Studentëve. Në vlerësimin e kandidatëve konsiderohen rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore përfshi edhe ato me përzgjedhje, rezultatet e marra në lëndët që lidhen me departamentin ku është aplikuar, cilësia e kurrikulave të shkollës së mesme të kandidatit, nota mesatare, renditja në shkollën ku ka përfunduar studimet, aftësia në fushën e kërkuar për të studiuar e mbështetur kjo me certifikata, letra reference të lëshuara nga pedagogë të shkollës së mesme.

Regjistrimi mund të kryhet nëse kandidati është fitues në provimin e pranimit të universitetit Epoka; ose me kriteret pikësh të vendosura për teste të ndryshme, si edhe për mesatare mbi 8 nga shkolla e mesme. Kandidatët i nënshtrohen gjithashtu edhe provimit të gjuhës angleze të organizuar nga universiteti.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë

Institucionalizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë, Funksonimi i tij, Vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, Rezultatet e vlerësimeve të jashtme

Sikurse raportohet në RVB, IAL ka ngritur disa mekanizma për të garantuar kontrollin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Këshilli i vlerësimit akademik dhe përmirësimit të cilësisë (KVAPC) është organi përgjegjës për sigurimin e cilësisë brenda Universitetit. Veprimtaria është e rregulluar me direktiva dhe rregullore të brendshme.

Duke filluar nga viti 2008 puna e stafit akademik është vlerësuar nga studentët në fund të çdo semestri përmes anketës lidhur me vlerësimin e lëndës dhe të pedagogut. RVB pohon se këto të dhëna analizohen dhe shpërndahen stafit, si edhe merren parasysh në rinovimin e kontratave. Në kapitullin e RVB ku flitet për këto mekanizma jepen parime të përgjithshme dhe një rregullore lidhur me funksionimin e tyre, por nuk jepen rezultate konkrete, të dhëna, interpretime statistikore mbi këto të dhëna apo edhe ndonjë eksperiencë direkte lidhur me impaktin konkret që këto organizma kanë dhënë lidhur me garantimin e cilësisë. Në intervistat me studentët që pati GVJ, ata pohojnë se plotësojnë rregullisht formularët e vlerësimit në fund të çdo sezoni dhe se ata i plotësojnë ato në mënyrë anonime dhe me vullnetin e tyre e pa ndërhyrje nga të tjerë. Sipas tyre ky është një mjet efikas për të përçuar idetë e tyre. Sipas RVB në fund të çdo viti akademik përgatitet raporti i vetëvlerësimit i cili dorëzohet Këshillit të lartë dhe mbi bazën e të cilit kryhet auditi i brendshëm.

Rekomandohet që të dhënat e perfituara nga KVAPC të analizohen dhe të bëhen pjesë më e drejtpërdrejtë e menaxhimit akademik dhe administrativ të IAL. Njësia e cilësisë do të duhej të dilte me rekomandime konkrete lidhur me nevojën e përmirësimeve dhe përsosjes së vazhdueshme që janë pjesë e jetës së çdo organizate. Në këtë aspekt institucioni duhet të forcojë më shumë aftësitë vetëkritike. Kjo frymë nuk dallohet as në RVB as edhe në intervistat me GVB apo edhe në departament. Fryma vetëkritike nuk duhet konsideruar si gabim.

Lidhur me garantimin e cilësisë ka disa standarde shumë të mira të aplikuara nga IAL që duhet të përmenden si psh.: pranimi i studentëve me mesataret hyrëse mbi 8; aplikimi iparakushteve si kalimi në semestrin e pestë vetëm nëse mesatarja e përgjithëshme është mbi 1.8

Aspekt shumë pozitiv në aspektin e cilësisë është certifikimi me standardin ISO 9001: 2008 mbi sistemet e menaxhimit të sistemeve të sigurimit të cilësisë, sikurse edhe vazhdimin e procesit për certifikimin me ISO 14001 dhe 18001 OHSAS

Qëndrimi ndaj të dhënave të paraqitura në RVB për Arkitekturën

Raporti paraqet një nivel të mirë të të dhënave, misionit, objektivave, si edhe të parimeve dhe rregullave të brendshme të Universitetit Epoka. Këto të dhëna tregojnë për një punë të vazhdueshme dhe

sistematike të mbledhjes së tyre. Nga intervistat me titullarët e institucionit, anëtarët e GVB si edhe me studentë rezulton se këto të dhëna janë të vërteta dhe të mbledhura me transparencën e duhur. Me këtë bazë të dhënash do të ishte mirë që të kishte një nivel më të thelluar të analizave dhe të reflektimit të tyre mbi menaxhimin akademik dhe organizativ të institucionit.

Lista e personave të intervistuar

Takimi me Rektorin dhe me titullarë të tjerë të institucionit

Takimi me të gjithë anëtarët e GVB

Takimi me Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë

Takim me të gjithë stafin e Departamentit të Arkitekturës

Takim dhe intervista me studentë të ndryshëm

2-Programi i studimit në Inxhinieri Ndertimi

Sikurse është përmendur edhe më sipër, Departamenti i Inxhinierisë së Ndertimit ofron programe studimi universitare dhe pasuniversitare në Inxhinieri Ndertimi. Programi i studimeve universitare zhvillohet për një periudhë katërvjeçare dhe në përfundim të tij studentët diplomohen me titullin Bachelor në Inxhinieri Ndertimi. Deri më sot në këtë program studimi janë pranuar 76 studentë, por ndërkohe ende nuk ka të diplomuar. Brezi i parë i studentëve pritet të diplomohet përkisht në këtë vit akademik.

Ky program studimesh ka për qëllim që të edukojë studentët me njohuri baze të shkencës dhe teknikut në mënyrë që ata të mund të ofrojnë zgjidhje për problemet inxhinierike dhe të përmirësojnë aftësitë në përdorimin e programeve kompjuterike, si dhe të zhvillojnë aftësitë komunikuese dhe kërkuese e hulumtuese të tyre. Kryesisht, ky program synon dhe ka për qëllim që:

- Trajnimi i studentëve të këtyre përmbajtjeve teorike në shkencat bazike dhe inxhinierike dhe t'i pajisë me aftësitë e nevojshme teknike;
- Të zhvillojë aftësitë e studentëve në lexim, shkrim dhe komunikim me gojë;
- Të inkurajojë punën në grup, bashkëpunimin dhe zhvillimin e shkathtësive ndërpersonale;
- Të nxjerrë të diplomuar për komunitetin e biznesit dhe inxhinierisë të pajisur me ndershmëri, vendosmëri, gjyqeshmëri, motivim, aftësi dhe arsim për të marrë përsipër rol udhëheqës për të përmbushur sfidat e kërkuara nga shoqëria;
- Të motivojë studentët për të kontribuar në përparimin e shkencës dhe teknologjisë.

Kurrikula e studimeve universitare në degën e Inxhinierisë së Ndertimit është përgatitur në përputhje me sistemin mesimor amerikan dhe është përshtatur me sistemin evropian, duke shfrytëzuar edhe përvojën e vendit tonë. I gjithë programi mesimor zhvillohet në tërësi në tetë semestra (katër vite kalendarike) dhe në çdo semester zhvillohen gjashtë lende.

Dy vitet e para të programit të studimeve të ciklit të parë i kushtohen kryesisht studimit të shkencave themelore si analiza matematike, fizika e përgjithshme apo kimia e përgjithshme të cilat e përgatisin studentin për të përvetësuar bazat e inxhinierisë. Më tej, i gjithë programi mesimor zhvillohet në gjuhën angleze, në vitin e parë i kushtohet një vëmendje e madhe zhvillimit të aftësive të

leximit dhe shkrimit ne kete gjuhe. Nderkohe, studenti merr njohuri ne shkencen e kompjuterave dhe ne gjuhete e programimit, rreth teknoplogjise se informacionit apo ne vizatimin teknik, si dhe hedh hapin e pare ne fushen e inxhinierise se ndertimit nepermjet lendes “Hyrje ne Inxhinierine e ndertimit”. Ne vitin e dyte krahas thellimit ne analizen matematike apo thellimeve ne matematiken per inxhinier, fillon edhe studimi i lendeve baze per inxhinierine e ndertimit, sic jane mekanika inxhinierike apo shkenca e materialeve te ndertimit. Permendim ketu se per here te pare studenti njihet me konstruksionet e ndertimit nepermjet lendes “Hyrje ne lendet e Konstruksionit”. Ne perfundim te ketyre dy viteve studenti duket te jete i formuar dhe i gatshem per t’u thelluar ne lendet profesionale te inxhinierise se ndertimit. Krahasuar me kurrikulen e programit e ciklit te pare te studimeve ne degen e ndertimit, ne Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit te Universitetit Politeknik te Tiranës, ky program duket se ofron nje hyrje me te studiuar ne lendet profesionale. Studenti jo vetem qe ka me shume kohe ne dispozicion per te hedhur bazat ne shkencat themelore, por nepermjet lendeve te tilla si “Hyrje ne Inxhinierine e Ndertimit” apo “Hyrje ne Lendet e Konstruksionit” pergatitet me gradualisht per te kaluar ne lendet profesionale inxhinierike. Te dy programet duket se kane ngjashmeri ne sidomos ne formimin qe ofrojne per shkencat themelore si matematika, fizika apo kimia, por nderkohe programi i studimeve ne Universitetin ‘EPOKA’ ofron edhe njohuri te shtese sic jane “Probabiliteti dhe Statistika per Inxhinier” apo “Matematika per Inxhinier”, lende qe kurrikula e Fakultetin te Inxhinierise se Ndertimit te Universitetit Politeknik te Tiranës i ofron vetem ne ciklin e dyte te studimeve (Master Shkencor). E rendesishme eshte te nenvizojme edhe prezencen ne kurrikul te lendeve te tilla si “Zhvillimi i Aftesive te Prezantimit Gojor”, qe per fat te keq nuk ekzistojne ne kurrikulen tradicionale te deges se inxhinierise se ndertimit ne Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit te Universitetit Politeknik te Tiranës. Nga pervoja shumevjcare e punes me studentet, mendoj qe kjo eshte nje lende mjaft e rendesishme, pasi i pergatit studentet qe te prezantojne ne menyre te qarte dhe dinjtoze studimet apo punet e tyre. E rendesishme eshte jo vetem te punosh ne menyre te vazhdueshme por edhe te trasmetosh sa me qarte rezultatet e punes se kryer. Mendoj se nje disipline e tille jo vetem qe qendron mire ne kurrikulen e prezantuar por mund te sherbeje edhe si nje shembull qe ajo te futet edhe ne kurrikulat e ngjashme te universiteteve te tjera.

Viti i trete dhe i katert perfshin studimin dhe aplikimin e parimeve te inxhinierise gjeoteknike, strukture, hidraulike dhe problemeve te pergjithshme te sistemeve inxhinierike. Pasi ka marre formimin baze studenti tashme prezantohet me disa lende te formimit te metejshe inxhinierik si “Mekanika e Strukturave”, “Analiza e Strukturave”, “Mekanika e Dherave” apo “Mekanika e Lengjeve” dhe me tej vazhdojne me lendet baze aplikative ne fushen e konstruksioneve betonarme apo metalike sic jane “Inxhinieria e Themeleve”, “Bazat e Betonarmese”, “Bazat e Projektimit te Celikut”. Nepermjet ketyre lendeve aplikative hidhen bazat e pergatitjes per projektim te strukturave te ndryshme te ndertimit e cila plotesohet edhe me perdorimin e metodave kompjuterike ne inxhinierine e ndertimit. Gjithashtu, studentet marrin njohuri edhe per projektimin e strukturave rezistuese ndaj termeteve nepermjet lendes “Hyrje ne Projektimin Rezistent ndaj Termeteve”. Ne keto dy vite studentet kane mundesi qe te ndjekin edhe programe ne lidhje me hyrjen ne zbatimin e ndertimit dhe menaxhimin ekonomise, te cilat jane thelbeshore per cdo inxhinieri te aplikuar. Per t’u vleresuar eshte futja ne planin mesimor te lendes “Praktika Verore I+II” e cila krijon mundesine e konkretizimit ne praktike te dijeve te marra ne auditor gjate procesit mesimor. Ne keto dy vite studentit i ofrohen edhe nje sere lendesh me zgjedhje, duke krijuar mundesine e orientimit sipas deshires apo interesave ne fusha te ndryshme te projektimit apo zbatimit.

Qellimi i Departamentit të Inxhinierisë së Ndertimit është të përgatisë studentët që të hyjnë si një forcë moderne në fushën e inxhinierisë së ndertimit dhe të jenë të suksesshëm në karrierën e tyre profesionale duke synuar të bëhen liderë të ardhshëm të këtij profesioni. Ai synon formimin e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në fushën e ndertimit si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik për projektimin dhe zbatimin e objekteve inxhinierike.

Diplomimi në degen e Inxhinierisë së Ndertimit kërkon grumbullimin e minimalisht 160 krediteve dhe 60 ditë të praktikës profesionale të miratuar që përfshin 20 ditë pune në një studio projektimi dhe 40 ditë pune në terren. Në çdo semester studenti përfaton afërsisht 20 kredite sipas sistemit amerikan ose rreth 30 kredite të konvertuara ETCS.

Duke analizuar me kujdes programin Bachelor në Inxhinieri Ndertimi dhe strukturën e tij konstatohet se ai është projektuar me kujdes dhe në përputhje me misionin e Universitetit EPOKA, jo vetëm për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të brendshëm shqiptar por edhe për të synuar tregjet e huaja e sidomos ato të rajonit përreth. Mendoj se programi i ofruar duke u zhvilluar në gjuhën angleze dhe me shtrirjen e tij në katër vite akademike do të rezultojë në një produkt cilësor dhe në të ardhmen do të bëhet një pikë referimi e rëndësishme e shkencës të inxhinierisë së ndertimit.

Për realizimin e programit në degen e Inxhinierisë së Ndertimit është angazhuar një sataf akademik cilësor, nga të cilët 11 janë pedagogë me kohë të plote dhe 6 pedagogë të tjerë me kohë të pjesshme apo të ftuar me kontratë. Nga pedagogët me kohë të plote dy janë me titull Prof., një Prof. As., katër Dr. dhe katër lektore. Ndërsa nga staf i ftuar me kontratë një është me titull Prof., tre Dr. dhe dy lektore.

Procesi mesimor realizohet kryesisht në kampusin qendror (ndertesa e re) i cili ofron mjedise të bollshme dhe kushte të përshtatshme fizike në të gjitha auditoret apo ambientet e punës. Në të gjitha auditoret e Universitetit EPOKA përdoren kompjutera, projektore dhe smart boardet në metode të mesimdhënies. Procesi mesimor në degen e Inxhinierisë së Ndertimit mbështet edhe nga tre laboratore që janë: Laboratori i Materialeve të Ndertimit, Laboratori i Gjeoteknikës dhe Laboratori i Mjeteve Matese. Megjithatë të reja këto laboratore ato numërojnë një sërë pajisjesh për realizimin e provave në fushat e përmendura dhe pritet që numri i pajisjeve testuese të shtohet. Ndërkohe, përveç funksionit të tyre për mbështetjen e procesit mesimor këto laboratore i shërbejnë edhe kerkimit shkencor të stafit akademik. Universiteti Epoka jep mundësinë për të gjithë pedagogët dhe studentët që të përdorin një bibliotekë moderne si dhe burimet e saj. Mund të thuhet se në Universitetin Epoka infrastruktura teknologjike dhe teknologjia e informacionit përdoren në nivelin më të lartë.

Nga analiza e bërë më sipër për Programin e Studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndertimi", jam i mendimit se mund të vecohen këto pika të forta:

Se pari, mesimdhënia në anglisht krijon mundësi për një mbështetje të procesit mesimor me tekste baze me një nivel të lartë dhe të shkruara nga autorë të njohur. Gjithashtu, studentët që gjatë kryerjes të studimeve universitare ambientohen me termat teknike në gjuhën angleze e cila është bërë tashmë një gjuhë e domosdoshme për ushtrimin e profesionit në fushën e ndertimit. Për studentët e këtij universiteti do të jetë më i lehtë edhe studimi, përvetësimi dhe përditesimi i Eurokodeve edhe nga versioni original i tyre në gjuhën angleze.

Se dyti, cilësia e lartë e kurrikulave të ofruara të programit të studimit të cilat jo vetëm janë hartuar mbi bazën e përvojës amerikane (tashmë e provuar si mjaft e suksesshme në fushën e ndertimit)

por edhe transmetohen per studentet nga nje staf akademik mjaft cilesor. Mendoj se nje nga perparsite e kurrikules se ofruar per studimet universitare ne degen e ndertimit eshte edhe shtrirja e saj ne kater vite akademike. Kjo ben qe studenti te marre jo vetem me shume njohuri (rreth 240 kredite) por te kete edhe nje pervesitim me te qendrueshem te dijeve te marra. Mendoj qe nje perparsi e tille jo vetem te ruhet por edhe te sherbeje si shembull per korrigjimin e kurrikulave te ngjashme ne universitete te tjera.

Se treti, infrastruktura e pershtatshme dhe ambientet komode ndihmojne ne realizimin me cilesi te programit te studimit. Implementimi i planit per ndertimin e kampusit qendror brenda nje periudhe te shkurter tregon se Universiteti EPOKA ka perparsi rritjen e vazhdueshme te cilesise te mesimdhenies, pavaresisht koston qe paguan per t'a arritur ate.

Sidoqofte duke analizuar me kujdes strukturen e Programit te Studimit Bachelor ne "Inxhinieri Ndertimi", jam i mendimit se mund te behen edhe disa permiresime ne funksion te zbatimit sa me te plote te tij:

Se pari, mendoj se ka nevojte per nje dimensionim edhe me te qarte te te gjitha programeve te lendeve mbi bazen e Eurokodeve Strukturore. Ne vizionin e zhvillimit te ketij universiteti eshte parafrimi me modelin amerikan, qe eshte dhe do te jete edhe ne te ardhmen nje perparsi shume e madhe nese gershetohet edhe me pervojat e perparuara europiane. Prandaj, Departamenti i Inxhinierise se Ndertimit duhet te beje sa me shpejt zgjedhjen e tij konkrete mbi modelin europian qe deshiron te imitoje si dhe te zgjedhi partneret e tij me te afert te bashkepunimit. Parafrimi i Programit Bachelor me ato te universiteteve te huaja europiane do te jape mundesine e prezantimit dhe njohjes nderkombetare te ketyre diplomave, dhe pse jo, te shikohet edhe mundesia e dhenies se **Diplomave double-degree**, si diploma te leshuara nga Universiteti EPOKA dhe ndonje tjeter partner ne Europe apo gjetke.

Se dyti, mendoj se pavaresisht nivelin te larte te mesimdhenies qe ofrohet nga stafi akademik i ketij departamenti do te ishte e nevojshme nje profilizim i qarte i ketij stafi ne fusha te caktuara. Ky perqendrim dhe fokusim ne problematikat e nje fushe te caktuar patjeter qe do te rriste edhe me tej nivelin e mesimdhenies.

Se treti, mendoj se planet mesimore mund te kompakesohen duke parashikuar ne te lende me jo me pak se 5 apo 6 kredite ETCS. Kjo do te krijonte mundesine qe plani mesimor te zhvishet nga lendet e teperta dhe nderkohe cdo lende e parashikuar te kete nje peshe te rendesishme ne realizimin e ketij programi studimesh.

1. Analiza e programeve te lendeve mesimore/syllabeve

Ne programet Bachelor, Universiteti EPOKA ka si objektiv formimin universitar te nivelit shume te larte profesional. Lendet zhvillohen duke u orientuar kryesisht drejt formimit teoriko-praktik, qe con ne nje profesion me nivel shume te larte kualifikimi universitar, qe njihet apo ka prirje te njihet e licensohet nga tregu i punes lokal apo global.

Duket se gjithcka pasqyrohet qartesisht ne Programet mesimore te lendeve/Syllabus-et, per te gjitha lendet e Pogramit bachelor ne "Inxhinieri Ndertimi". Syllabus-et e te gjitha lendeve te ketij programi universitar jane ndertuar sipas nje modeli/template te strukturuar mire ne te cilin jane parashikuar te gjitha ceshtjet me te rendesishme te mbulimit te lendeve, sic jane: permbajtja e shkurter/synopsis dhe qellimet e lendes , tematika e ceshtjeve te trajtuara ne forme problemore, nocionet themelore te lendes, rezultatet e pritshme/aftesimi i studenteve, ceshtje themelore te debatueshme bashkekohore te lendes,

metodat dhe teknikat pedagogjike te mesimdhenies, tekstet baze dhe literatura perkatese e rekomanduar, si dhe menytrat e kontrollit te dijes se studenteve. Vihet re se nje rendesi e madhe i kushtohet vleresimit ne vazhdimesi gjate gjithë periudhes se zhvillimit te lendes dhe jo vetem ne provimin perfundimtar. Kjo menyre vleresimi mendoj qe eshte shume e pershtatshme dhe ndihmon studentet ne pervetsimin e qendrueshem te dijeve.

Pra, konstatojme se gjithcka, eshte ne rregull me permbajtjen e lendeve te parashikuara nga plani mesimor. Megjithate, dua te perseris edhe nje here mendimin tim te shprehur pak me lart se planet dhe programet mesimore mund te permiresohen vazhdimisht, duke konsideruar kompaktesimin e tyre sikurse e kam shenuar me siper dhe pasurimin e panderprere te tyre.

2. Konkluzione dhe rekomandime perfundimtare

- Duke shqyrtuar dhe vleresuar ne shume kujdes dhe objektivet te gjitha arritjet e deritanishme te Universitetit EPOKA, dhe ne vecanti cilesine e programit Bachelor ne “Inxhinieri Ndertimi”, dhe te standarteve te perparuara te tij, duke vleresuar dhe respektuar te gjitha burimet e kualifikuara akademike mesimore dhe shkencore te tij si dhe resurset e pasure te infrastruktures, teknologjise, dhe informacionit qe ofron ky universitet, jam I bindur dhe do te rekomandoja seriozisht APAAL qe ketij univeristeti t’i jepet pa hezitim akreditimi per Programin Bachelor ne “Inxhinieri Ndertimi”;
- Komentet dhe sugjerimet e paraqitura ne kete Draft-raport per permiresimin e metejshme te kurrikulave te ketij programi studimi jane dhene me deshiren e mire per persosjen e modernizimin e metejshem te ketij programi dhe nuk cenojne standartet e larta qe ofron ky universitet ne Programin Bachelor ne “Inxhinieri Ndertimi”, prandaj nuk duhet as te pengojne dhe as te vonojne dhenien e akreditimit ketij programi.

3-Programi i studimit ne Inxhinieri e Kompjuterave

1.Përshkrimi i programit të studimit.

Programet e studimit të IAL “Epoka University” për fushën e Inxhinierisë së Kompjuterave kanë këto karakteristika:

1. Janë në përputhje me kornizën ligjore në Republikën e Shqipërisë,
2. Janë në përputhje me standartet ndërkombëtare,
3. Janë të përshtatshme për ciklin e parë të studimeve të larta (ndonëse kohëzgjatja është 4 vite akademike),

4. U bëhen të njohura studentëve me fillimin e çdo viti akademik.

2. Misioni i Programit te studimit

Eshtë formimi i të diplomuarve të ciklit të parë me baza të mjaftueshme teorike dhe me bagazh shumë të mirë praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e Inxhinierisë së Kompjuterave.

3.Objektivat Programit te studimit

Janë “pajisja” e të diplomuarve të ciklit të parë me njohuri të shëndosha në:

1. programim (tradicional, të orientuar nga objekti dhe për zbatime informatike të gjithanëshme),
2. inxhinieri rrjetash kompjuterike,
3. aplikimesh Web dhe Baza të Dhënash,
4. projektim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit.

4.Standardet akademike.

Shumë të mira.

5.Standardet e programeve.

Shume të mira.

6.Standardet e planit mësimor.

- Në semestrin e parë, zhvillohen **5 lëndë** mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e dytë, zhvillohen **5 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e tretë, zhvillohen **6 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e katërt, zhvillohen **6 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e pestë, zhvillohen **6 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e gjashtë, zhvillohen **6 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e shtatë, zhvillohen **5 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).
- Në semestrin e tetë, zhvillohen **5 lëndë** lëndë mësimore (30 ECTS).

Formimi përmban 240 ECTS.

7.Studentët e programit te studimet , pranimet etj

Kryhen sipas rregullores së brendshme me dosje dhe intervistë. **E meta në procesin e regjistrimit të studentëve është moszbatimi i mbylljes se procesit të regjistrimeve 1 ose 2 javë pas fillimit të çdo semestri.**

8.Programi i studimit.

Jepet në libretin e IAL në formë shumë të qartë dhe në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.

9.Leksionet/ Seminaret

Në përputhje me standartet kombëtare dhe udhezimet e MASH-it.

10.Stafi Mësimdhënës dhe mbështetës në program

Vendas dhe i huaj me një nivel shumë të mirë pedagogjik dhe shkencor.

11.Mësimdhënia

Bashkëkohore.

12.Teknikat e mësimdhënies

Bashkëkohore me një bazë të mirë laboratorike.

13.Vlerësimi i dijeve të studentëve

Realizohet me kontroll të vazhduar dhe provim përmbyllës, duke i dhënë mundësinë studentit të kërkojë sqarime dhe rishikim të vlerësimit, sipas procedurave shumë rigorozë institucionale. Hedhja e rezultateve bëhet në menyre elektronike dhe studentët i njohim mënyrat e vlerësimit para fillimit të semestrit.

II SEKRETARIA MESIMORE

Tërësisht e informatizuar, por duhat mbajtur parasysh vërejtja e pikës 7.

III KERKIMI SHKENCOR

Ndonëse IAL është me historik disa vjeçar është prioritet për personelin e tij. “Epoka University” ka strategji të qartë të zhvillimit të R&D dhe ndjek politika nxitëse për promovimin e Kërkim – Zhvillimit.

IV BIBLIOTEKA

Bashkëkohore, e pajisur me tituj dhe botime të kohëve të fundit me një fond në zhvillim të vazhdueshëm.

V SISTEMI I BRENDSEHM I SIGURIMIT TE CILESISE

Funksional dhe i rëndësishëm për institucionin. Pjesmarrja e studentëve sipas një skeme origjinale dhe efikase.

VI ANALIZA SWOT

Pika të Forta

Objektiva të qarta zhvillimi. Kampus i dedikuar. Formim profesional cilësor. Personel i dedikuar dhe me përvojë të mirë.

Pikat e dobëta

Nuk ka vërtetuar ende formimin profesional cilësor në tregun e punësimit.

Rreziqet

Konkurenca e madhe në fushat e veprimtarisë së tij dhe tarifat praktikuara të shkollimit.

Mundësitë

Të mira për një zhvillim të qëndrueshëm.

4-Programi i studimit ne Ekonomiks

Misioni, qëllimi dhe objektivat

Misioni kryesor i programit të studimit bachelor në Ekonomiks është përgatitja e ekspertëve dhe specialistëve cilësorë të aftë të unojnë në administrarën publike, sektorin privat dhe organizatat jo qeveritare si brenda vendit ashtu edhe ne mjedisin nderkombetar. Studentet e këtij programi synohet të përftojnë njohuritë e nevojshmëe për tu punësuar brenda dhe jashtë vendit për shkak të formimit teorik, njohurive për ekonominë shqiptare, kontabilitetin, ligjeve përkatse, dhe njohurive teorike ne ekonomine nderkombëtare.

Me përfundimin e programit përkatës synohet që studenti të pajiset me një bashkësi kompetencash si:

- Aftësia për të parë problemet e përditshme me një këndvështrim më të gjerë, duke përfituar shprehi të nevojshme që mundësojnë kuptimin e problemeve ekonomike dhe të ndërtojnë modele të cilat funksionojnë.
- Aftësia për të përdorur teoritë bazë dhe instrumentat ekonomike për të zgjidhur problemet e shfaqura në fushën e ekonomiks.
- Aftësia për të përdorur programet kompjuterike si në prodrimin e përditshëm administrativ ashtu dhe për vlerësimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore ne sektorin publik dhe privat.
- Zotërimi i një bashkësie solide dhe të gjere njohurish në mikroekonomi, makroekonomi, ekonomiks nderkombëtar, dhe medoda matematikore dhe statistikore në ekonomi.

Organizimi dhe vendimmarrja

Departamenti i Ekonomiksit paraqitet në organigramën e Universitetit si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonimike dhe Administrative së bashku me Departamentin e Financës dhe Bankave, Departamentin e Administrimit dhe Biznesit, Departamentin e Shkencave Politike dhe Mardhënjeve Ndërkombëtare”. Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti kryesor drejtues në departament. Vendimmarrja realizohet në linjë vertikale ku politikën kryesore të zhvillimit dhe rekomandimet me karakter strategjik i merr Bordi më i Lartë, ndërsa drejtimi dhe vendim-marrja realizohet nga organet

drejtuese si Senati Akademik, Bordi Administrativ, Këshillat e Fakulteteve, Bordi i Etikës dhe autoritetet drejtuese Rektori, Dekanët dhe Përgjegjësit e departamenteve.

Programi Baçelor në Ekonomiksi realizohet nga Departamenti Ekonomiksitt, i cili bashkëpunon ngushtë me departamentin e Finacës, departamentet e tjera dhe me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave për realizimin e praktikës profesionale.

4.3 Analiza e programeve të studimit

Departamenti i Ekonomiksitt ofron diplomë bachelor në ekonomiks. Programet ofrohen me kohë të plotë me kohëzgjatje 4 vite akademike, të organizuara në tetë semestra me 15 javë seicla, me gjashtë lëndë për çdo semester. Studenti në përfundim të programit fiton të paktën 240 ECTS dhe pajiset me një diplomë të nivelit të parë në fushën e ekonomiksitt. Programi është ndërtuar për t'i shërbyer atyre që kërkojnë të formohen si ekonomistë të mirëfilltë me një bekgraund të fortë teorik, duke krijuar mundësinë e thellimit të mëtejshëm në këtë fushë apo në fushat e biznesit. Programi ofrohet plotësisht në gjuhën angleze.

4.4 Planet dhe programet mësimore

Planet janë të miratuara nga senati dhe është hartuar nga departamentet në përputhje me kërkesat e neneve 25,26,27,28,29, dhe 30 të ligjit Nr 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Çdo lëndë e planit mësimor zhvillohet në përputhje me objektivat dhe kërkesat e diplomës.

Kurrikula dhe programet e zgjedhura janë të modelit anglosakson dhe sipas përvojës turke, duke marrë disa modele dhe të përshtatura me realitetin dhe nevojat e tregut shqiptar, përshtatje që deri më sot rezultojnë në ndryshimin e 6 lëndëve nga totali. Në këtë kuadër, studentëve u jepen projekte/detyra kursi në mënyrë që konceptet teorike të shihen si zbatohen në realitetin shqiptar, të cilat realizohen në grup dhe individualisht. Viti i dytë i studimeve është i njëjtë për të gjitha programet e fushës ekonomike.

Nëse profesorët deshirojnë të propozojnë ndryshime, ato fillimisht diskutohen në departament, më tej diskutohen në bord dhe, së fundi, në senat i cili mblidhet 2 herë në vit, por për raste të jashtëzakonshme mblidhet dhe me shpesh.

Syllabuset e lëndëve përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar nga ligji, të cilat për nga standartet e plotsuara dhe cilësia janë një model shumë i mirë për tu përgjithsuar për shkak të qartësisë, informacionit të saktë dhe të bollshëm që japin dhe elementëve të hollësishëm dhe shtesë.

Në secilin semestër ofrohen gjashtë lëndë. Lëndët e ofruara në dy vitet e para janë të detyrueshme, ndërsa vitin e tretë dhe të katërt janë përkatësisht katër dhe tetë lëndë me zgjedhje. Vlerësimi i lëndëve bëhet me provim me shkrim bëhen menjëherë pasi mbaron mësimi dhe pa sezon provimesh. Rimarrja nuk ka

kufinj dhe sezon vjeshte, studentët që ngelin në një lëndë e japin provim vitin tjetër në kohën që ajo është planifikuar.

Pjesë e planeve mësimore janë edhe shkollat verore. Nëse studentët ndjekin këto kurse, mbështetur në kreditet e fituara mund të mbarojnë universitetin për 3 vite dhe jo për 4 sa është kohëzgjatja normale. Në periudhën qershor- gusht 2010 është planifikuar një kurs veror por për arsye të mungesës së aplikimeve nuk ka funksionuar.

Në fund të çdo viti studentët kanë 1-6 javë praktikë, nga ku rreth 102 studentë e kanë bërë atë në Turqi.

Vlerësimi i praktikës bëhet mbi bazën e një raporti prej 11 faqesh që studentët do të paraqesin në fund.

Literatura e cila është bashkëkohore dhe nga autorë shumë të njohur të huaj ju rekomandohet studentëve të blihet në www.amazon.com, veçanërisht për libra të cilët u duhen studentëve dhe pasi të kenë mbaruar universitetin. Studentët i blejnë ose i fotokopjojnë librat jashtë universitetit pasi aty nuk është e lejuar për arsye të të drejtës së autorit. Ndërkohë, studentët mund ta gjejnë literaturën përkatse në bibliotekë e cila disponon 5 kopje për çdo titull. Institucioni është abonuar në bibliotekën online ebscohost në të cilën studentët kanë akses në 20 gazeta të fushave të ndryshme.

Në sajë të një marrëveshjeje me LEEDS Metropolitan University studentët kundrejt një tarife prej 6000 euro mund të ndjekin vitin e katërt në këtë universitet por mbrojtjen e diplomës duhet ta bëjnë në Shqipëri. Në përfundim të studimeve studenti merr diplomë që njihet dhe në Angli. Në këtë marrëveshje parashikohet që studentët që bëjnë vitin e katërt në LEEDS do të bëjnë dhe disa module shtesë.

Cilësia e programit të studimit konfirmohet edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se :

- Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e drejtimit tuaj të studimit, i janë përgjigjur po 92% e studentëve se ishte interesimi i tyre personal dhe 8%, i janë përgjigjur po se ishte mundësia e marrjes së një burse studimi
- Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e shkollës suaj, i janë përgjigjur po 50% e studentëve se ishte interesimi i tyre personal, i janë përgjigjur po 33% e studentëve se ishte lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve dhe 17% i janë përgjigjur po se ishte cilësia e mësimdhënjes dhe eksperiencia e mirë e kolegjeve turke.
- Për çdo lëndë që ju studjoni, pedagogu përgjegjës ju prezanton në fillim qëllimin dhe objektivat e programit të lëndës, format e realizimit të tij (leksione, seminare, pune praktike laboratorike, etj.) materialet me të cilat do të studjoni, etj. A bëhen prezantime të tilla të rregullta për çdo lëndë që ju studjoni, i janë përgjigjur po 100% e studentëve.
- A janë qëllimet dhe objektivat e lëndëve që keni studjuar deri tani në përputhje me qëllimet dhe objektivat e drejtimit të studimit të zgjedhur nga ju, i janë përgjigjur po 96% e studentëve dhe i janë përgjigjur jo 4% e studentëve.

- A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë viteve të studimit dhe në dy semestrat e një viti akademik, i janë përgjigjur po 96% e studentëve se ishte numri dhe shpërndarja e arsyeshme e lëndëve.

Nga ana tjetër shumë komente pozitive të studentëve konfirmojnë të njëjtën gjë, më konkretisht: Stafi akademik shumë i mire e i kualifikuar, komunikim i afërt me pedagogët, metoda dhe teknologji të mira të mësimdhënies, literatura shumë e mire, ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik, mundësia që diploma të njihet jashtë vendit, sistemi shumë të mirë i bursave dhe studentët që nuk kalojnë testin për shkak të nivelit jo të duhur të anglishtes universiteti ju ofron kurse intensive dhe më pas bëhet përsëri testi i pranimit.

4.5 Stafi

Stafi akademik i që i përket Departamentit të ekonomikut angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 7 pedagogë të cilët janë të gjithë të brendshëm. Nga totali, 2 janë profesorë, 1 profesor i asociuar, dhe 5 lektorë. Ndërkohë stafi i departamenteve të tjera që mbulon lëndët përkase të kësaj diplome përbëhet nga 3 profesorë, 5 profesorë të asociuar dhe 9 lektorë më master nga të cilët 3 janë të jashtëm. Raporti pedagog student për këtë program është optimal 1 pedagog i departamentit për 0.6 studentë të regjistruar, që përfaqëson një nivel shumë të kënaqshme krahasuar me të njëjtin tregues për programet e tjera të studimit dhe me universitetet e tjera private e publike, por kjo vjen për shkak të numurit shumë të vogël të studentëve të rrregjistruar në këtë program, gjithsej 4 vetë. Pjesa e dërmuese e stafit mësimdhënës në këtë program janë të huaj dhe të kualifikuar e me përvojë të gjatë akademike.

Cilësia e stafit konfirmohet edhe nga komentet e studentëve që konsitojnë: stafi akademik i huaj i angazhuar në mësimdhënie vjen nga 15 universitete të ndryshme, në lëndët aplikative angazhohet staf akademik shqiptar, në kontratën e stafit akademik është një klauzolë ku brenda 1 viti pedagogu duhet të marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare dhe të botojë një artikull në një revistë shkencore dhe për të realizuar këtë pikë të kontratës institucioni subvencionon me një shumë prej 750 euro në vit si dhe përmbushja e kësaj pike të kontratës dhe vlerësimi nga studentët merren parasysh për rinovimin e kontratës, egzistenca e regullit që një pedagog të japë 2-3 lëndë në vit ku rast i veçantë i Prof. Dr. Güngör Turan që për arsye të eksperiencës së madhe jep 4 lëndë, pedagogët janë të lirë që të ndryshojnë përmbajtjen e syllabuseve por duhet gjithmonë t'i përmbahen strukturës së syllabusit e cila është standarde, egzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit me 30 universitete të ndryshme, kriteri që minimumi i kualifikimit të pedagogëve që angazhohen në mësimdhënie është masteri dhe për kontrollin e detyrave të kursit nëse ato janë kopjime duke qenë se ato paraqiten në gjuhën angleze u kërkohet studentëve që të nisen me e-mail dhe teksti futet në google ku shihet nëse korrespondon me artikuj në internet, ndërkohë që deri tani nuk kanë staf të veçantë për mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

4.6 Mësimdhënia

Veprimtaria mësimore në këtë program realizohet në gjuhën angleze nëpërmjet kombinimit efektiv të një larmie metodash si psh, leksione, seminare dhe praktika, mësimi në grup, analiza e situatave të ndryshme studimore, prezantime, folës të shquar të ftuar, detyra dhe projekte kërkimi duke kombinuar nëpërmjet metodave të mësipërme me praktikën profesionale. Format e mësimdhënies nuk janë fikse por pedagogu ka raste që në një periudhë bën vetëm leksione pastaj seminare e leksione bashke, kjo e fundit është me e zakonshme.

Ndërkohë çdo studenti i caktohet një supervisor dhe një mentor, supervizori është pjesë e stafit akademik dhe i caktohet studentit që vitin e parë, ndërsa mentori është nga tregu i punës dhe u caktohet në vitin e tretë.

Duke u nisur nga përbërja e zgjedhur e profesorit, nga përmbajtja e programeve dhe nga tematikat e punimeve të kursit apo të punimeve të tjera me karakter teorik e praktik, nga metodat e zhvillimit të mësimit se u konstatua se **cilësia e realizimit të mësimdhënies është e mirë dhe kontrolli i shkallës së përvetësimit të dijeve është bashkëkohor**. Sipas evidencave të siguruar nga institucioni për rezultatet e arritura në provime dhe forma të tjera të verifikimit të cilësisë, del se niveli i studentëve është në përgjithësi i mirë dhe se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies.

Cilësia e mësimdhënies konfirmohet edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se :

- A jeni të kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies si leksione/seminare/ushtrime/praktike/ etj., i janë përgjigjur po 96 % e studentëve për lëndë si Makroekonomi Kontabilitet financiar, Teori dhe politika monetare, Tregu dhe insti financiare, Operacione bankare, Ligje biznesi, Hyrje ne ekonomi, Mikroekonomi dhe 4% i janë përgjigjur jo.
- Çfarë mendoni për ngarkesën mësimore gjatë kohës së studimeve, 92 % e studentëve mendojnë se ngarkesa mësimore është e arsyeshme, 4 % e studentëve mendojnë se ka lëndë ku e gjykoj të arsyeshme të zhvillohen në më shumë orë mësimore dhe 4 % e studentëve mendojnë se ka lëndë të cilat mund të zhvillohen në më pak orë mësimore.
- Si e gjykoni ngarkesën e studentit: raportin midis kohës së të ndjekurit të orëve mësimore me kohën e punës së pavarur në shtëpi 62.5% e studentëve mendojnë se ngarkesa në auditor dhe jashtë tij është e arsyeshme dhe 37.5% shprehen se janë të ngarkuar me orët mësimore dhe ju mbetet më pak kohë për të studjuar në shtëpi.
- Çfarë mendimi keni lidhur me cilësinë e mësimdhënies, 84% e studentëve mendojnë se Ka lëndë në të cilat mësimdhënia është shumë cilësore si p.sh.: Tregjet financiare, Kontabilitet, Hyrje ne Kontabilitet, Hyrje ne ligje, Teori dhe politike monetare, Institucioni dhe tregu financiar, Shërbimet dhe operacionet bankare, Makroekonomi, ligje biznesi, Menaxhim dhe organizim,

Makroekonomi, Statistikë dhe pjesa tjetër e studentëve mendojnë se ka lëndë në të cilat cilësia e mësimdhënies lë për të dëshiruar si p.sh.: Kontabilitet financiar, Mikroekonomi, statistikë.

- Si e vlerësoni ju nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste, leksione, etj.), 100% e studentëve mendojnë se është shumë e mirë.
- A është komponenti praktik (laboratorë, punë praktike në terren, etj.,) i mirëintegruar me pjesën e njohurive teorike që ju merrni, 100% e studentëve mendojnë se po.
- Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja, 96% e studentëve mendojnë se format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme dhe 4% e studentëve mendojnë se mund të aplikohen forma të reja, më efektive për kontrollin e njohurive.
- A i përmbahen testimet dhe provimet programit të zhvilluar të lëndës, 100% e studentëve mendojnë se po.
- Vlerësimi i lëndëve është, 100% e studentëve mendojnë se është vlerësim i shtrirë dhe i plotë gjithëvjetor dhe se ky është blerësim i drejtë.
- A tregohen të drejtë/objektivë pedagogët në vlerësimin tuaj, 100% e studentëve mendojnë po
- A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuara me komente që ju ndihmojnë, 100% e studentëve mendojnë po.
- A ju ndihmojnë pedagogët tuaj edhe jashtë orëve të mësimin, 100% e studentëve mendojnë po.
- A ka pedagogë apo persona nga stafi ndihmës të cilët kërkojnë vlera materiale apo financiare për të vlerësuar pozitivisht përgjigjet tuaja në provime, 100% e studentëve mendojnë jo.
- A ka caktuar institucioni një pedagog përgjegjës/mentor me të cilin këshilloheni për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasni gjatë periudhës së studimit tuaj, 100% e studentëve mendojnë po.

4.7 Studentët

Departamenti i Ekonomiksit si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonimike dhe Administrative të Universitetit “EPOKA” çdo fillim viti publikon në media hapjen e periudhës së regjistrimit si dhe ofron informacion për mënyrën se si do të pranohen studentët e rinj. Në vitin akademik 2009-2010, në këtë program u regjistruan për herë të parë 4 studentë, numër mjaft i ulët krahasuar me të degëve të tjera të ngjashme si bankë dhe finacë dhe administrim biznesi.

Për pranimin e studentëve institucioni bën një provim pranimi ku testohet dhe niveli i njohurisë nga ana e tyre e gjuhës angleze. Studentët e pranuar , 80 % e tyre janë nga kolegjet turke pasi për to ka disa lehtësi pranimi. Nga analiza e detajuar që i bëhet cilësive të studentëve të pranuar është e vështirë të gjykohet

për programin e ekonomiksit për shkak se viti i fundit është viti parë i rregjistrimit dhe numuri i tyre është shumë i vogël, vetëm 4 studentë. Sa i takon notës mesatare në hyrje ajo ka qenë për vitin e vetëm të pranimeve në nivel të mirë me GPA 87.9 me një tendencë të lehtë rënse gjatësemestrit të parë.

Në websitin e universitetit studentët mund të njihen me syllabusin e çdo lënde, pedagogun që do të japë lëndën si dhe CV e pedagogut. Çdo student ka llogarinë e tij në web ku mund të marrë informacione për vlerësimin e tij në çdo lëndë, të marrë prezantimet ppt dhe materialet shtesë që lë pedagogu i lëndës.

4.8 Shërbimet dhe lehtësirat e nevojshme

Departamenti në kuadrin e Universitetit ofron mjaft shërbime që ndihmojnë zhvillimin me cilësi të procesit mësimor shkencor. Lehtësirat dhe infrastruktura e ofruara përnëhen nga :

Mjediset dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e procesit mësimor si sallat e leksioneve, laboratorët, mjetet e pajisjet për përgatitjen teorike dhe praktike të cilat janë modern dhe në nivele të kënaqshme dhe në zgjerim e sipër dhe të planifikuar në vazhdim.

Lidhjet me internet, pajisje kompjuterike për stafin e studentët janë bashkëkohore dhe në nivele të pranueshme por me trend rritës në të ardhmen e afërt dhe afat mesme. Kudo në ndërtesën e universitetit ka internet wireless dhe salla kompjuterike moderne për studentët. Në koridore janë vendosur kompjutera ku studentët kanë akses në intranetin e universitetit.

Libraria, biblioteka dhe kapaciteti i tyre në raport me stafin dhe studentët është i pranueshëm dhe e planifikuar për tu zgjeruar në masë të madhe me ndërtimin e një bibliotekë të madhe dhe si strukturë e vacantë. Duhet të theksojmë, megjithatë, se biblioteka është e pamjaftueshme për stafin dhe numrin aktual të studentëve, një pamjaftuesmeri që vihej re jo vetëm në hapësirën e saj por dhe në titujt që përmbante.

Niveli shërbimeve dhe lehtësirave të nevojshme si dhe cilësia e tyre, për sa i përket vlerësimeve të mësipërme konfirmohet përgjithësisht edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se:

- Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit, 100% e studentëve mendojnë se i ndihmojnë shumë.
- A shfrytëzoni literaturë profesionale, 100% e studentëve mendojnë se po.
- A jeni i/e kënaqur me kushtet që ju ofron IAL ku ju studjoni; lidhur me sallat e leksioneve dhe seminareve, 100% e studentëve mendojnë po, lidhur me laboratorët, pajisjen e tyre me aparatura, materiale pune, etj., 100% e studentëve mendojnë po, lidhur me sallat e studimit ku ju mund

të studjoni gjatë kohës suaj të lirë, 92% e studentëve mendojnë po, 4% e studentëve mendojnë jo dhe 4 e studentëve mendojnë se nuk e dinë, lidhur me cilësinë e sallave të bibliotekës dhe me sasinë e titujve që ajo disponon, 92% e studentëve mendojnë po, 4% e studentëve mendojnë jo dhe 4 e studentëve mendojnë se nuk e dinë.

- A e shfrytëzoni bibliotekën e IAL si një burim të rëndësishëm informacioni, 67% e studentëve mendojnë po dhe pjesa tjetër e studentëve mendojnë tjetër arsye të paspecifikuar.

4.9 Lidhjet me studentët e Diplomuar

Zyra e karrirës e cila përfaqëson një nga institucionet më të mirëorganizuara jo vetëm brenda universitetit por edhe në institucione të tjera të arsimit të lartë, i ka kapacitet dhe teknologjinë për ta ndjekur këtë proces por duke qënë se ky është viti i parë i diplomimit të cilët janë kryesisht në proces lidhjet priten të verifikohen në të ardhmen.

4.10 Vlerësimi i brendshëm i cilësisë

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë organizohet nëpërmjet këtyre hapave kryesorë:

- Librit të pedagogut i cili përmban standartet e cilësisë së mësimdhënies
- Pyetsorët e plotësuar nga studentët në cdo vit akademik
- Sekretarisë mësimore, nëpërmjet ndjekjes së orëve mësimore
- Zbatimi i një syllabusi unik, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e studentit

4.11 Kërkimi shkencor

Pedagogët e brendshëm janë të angazhuar në punën shkencore nëpër mjet kërkimit dhe botimeve si :

- Botime në Revistat shkencore të universitetit dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit
- Konferencat shkencore, të organizuara nga vetë institucioni dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Botimet shkencore. Epoka në bashkpunim me Epoka-press, inkurajojnë pedagogët e brendshëm të botojnë libra shkencor. Këto punime janë autentike me kritere akademike të rrepta.
- Grupet e kërkimit. Ngrihen grupe kërkimi rreth pedagogëve me tituj dhe grada brenda departamentit ose dhe në bashkepunim me departamentet e tjera.

Kërkimi shkencor

- Deri tani janë realizuar 13 botime shkencore dhe 25 prezantime në konferenca ndërkombëtare.
- Departamenti i ekonomisë nuk kishte plane konkrete për kërkimin shkencor, sipas shefit të departamentit pedagogët janë të motivuar vetë të nga klauzola e kontratës.
- Kanë bashkëpunime me qendra kërkimore të universiteteve që kanë marrëveshje

5. REZULTATET E VLERËSIMIT

Nga analiza e mësipërme arrijmë në disa përfundime:

5.1 Rezultatet e Formimit

Rezultatet e formimit veçanërisht për sa i përket shkallës së punësimit dhe karrierës së studentëve të graduuar është më e vështirë për tu gjykuar për shkak të vitit të parë të graduimit të studentëve në këtë fushë.

Duke u nisur nga përbërja e zgjedhur e profesoratit, nga përmbajtja e programeve dhe nga tematikat e punimeve të kursit apo të punimeve të tjera me karakter teorik e praktik, nga metodat e zhvillimit të mësimi se u konstatua se **cilësia e realizimit të mësimdhënies është e mirë dhe kontrolli i shkallës së përvetësimit të dijeve është bashkëkohor**. Sipas evidencave të siguruar nga institucioni për rezultatet e arritura në provime dhe forma të tjera të verifikimit të cilësisë, del se niveli i studentëve është në përgjithësi i mirë dhe se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies.

5.2 Rezultatet e kërkimit shkencor

Nga gjetjet e veprimtarisë së pedagogëve të angazhuar në këtë program spikat veprimtaria botuese dhe kërkimore e gjerë e një pjese të stafit, veçanërisht atij të kualifikuar si me tituj akademik. Vlen të përmendet se kërkimi shkencor është i orientuar si në aktivitetet e brendshme që organizohen nga universiteti ashtu dhe në planin e jashtëm vendas dhe ndërkombëtar nëpërmjet botimeve në revista shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore,

6. PËRFUNDIMET E NXJERRJA

Nga analizat e kryera dhe të paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm, nga vizitat e kryera në vend në ambjentet e UET dhe nda të dhënat be grumbullura drejpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimit të studentëve, arrijmë në disa konkluzione të rëndësishme:

Programi Bachelor në Ekonomiks është ndërtuar duke respektuar jo vetëm ligjërisht por në praktikë kërkesat ligjore dhe kërkesat që burojnë nga misioni dhe objektivat e programit. Të gjithë elementët e programit duke filluar që me planin mësimor, mësimdhënjen, stafin akademik, kërkimin shkencor dhe infrastrukturën janë në nivele të mira dhe optimale dhe japin garanci për realizimin e tij.

Nga analiza e gjendjes në këndvështrimin e mësipërm rezultoi kjo pamje që shprehet nëpërmjet analizës SWOT:

Pikat e Forta

1. Program studimi si model anglosakson me kohëzgjatja prej 4 vitesh, i përshtatur me kontekstin shqiptar e cila i jep përparësi këtij programi duke bërë diferencën me shumicën e universiteteve të tjera.
2. Kushte shumë të mira infrastrukturore që përfshinë vendosjen e kampusit në kryeqytet, ndertimin e përfunduar pjesërisht të kampusit modern, që planifikohet të mbarojë në një periudhë të shkurtër .
3. Ofrimi në gjuhën angleze i studimeve
4. Dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik cilësor që shoqëron këtë program
5. Plani mësimor dhe programe bashkëkohore në të gjithë elementët e tij
6. Përprjekjet sistematike për të zbatuar standartet në mësimdhënie dhe në kontrollin e dijeve dhe për të shmangur plagjiaturën në punimet e studentëve
7. Egzistenca e një sistemi të brendshëm të mirë vlerësimi të institucionaizuar
8. Personeli akademik i zgjedhur në mësimdhënie e në kërkimin shkencor dhe me përvojë ndërkombëtare, dukshëm më i mirë nga shumica e universiteteve të tjera private
9. Politika të dizenuara për ndjekjen e studentëve edhe pas diplomimit

Pikat e dobëta

- Mungesa relative e litaraturës në gjuhën shqipe dhe atë të huaj
- Probleme me transportin që lindin nga largësia e kampusit.
- Nivel jo optimal i marketingut, i cili për aq sa realizohet është cilësor .

Mundësitë

- Zgjerim i tregut rajonal, jo vetëm shqipfolës, por edhe kombësi të tjera përfshirë dhe tregun turk
- Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit në drejtim të kërkimit shkencor dhe rritja e imazhit të universitetit me orientim nga kërkimi shkencor
- Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit në drejtim të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve.
- Rritja e mobilitetit të studentëve nëpërmjet përfshirjes në programet TEMPUS, Erasmus Mundus, Socrates, etj.

Kërcenimet (rreziqet e mundshme)

- Konkurrenca jo e ndershme nga universitete të tjera private brenda vendit
- Ndryshimet ligjore të shpeshta që rrisin kostot e rihartimit të programeve dhe të ekuivalentimit të tyre.

- Kufizimi i tregut për shkak të përdorimit vetëm të gjuhës angleze.
- Rrëzimi i konkurrencës në arsimin e lartë në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë

7. REKOMANDIME

Mësimdhënia

- Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa e mësimdhënjes nga Profesorët e huaj
- Të shikohet mundësia për ofrimin e mësimdhënjes në gjuhën shqipe
- Të rritet punësimi i pedagogëve të kualifikuar

Bashkëpunimet

- Të vazhdohet puna e nisur me bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke insitucionalizuar ato me marrveshje të qendrueshme edhe në trojet shqiptare

Studentët

Kërkimi shkencor

- Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor dhe të zgjerohet pjesëmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare

Infrastruktura dhe lehtësirat

- Të pasurohet fondi i bibliotekës dhe hapësirat e saj.
- Të ndërtohen ambiente sportive

5-Programi i studimit ne Finance-Banke

1.Përshkrimi i programit të studimit

Departamenti i Finance Banke ofron diplomë bachelor në sektorin e finances dhe institucioneve financiare. Programet ofrohen me kohë të plotë me kohëzgjatje 4 vite akademike, të organizuara në tetë semestra me 15 javë secila, me gjashtë lëndë për çdo semester. Studenti në përfundim të programit fiton të paktën 240 ECTS dhe pajiset me një diplomë të nivelit të parë në fushën e finance bankes . Programi është ndërtuar për t'i shërbyer atyre që kërkojnë të formohen si ekonomistë të finances një background të fortë teorik, duke krijuar mundësinë e thellimit të mëtejshëm në këtë fushë apo në fushat e biznesit. Programi ofrohet plotësisht në gjuhën angleze.

2.Misioni i Programit të studimit

Misioni i këtij program studimi është të arrijë të përgatis staf potencial të kualifikuar në fushën e financave dhe në sistemin bankar por edhe më gjërë. Njohuritë teoriko praktike të fituara nëpërmjet këtij program do mundësojnë plotësimin e tregut të punës në sektorin bankar dhe financiar në vendin tonë por edhe më gjërë. Këtu kemi parasysh mundësinë e punësimit në kompani të huaja që zhvillojnë veprimtarinë në vendet të tjera të rajonit dhe më gjërë.

3.Objektivat e Programit të studimit

Objekti kryesor i programit është paisja e studentëve me njohuritë bashkëkohore të drejtimit financiar dhe bankar.

4.Studentët e programit të studimit , pranimet etj.

Departamenti i Finance Bankes si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Universitetit "EPOKA" çdo fillim viti publikon në media hapjen e periudhës së regjistrimit si dhe ofron informacion për mënyrën se si do të pranohen studentët e rinj. Në vitin akademik 2007-2008, në këtë program u regjistruan për herë të parë 34 studentë, numër normal si fillim dhe njëkohësisht më i lart për këtë degë krahasuar me degët e tjera të ngjashme Ekonomiks, Administrim Biznes etj.

Për pranimin e studentëve institucioni bën një provim pranimi ku testohet dhe niveli i njohurisë nga ana e tyre në gjuhën angleze. Studentët e pranuar , 80 % e tyre janë nga kolegjet turke pasi për to ka disa lehtësi pranimi. Nga analiza e detajuar që i bëhet cilësive të studentëve të pranuar mund të gjykojmë për një nivel të mirë të tyre po të kemi parasysh që nota mesatare e shkollës së mesme për të tre vitet ka qenë në

nivelin 8,3 deri 8.9, një nivel ky i kenaqshëm dhe premtues për vijueshmërinë e studimeve. Si rrjedhojë këtu e shohim në përqindjen e kalueshmërisë e cila varion nga 47% në vitin e parë në 86 % në vitin e dytë.

Në websitin e universitetit studentët mund të njihen me syllabusin e çdo lënde, pedagogun që do të japë lëndën si dhe CV e pedagogut. Çdo student ka llogarinë e tij në web ku mund të marrë informacione për vlerësimin e tij në çdo lëndë, të marrë prezantimet ppt dhe materialet shtesë që lë pedagogu i lëndës.

5. Programi i studimit.

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 274, datë 10.05.2006 “Për dhënien e lehtë për hapjen e shkollës së lartë universitare, njësia e ka filluar veprimtarinë e saj mësimore në vitin akademik 2007 – 2008 duke ofruar, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative këtë program studimi me shprehje nga puna. Në mbarim të ciklit të studimeve, që me programin aktual zgjatën 4 vite, njësia do t’i pajisë studentët me diplomën universitare “Bachelor” përkatësisht në titullin : Finance Banke. Studentët e parë do të diplomohen në vitin akademik, 2010-2011.

Programet e studimit, të miratuara dhe në proces zbatimi, u përgjigjen kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (posaçërisht nënë 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 të këtij ligji), si dhe kërkesave të Udhëzimit të MASH Nr.15 datë 04.04.2008 (posaçërisht nënë VII, VIII dhe IX të tij). Gjithashtu, gjykojmë se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Sikurse përcaktohet edhe në statutin e njësisë, programet dhe plani mësimor janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme, dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët, apo institucionet me të cilat njësia është në proces bashkëpunimi.

Kurrikula dhe programet e zgjedhura janë të modelit anglosakson dhe sipas përvojës turke, duke marrë disa modele dhe të përshtatura me realitetin dhe nevojat e tregut shqiptar, përshtatje që deri më sot rezultojnë në ndryshimin e 6 lëndëve nga totali. Në këtë kuadër, studentëve u jepen projekte/detyra kurse në mënyrë që konceptet teorike të shihen si zbatohen në realitetin shqiptar, të cilat realizohen në grup dhe individualisht. Viti i dytë i studimeve është i njëjtë për të gjitha programet e fushës ekonomike.

Në dokumentin e miratuar dhe në proces zbatimi të programit të studimeve në drejtimin “Finance Banke” për ciklin e parë 4-vjeçar, pas një hyrjeje ku jepet informacion i përmblodhur për programin dhe planin mësimor dhe parimet mbi të cilat ata janë ndërtuar, për vitet e studimit, kreditet, karakteristikat e diplomës, etj., parashtrohen qëllimi dhe objektivat kryesore të programit. Më tej, bazuar në kërkesat e

akteve normative por edhe në “përshkruesit e Dublinit”² që dallojnë nivelin e njohurive dhe aftësive që duhet të zotërojnë studentët në përfundim të cikleve përkatëse të studimit, analizohen rezultatet e pritura nga studentët. Në këtë kuadër shtjellohen, në mënyrë të shkallëzuar, parashikimet për njohuritë e fituara, për aftësitë e përgjithshme për të vepruar, aftësitë për të vepruar në fusha të veçanta, për aftësitë për punë kërkimore-shkencore, dhe aftësitë për të komunikuar. Për secilin prej këtyre shkallëve të njohurive dhe aftësive të fituara, përshkruhen metodat dhe instrumentet kryesore që do të përdoren, si dhe elementët kryesorë të procesit të vlerësimit. *Jemi të mendimit se shtjellimi i kujdesshëm që i është bërë këtij dimensionit në programin që po diskutojmë (si dhe në programet e drejtimeve të tjera të studimit), përfaqëson në vetvete një përvojë pozitive të njësisë, që mund t’u shërbejë edhe njësive të tjera të arsimit të lartë, publike apo private.*

Më tej, në dokument përshkruhen struktura dhe kushtet e programit studimor, nivelet, modulet, kreditet. Kohëzgjatja e studimit është 4 vjet, e ndarë në 8 semestra, me nga 15 javë secili. Në çdo semestër ofrohen 6 lëndë, të cilat mund të jenë lëndë të detyrueshme, apo me zgjedhje, sikurse përcaktohen në planin mësimor. Për çdo lëndë janë përcaktuar kreditet e fituara (bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, në kërkesat e modelet e paraqitura në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008, dhe duke reflektuar kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës), duke respektuar raportin: 1 kredit = 25 deri 30 orë ngarkese mësimore, ku përfshihen orët në auditor dhe jashtë tij. Në çdo vit fitohen 60 kredite, duke nënkuptuar 1500-1800 orë ngarkese mësimore brenda dhe jashtë shkollës. Për të katër vitet e studimit, studenti duhet të fitojë 240 kredite. Në përfundim të lëndëve të parashikuara në planin mësimor, studentët duhet të mbrojnë tezën e diplomës, të përgatitur përgjatë semestrit të fundit (të tete) të studimeve.

Ndër të tjera, në këtë pjesë të dokumentit të programit të studimit për drejtimin “Finance Banke” nënvizohet detyrimi i pjesëmarrjes së studentëve në leksione dhe seminare, deri në masën 75% të totalit të orëve në auditor, që të lejohet futja e tyre në provimin përfundimtar të çdo lëndë.

Programi vazhdon më tej me parashtrimin e planit mësimor, duke paraqitur lëndët sipas semestrave dhe duke dhënë për çdo lëndë orët totale, ndarë në leksione dhe seminare, kreditet përkatëse, dhe orët javore. Gruplëndët e ofruara gjykojmë se janë në përputhje me qëllimin, objektivat dhe njohuritë e aftësitë që kërkohen të fitojë studenti. Edhe renditja e tyre sipas semestrave e viteve të studimit gjykojmë se ndihmon në komplementimin dhe konsolidimin e njohurive dhe aftësive të fituara. Sidoqoftë, mund të bënim edhe ndonjë sugjerim. *Për shembull, mendojmë se lënda “Hyrje në Finance” që nuk është në curricul është më mirë të ofrohet në vitin e dytë, pasi vetëm në vitin e tretë fillojnë të merren njohuritë në fushën e finances, nderkohe që lënda “Kontabilitetit Financiar I dhe II behen perkatesisht ne semestrin e pare dhe*

² Në kuadër të reformimit të arsimit të lartë në hapësirën evropiane bazuar në marrëveshjen e Bolonjës, janë përcaktuar edhe “Përshkruesit e Dublinit” (“Dublin’ descriptors”), ku përshkruhen kërkesat për njohuritë dhe aftësitë që duhet të zotërohen në përfundim të secilit cikël të studimit në kuadër të arsimit të lartë.

semestrin e dyte te vitit te dyte. Mendojme se qe ne semestrin e pare te vitit te dyte , apo edhe ne semestrin e dyte te vitit te pare lenda qe propozojme te perfshihet ndihmon edhe ne kuptimin e lendeve te para te kontabilitetit qe ofrohen si me siper. Duke pare lendet me zgjedhje do te rekomandonim se lende te tilla si “Sherbimet dhe Veprimet Bankare” apo “Menaxhim i Institucioneve Finaciare “ do ishin mire te jene te detyrueshme pasi do te plotesonin me mire formimin baze teorik por edhe praktik te ketij programi.

Alokimi i krediteve dhe ndarja e lëndëve në semestra është bërë duke mbajtur parasysh klasifikimin e tyre në lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakteristike të programit, lëndë formuese të ngjashme ose integruese me ato të programit, lëndë opsionale, lëndë që përfshihen në grupin gjuhë të huaja, informatikë, praktika mësimore, etj. Nga informacioni i marrë nga njësia dhe llogaritjet e bëra, del se përndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve u përgjigjet kërkesave të Udhëzimit të MASH, Nr. 15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në insitucionet publike të arsimit të lartë” (Kreu VII, pikat 4 dhe 5, dhe shtojca 1). Lëndët karakteristike të programit kapin rreth 50% të totalit të krediteve, pasuar nga lëndët e formimit të përgjithshëm, lëndët formuese të ngjashme, e kështu me radhe. Vështuar sipas viteve të studimit, del se lëndët e formimit të përgjithshëm shtrihen kryesisht në vitin e parë dhe në vitin e dytë . Lëndët karakteristike të finances dhe bankes janë shpërndarë në të tre vitet e para te studimit, por në pjesën më të madhe në vitin e trete dhe sidomos te katert.

Në përfundim të dokumentit të programit të studimit për drejtimin “Finance Banke” paraqiten të atashuara edhe programet e lëndëve. Edhe në hartimin e programeve të lëndëve, duket që është bërë një punë e kujdesshme nga ana e njësisë: ato janë të plota, u përgjigjen kërkesave të rregulloreve përkatëse, janë të qarta dhe orientuese për studentët. Programet e lëndëve janë të formalizuar sipas një strukture standarde. Në faqen e parë jepet emërtimi i lëndës, viti akademik dhe semestri, orari kur zhvillohet lënda, orari i konsultimeve, emri i lektorit dhe i drejtuesit të seminarit, dhe adresa e institucionit. Më pas përshkruhen objektivi dhe misioni i lëndës, pasuar me përshkrimin e formave kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies (leksione, seminare, etj.). Vend i veçantë u kushtohet objektivave specifike të lëndës dhe përfitimeve të pritshme të studentit. Përshkruhet ngarkesa mësimore e lëndës, ndarë në leksione dhe seminare dhe metodologjia e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, dhe paraqitet literatura e detyrueshme dhe e këshillueshme.

Programi vazhdon me paraqitjen e planit të leksioneve, ndarë me tema dhe çështje sipas çdo jave. Në plan parashikohet edhe koha kur do të mbahen provimet e pjesshme dhe provimi përfundimtar. *Mendojme se programi duhet te jape me te detajuar edhe planin e seminareve, ndërtuar përsëri sipas temave dhe çështjeve përkatëse të parashikuara për çdo javë, përfshirë edhe provimet e pjesshme apo detyrimet e tjera të studentëve.*

Cilësia e programit të studimit konfirmohet edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se :

- Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e drejtimit tuaj të studimit, i janë përgjigjur po 92% e studentëve se ishte interesimi i tyre personal dhe 8%, i janë përgjigjur po se ishte mundësia e marjes së një burse studimi
- Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e shkollës suaj, i janë përgjigjur po 50% e studentëve se ishte interesimi i tyre personal, i janë përgjigjur po 33% e studentëve se ishte lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve dhe 17% i janë përgjigjur po se ishte cilësia e mësimdhënjes dhe eksperiencia e mirë e kolegjeve turke.
- Për çdo lëndë që ju studjoni, pedagogu përgjegjës ju prezanton në fillim qëllimin dhe objektivat e programit të lëndës, format e realizimit të tij (leksione, seminare, pune praktike laboratorike, etj.) materialet me të cilat do të studjoni, etj. A bëhen prezantime të tilla të rregullta për çdo lëndë që ju studjoni, i janë përgjigjur po 100% e studentëve.
- A janë qëllimet dhe objektivat e lëndëve që keni studjuar deri tani në përputhje me qëllimet dhe objektivat e drejtimit të studimit të zgjedhur nga ju, i janë përgjigjur po 96% e studentëve dhe i janë përgjigjur jo 4% e studentëve.
- A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë viteve të studimit dhe në dy semestrat e një viti akademik, i janë përgjigjur po 96% e studentëve se ishte numri dhe shpërndarja e arsyeshme e lëndëve.

Nga ana tjetër shumë komente pozitive të studentëve konfirmojnë të njëjtën gjë, më konkretisht: Stafi akademik shumë i mirë e i kualifikuar, komunikim i afërt me pedagogët, metoda dhe teknologji të mira të mësimdhënies, literatura shumë e mirë, ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik, mundësia që diploma të njihet jashtë vendit, sistemi shumë të mirë i bursave dhe studentët që nuk kalojnë testin për shkak të nivelit jo të duhur të anglishtes universiteti ju ofron kurse intensive dhe më pas bëhet përsëri testi i pranimit.

6.Stafi mësimdhënës dhe mbështetës në program

Stafi akademik i që i përket Departamentit të Finance Banke i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 10 pedagogë nga të cilët 7 janë të brendshëm dhe 3 janë të jashtëm. Raporti pedagog student për këtë program është optimal 1 pedagog i departamentit për 8.7 studentë të regjistruar, që përfaqëson një nivel normal krahasuar me të njëjtin tregues për programet e tjera të studimit dhe me universitetet e tjera private e publike, por kjo vjen për shkak të numurit relativisht të vogël të studentëve të rrregjistruar në këtë program, gjithsej 78 vetë. Pjesa e dërrmuese e stafit mësimdhënës në këtë program janë të huaj dhe të kualifikuar e me përvojë të gjatë akademike.

Cilësia e stafit konfirmohet edhe nga komentet e studentëve që konsistojnë: stafi akademik i huaj i angazhuar në mësimdhënie vjen nga 15 universitete të ndryshme, në lëndët aplikative angazhohet staf

akademik shqiptar, në kontratën e stafit akademik është një klauzolë ku brenda 1 viti pedagogu duhet të marrë pjesë në një konferencë ndërkombëtare dhe të botojë një artikull në një revistë shkencore dhe për të realizuar këtë pikë të kontratës institucioni subvencionon me një shumë prej 750 euro në vit si dhe përmbushja e kësaj pike të kontratës dhe vlerësimi nga studentët merren parasysh për rinovimin e kontratës. Egziston dhe rregullit që një pedagog të japë 2-3 lëndë në vit. Por ka rast te veçantë i Prof. Dr. Güngör Turan që është dhe përgjegjes i Departamentit të Finance Banke që për arsye të eksperiencës së madhe jep 4 lëndë. Gjithahstu, pedagogët janë të lirë që të ndryshojnë përmbajtjen e syllabuseve por duhet gjithmonë t'i përmbahen strukturës së syllabusit e cila është standarde. Ekzistenca e marrëveshjeve të bashkëpunimit me 30 universitete të ndryshme, kriteri që minimumi i kualifikimit të pedagogëve që angazhohen në mësimdhënie është masteri dhe për kontrollin e detyrave të kursit nëse ato janë kopjime duke qenë se ato paraqiten në gjuhën angleze u kërkohej studentëve që të nisen me e-mail dhe teksti futet në google ku shihet nëse korrespondon me artikuj në internet, janë disa prej konstatimeve tona lidhur me këto problem.

7.Mësimdhënia

Veprimtaria mësimore në këtë program realizohet në gjuhën angleze nëpërmjet kombinimit efektiv të një larmie metodash si psh, leksione, seminare dhe praktika, mësimi në grup, analiza e situatave të ndryshme studimore, prezantime, folës të shquar të ftuar, detyra dhe projekte kërkimi duke kombinuar nëpërmjet metodave të mësipërme me praktikën profesionale. Format e mësimdhënies nuk janë fikse por pedagogu ka raste që në një periudhë bën vetëm leksione pastaj seminare e leksione bashke, kjo e fundit është me e zakonshme.

Ndërkohë çdo studenti i caktohet një supervisor dhe një mentor, supervizori është pjesë e stafit akademik dhe i caktohet studentit që vitin e parë, ndërsa mentori është nga tregu i punës dhe u caktohet në vitin e tretë.

Mjediset e njësive dhe logjistika në mbështetje të procesit mësimor lejojnë edhe përdorimin e metodave efektive në procesin e mësimin. Sikurse analizohet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë por edhe sipas vlerësimit të vetë studentëve sikurse rezultoi nga pyetësi i plotësuar dhe nga fokusgrupi që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri ta, pedagogët janë të prirur të përdorin metoda që nxisin ndërveprimin aktiv të studentëve. Mjetet audio-vizuale shfrytëzohen në mjaft raste dhe literatura baze dhe ajo e rekomanduar janë të përditësuara.

Pesha e konsiderueshme e vlerësimit që marrin studentët gjatë zhvillimit të lëndës përkatëse në vlerësimin përfundimtar të tyre krahas këmbënguljes për vlerësim korrekt, të paanshëm, transparent e të parashikueshëm, ushtrojnë ndikim pozitiv në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Megjithëse në njësi ka përpjekje për ta lidhur procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies me punën kërkimore edhe të studentëve dhe me njohuritë që ata marrin nga mundësitë e krijuara në lëndë të veçanta për lidhje me qendra të biznesit, mendojmë se në të dy këto drejtime duhen përforduar përpjekjet për një integrim më të mirë dhe më të plotë. Institucionalizimi më i mirë i punës kërkimore si dhe i lidhjeve kooperuese me biznesin, do ta fuqizonin procesin integruar të tyre me veprimtarinë mësimore.

Duke u nisur nga përbërja e zgjedhur e profesoratit, nga përmbajtja e programeve dhe nga tematikat e punimeve të kursit apo të punimeve të tjera me karakter teorik e praktik, nga metodat e zhvillimit të mësimin se u konstatua se **cilësia e realizimit të mësimdhënies është e mirë dhe kontrolli i shkallës së përvetësimit të dijeve është bashkëkohor**. Sipas evidencave të siguruar nga institucioni për rezultatet e arritura në provime dhe forma të tjera të verifikimit të cilësisë, del se niveli i studentëve është në përgjithësi i mirë dhe se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies.

Cilësia e mësimdhënies konfirmohet edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se :

- A jeni të kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies si leksione/seminare/ushtrime/praktike/ etj., i janë përgjigjur po 96 % e studentëve për lëndë si Makroekonomi Kontabilitet financiar, Teori dhe politika monetare, Tregu dhe insti financiare, Operacione bankare, Ligje biznesi, Hyrje ne ekonomi, Mikroekonomi dhe 4% i janë përgjigjur jo.
- Çfarë mendoni për ngarkesën mësimore gjatë kohës së studimeve, 92 % e studentëve mendojnë se ngarkesa mësimore është e arsyeshme, 4 % e studentëve mendojnë se ka lëndë ku e gjykoj të arsyeshme të zhvillohen në më shumë orë mësimore dhe 4 % e studentëve mendojnë se ka lëndë të cilat mund të zhvillohen në më pak orë mësimore.
- Si e gjykoni ngarkesën e studentit: raportin midis kohës së të ndjekurit të orëve mësimore me kohën e punës së pavarur në shtëpi 62.5% e studentëve mendojnë se ngarkesa në auditor dhe jashtë tij është e arsyeshme dhe 37.5% shprehen se janë të ngarkuar me orët mësimore dhe ju mbetet më pak kohë për të studjuar në shtëpi.
- Çfarë mendimi keni lidhur me cilësinë e mësimdhënies, 84% e studentëve mendojnë se Ka lëndë në të cilat mësimdhënia është shumë cilësore si p.sh.: Tregjet financiare, Kontabilitet, Hyrje ne Kontabilitet, Hyrje ne ligje, Teori dhe politike monetare, Institucioni dhe tregu financiar, Shërbimet dhe operacionet bankare, Makroekonomi, ligje biznesi, Menaxhim dhe organizim, Makroekonomi, Statistikë dhe pjesa tjetër e studentëve mendojnë se Ka lëndë në të cilat cilësia e mësimdhënies lë për të dëshiruar si p.sh.: Kontabilitet financiar, Mikroekonomi, statistikë.
- Si e vlerësoni ju nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste, leksione, etj.), 100% e studentëve mendojnë se është shumë e mirë.

- A është komponenti praktik (laboratorë, punë praktike në terren, etj.,) i mirëintegruar me pjesën e njohurive teorike që ju merrni, 100% e studentëve mendojnë se po.
- Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja, 96% e studentëve mendojnë se format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme dhe 4% e studentëve mendojnë se mund të aplikohen forma të reja, më efektive për kontrollin e njohurive.
- A i përmbahen testimet dhe provimet programit të zhvilluar të lëndës, 100% e studentëve mendojnë se po.
- Vlerësimi i lëndëve është, 100% e studentëve mendojnë se është vlerësim i shtrirë dhe i plotë gjithëvjetor dhe se ky është blerësim i drejtë.
- A tregohen të drejtë/objektivë pedagogët në vlerësimin tuaj, 100% e studentëve mendojnë po
- A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuara me komente që ju ndihmojnë, 100% e studentëve mendojnë po.
- A ju ndihmojnë pedagogët tuaj edhe jashtë orëve të mësimi, 100% e studentëve mendojnë po.
- A ka pedagogë apo persona nga stafi ndihmës të cilët kërkojnë vlera materiale apo financiare për të vlerësuar pozitivisht përgjigjet tuaja në provime, 100% e studentëve mendojnë jo.
- A ka caktuar institucioni një pedagog përgjegjës/mentor me të cilin këshilloheni për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasni gjatë periudhës së studimit tuaj, 100% e studentëve mendojnë po.

8.Teknikat e mësimdhënies

Format e mesimdhënies në këtë program janë të organizuara në formën e leksioneve, seminareve, prezantimeve, punëve laboratorike, angazhim jashtë auditorit në formën e detyrave të kursit dhe projektet. Në ndihmë të këtij procesi janë laboratorët me kompjutera të ngritura si dhe paisja e sallave të leksionit me projektore dhe smart boardet.

Lidhjet me internet, pajisje kompjuterike për stafin e studentët janë bashkëkohore dhe në nivele të pranueshme por me trend rritës në të ardhmen e afërt dhe afat mesme. Kudo në ndërtesën e universitetit ka internet wireless dhe salla kompjuterike moderne për studentët. Në koridore janë vendosur kompjutera ku studentët kanë akses në intranetin e universitetit.

9.Vlerësimi i dijeve të studentëve

Vëmendje e veçantë në program u kushtohet detyrimeve të lëndës dhe vlerësimit të studentit. Përshkruhen format dhe elementët e vlerësimit. Si rregull, vlerësimi në provimet e pjesshme dhe për pjesëmarrjen aktive në seminare e leksione kap deri 60% të vlerësimit total; diferenca prej 40% i takon provimit përfundimtar. Programi bazohet në shkallëzimin e vlerësimit, duke lidhur pikët me notat sipas

skemës: nota katër i korespondon pikeve deri 59 pikë, nota 5; 60-64 pikë nota 6; 65-69 pike e kështu me rradhë. Pikeve dhe notave u korespondojnë edhe vleresimi me simbole që variojnë nga nota minimale NA te ajo maksimale AA

II SEKRETARIA MESIMORE

Në sekretarinë mesimore të universitetit u bë vizita në vend. Për të vlerësuar këtë hallkë të Universitetit u kontrollua formalisht dokumentacioni mesimor. U bë verifikim me zgjedhje të dokumentacionit të studenteve si dhe procesverbale të vlerësimit të tyre. Gjithahastu, u verifikua edhe rregullshmeria e regjistrimit të vlerësimit të studenteve dhe procesverbalet përkatëse. Dokumentacioni rezultoi conform rregullave të mirënjohura. U rekomandua që fletet e regjistrimit të vlerësimit të kishin numrin e tyre rendor.

III KËRKIMI SHKENCOR

Pedagogët e brendshëm janë të angazhuar në punën shkencore nëpër mjet kërkimit dhe botimeve si :

- Botime në Revistat shkencore të universitetit dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit
- Konferencat shkencore, të organizuara nga vetë institucioni dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- Botimet shkencore. Epoka inkurajon pedagogët e brendshëm të botojnë libra shkencor. Këto punime janë autentike me kritere akademike të rrepta.
- Grupet e kërkimit. Ngrihen grupe kërkimi rreth pedagogëve me tituj dhe grada brenda departamentit ose dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera.

Kërkimi shkencor

- Deri tani janë realizuar 13 botime shkencore dhe 25 prezantime në konferenca ndërkombëtare.
- Departamenti i ekonomisë nuk kishte plane konkrete për kërkimin shkencor, sipas shefit të departamentit pedagogët janë të motivuar vetë të nga klauzola e kontratës.
- Kanë bashkëpunime me qendra kërkimore të universiteteve që kanë marrëveshje

IV BIBLIOTEKA dhe LEHTESITË E TJERA NË UNIVERSITET.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kreu dy vizita në mjediset universitare. Konstatimi i tij është se mjediset e brendshme janë moderne dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Në ambjentet e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka salla të mëdha leksionesh, salla për seminarët, zyra të pajisura shumë mirë për punonjësit akademikë, për punonjësit ndihmës dhe mbështetës, sallë për kompjuterat, ku ofrohet shërbimi i internetit për studentët dhe për stafin akademik, bibliotekë dhe sallë leximi, laborator të gjuhëve të huaja,

Libraria, biblioteka dhe kapaciteti i tyre në raport me stafin dhe studentët është i pranueshëm dhe e planifikuar për tu zgjeruar në masë të madhe me ndërtimin e një bibliotekë të madhe dhe si strukturë e vacantë. Duhet të theksojmë, megjithatë, se biblioteka është e pamjaftueshme për stafin dhe numrin aktual të studentëve, një pamjaftueshmeri që vihej re jo vetëm në hapësirën e saj por dhe në titujt që përmbante. Nga vizita e bere ne bibloteken e universitetit vume re qe jane blere disa nga tekset nderkombetare te studenteve ne fushen e finances dhe bankes te autoreve te njohur ne kete fushe si botime te Prof. Federic Mishkin, Prof. Eugene BRIGHAM etj, por qe ende jane te paket. Gjithashtu biblioteka duhet te pasurohet edhe me literature nga botimet e autoreve vendas per te marre edhe njohurite nga eekonomia vendase.

Konstatimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm është se facilitetet e këtij universiteti i përmbushin kërkesat e kohës për mësimdhënie e nxënie moderne. Kushtet materiale të krijuara në këtë universitet duket se bazohen në një politikë e cila e vlerëson maksimalisht rëndësinë e infrastrukturës për një institucion akademik dhe *dhe përbën një premisë plus për të nxitur pranimet në këtë universitet dhe cilësinë e punës në të.*

Niveli shërbimeve dhe lehtësirave të nevojshme si dhe cilësia e tyre, për sa i përket vlerësimeve të mësipërme konfirmohet përgjithësisht edhe nga rezultatet e anketimit të studentëve sipas të cilave pyetjes se:

- Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit, 100% e studentëve mendojnë se i ndihmojnë shumë.
- A shfrytëzoni literaturë profesionale, 100% e studentëve mendojnë se po.
- A jeni i/e kënaqur me kushtet që ju ofron IAL ku ju studjoni; lidhur me sallat e leksioneve dhe seminareve, 100% e studentëve mendojnë po, lidhur me laboratorët, pajisjen e tyre me aparatura, materiale pune, etj., 100% e studentëve mendojnë po, lidhur me me sallat e studimit ku ju mund të studjoni gjatë kohës suaj të lirë, 92% e studentëve mendojnë po, 4% e studentëve mendojnë jo dhe 4 e studentëve mendojnë se nuk e dinë, lidhur me cilësinë e sallave të bibliotekës dhe me sasinë e titujve që ajo disponon, 92% e studentëve mendojnë po, 4% e studentëve mendojnë jo dhe 4 e studentëve mendojnë se nuk e dinë.
- A e shfrytëzoni bibliotekën e IAL si një burim të rëndësishëm informacioni, 67% e studentëve mendojnë po dhe 4 e studentëve mendojnë tjetër arsye të paspecifikuar.

V SISTEMI I BRENDSEHM I SIGURIMIT TE CILESISE

4.10 Vlerësimi i brendshëm i cilësisë

Keshilli i Vlerësimit Akademik dhe Permiresimi i Cilesise (KVAPC) eshte organi pergjegjes ne Universitetin EPOKA ne lidhje me sigurimin e cilesisebrenda institucionit.

Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është trajtuar teorikisht, në kuptimin që duket sikur ato që janë shkruar, si rregull duhet të bëhen, por nuk është trajtuar plotësisht se çfarë ka bërë në fakt Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si e ka menaxhuar ai cilësinë, sa raporte ka hartuar, ç'probleme dhe sugjerime janë paraqitur në raportet dhe ç'kanë dalë nga diskutimet që kanë bërë anëtarët e Bordit, çfarë vendimesh ka marrë Bordi i Universitetit, si janë reflektuar ato në Planin aftashkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të Institucionit.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë organizohet nëpërmjet këtyre hapave kryesorë:

- Librit të pedagogut i cili përmban standartet e cilësisë së mësimdhënies
- Pyetsorët e plotësuar nga studentët në cdo vit akademik
- Sekretarisë mësimore, nëpërmjet ndjekjes së orëve mësimore
- Zbatimi i një syllabusi unik, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e studentit

Në intervistat me drejtues të këtij universiteti na u pohua se studentët janë anketuar rregullisht në lidhje me veprimtaritë universitare, se janë vëzhguar orë të caktuara mësimore edhe nga vetë rektori i universitetit, etj., të dhëna të cilat tregojnë për një interesim institucional në këtë drejtim.

VI ANALIZA SWOT

Nga analizat e kryera dhe të paraqitura në raportin e vlerësimit të brendshëm, nga vizitat e kryera në vend në ambjentet e Epokes dhe nga të dhënat e grumbullura drejpërdrejtë dhe nëpërmjet anketimit të studentëve, arrijmë në disa konkluzione të rëndësishme:

Programi Baçelor në Finance Banke është ndërtuar duke respektuar jo vetëm ligjërisht por në praktikë kërkesat ligjore dhe kërkesat që burojnë nga misioni dhe objektivat e programit. Të gjithë elementët e programit duke filluar që me planin mësimor, mësimdhënjen, stafin akademik, kërkimin shkencor dhe infrastrukturën janë në nivele të mira dhe optimale dhe japin garanci për realizimin etij.

Analiza SWOT e paraqitur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë është objektive, realiste dhe qëndron në bazë të përcaktimit të piketave themelore të planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili është gjithashtu pjesë e atij Raporti. Pa përsëritur dhe komentuar të gjithë analizën SWOT të evidentuara në Raport, të cilat mendojmë se janë të argumentuara, po qëndrojmë në disa prej tyre.

Pikat e Forta

10. Program studimi si model anglosakson me kohëzgjatja prej 4 vitesh, i përshtatur me kontekstin shqiptar e cila i jep përparësi këtij programi duke bërë diferencën me shumicën e universiteteve të tjera.

11. Kushte shumë të mira infrastrukturore që përfshinë vendosjen e kampusit në kryeqytet, ndertimin e përfunduar pjesërisht të kampusit modern, që planifikohet të mbarojë në një periudhë të shkurtër .
12. Ofrimi në gjuhën angleze i studimeve
13. Dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik cilësor që shoqëron këtë program
14. Plani mësimor dhe programe bashkëkohore në të gjithë elementët e tij
15. Përpjekjet sistematike për të zbatuar standartet në mësimdhënie dhe në kontrollin e dijeve dhe për të shmangur plagjiaturën në punimet e studentëve
16. Egzistenca e një sistemi të brendshëm të mirë vlerësimi të institucionaizuar
17. Personeli akademik i zgjedhur në mësimdhënie e në kërkimin shkencor dhe me përvojë ndërkombëtare, dukshëm më i mirë nga shumica e universiteve të tjera private
18. Ndertimi i një sistemi të plotë dhe efektiv të informacionit bazuar në një investim të konsiderueshëm.
19. Politika të dizenuara për ndjekjen e studentëve edhe pas diplomimit

Pikat e dobëta

- Mungesa relative e litaraturës në gjuhën shqipe dhe atë të huaj dhe bashkërendimi jo i plotë mes dhenies së njohurive perkatese nga eksperiencia botërore me ato të realitetit të ekonomisë shqiptare.
- Probleme me transportin që lindin nga largësia e kampusit.
- Nivel jo optimal i marketingut, i cili për aq sa realizohet është cilësor .

Mundësitë

- Zgjerim i tregut rajonal, jo vetëm shqipfolës, por edhe kombësi të tjera përfshirë dhe tregun turk
- Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit në drejtim të kërkimit shkencor dhe rritja e imazhit të universitetit me orientim nga kërkimi shkencor
- Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit në drejtim të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve.
- Rritja e mobilitetit të studentëve nëpërmjet përfshirjes në programet TEMPUS, Erasmus Mundus, Socrates, etj.

Kërcenimet (rreziqet e mundshme)

- Konkurrenca jo e ndershme nga universitete të tjera private brenda vendit
- Ndryshimet ligjore të shpeshta që rrisin kostot e rihartimit të programeve dhe të ekuivalentimit të tyre.
- Kufizimi i tregut për shkak të përdorimit vetëm të gjuhës angleze.

- Rrtja e konkurrencës në arsimin e lartë në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë

7. REKOMANDIME

Mësimdhënia

- Të harmonizohet më mirë orari dhe ngarkesa e mësimdhënjes nga Profesorët e huaj
- Të shikohet mundësia për ofrimin e mësimdhënjes pjesërisht në gjuhën shqipe
- Të rritet punësimi i pedagogëve të kualifikuar.
- Të intensifikohen përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të pranuar, duke përdorur politika më efektive marketingu,

Bashkëpunimet

- Të vazhdohet puna e nisur me bashkëpunimet brenda dhe jashtë duke insitucionalizuar ato me marrveshje të qendrueshme edhe në trojet shqiptare

Kërkimi shkencor

- Të hartohen programe të plota të kërkimit shkencor dhe të zgjerohet pjesëmarrja në projekte kërkimi në funksion të ekonomisë shqiptare

Infrastruktura dhe lehtësirat

- Të pasurohet fondi i bibliotekës dhe hapësirat e saj.
- Të ndërtohen ambiente sportive

6-Programi i studimit ne Administrim Biznesi

Programi i studimit

Programi i studimit ne Administrim biznesi mbulohet nga pikpamja akademiko-administrative nga departamenti i Administrim biznesit. Programi universitar eshte i bazuar ne sistemin katervjecar dhe studentet diplomohen me titullin Bachelor ne Administrim biznesi. Te diplomuarit e parë pritët të dalin në vitin akademik 2011-2012. Diploma mbeshtetet ne nje ngarkese prej 240 ECTS. Modeli i zgjedhur per te ndertuar programin e studimit eshte ai amerikan, me kredite te llogaritura sipas ketij sistemi. Por njekohesisht, konform me detyrimet e sistemit arsimor shqiptar, cdo lende ka te percaktuara eshte kreditet ECTS.

Diploma eshte ndertuar me 30 kredite per cdo simester, gjithsej 8 simestra. Cdo lende ka 5 kredite. Zhvillohen gjithsej 48 lende, nga te cilat 36 jane te detyruara, 12 jane me zgjedhje. Ne 12 lendet me zgjedhje, mundesia e lendeve te ofruara per t'u zgjedhur eshte 32 ne total, te kategorive A,B,C,D. Ne 4 simestrat e pare lendet jane te detyruara, ne dy simestrat pasues (i peste dhe i gjashte) futen respektivisht nga dy lende me zgjedhje per simester, ndersa ne vitin e katert raporti kthehet ne favor te lendeve me zgjedhje. Konkretisht, ne simestrat e shtate dhe tete ka perkatesisht nga dy lende te detyruara secili dhe nga 4 lende me zgjedhje secili. Struktura e lendeve te detyruara eshte:

A-Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 45 ECTS/9 lëndë.

B-Disiplina të formimit karakterizues të programit 80 ECTS/16 lëndë.

C-Disiplina të ngjashme ose integruese 25 ECTS/5 lëndë.

E-Veprimtari formuese 10 ECTS/2 lende.

F-Punimi i diplomës. 5 ECTS/1 lende.

Numri dhe lloji i lendeve te detyruara si dhe ato me zgjedhje qe ofrohen plotesojne ne nje shtrirje te arsyeshme gamen e subjekteve te nevojshme per t'u studiuar per te marre formim ne administrim te biznesit.

Kurrikula eshte ndertuar me kendveshtrim qe t'i pershtatet profilit dhe realiteteve te tregut dhe ka nje mase te arsyeshme dinamizmi. Deri tani kane ndryshuar kurrikulat e disa lendeve. Kriteri themelor per ndryshime, apo shtime lendesh, ka qene pershtatja me nevojat e tregut shqiptar. Keto ndryshime zhvillohen si nje proces nga poshte- lart, duke kaluar ne njesi te veshura me force vendimmarrese sic jane departamenti, bordi, senati.

Përputhja me kërkesat e tregut të punës

Diploma bachelor ne Administrim biznesi ofron formim në përputhje me kërkesat aktuale në rritje të tregut të punës për ekonomistë qe mund të punojnë në manaxhim. Por aktualisht ka një shpërthim ofertash në Arsimin universitar për ekonomistë të kësaj kategorie dhe në një të ardhme të afërt do të kete një ngopje të tregut. Universiteti Epoka i ka dale perpara kesaj sfide duke percaktuar qe punon ne

segmentin e tregut te karakterizuar nga cilesia. Ky segment i tregut nuk parashikohet te kete ngopje ne ndonje te ardhme. Edhe sikur kjo te ndodhe, gjuha angleze ne te cilen zhvillohet mesimi ne kete institucion u jep mundesi punesimi te diplomuarve jo vetem ne tregun shqiptar.

Ne Universitetin Epoka funksionon nje Qender e planifikimit te karrieres, e cila aktualisht eshte e orientuar ne organizimin e programeve te ndryshme te trainimit per t'i pajisur studentet me aftesite qe u nevojiten ne karrieren e tyre te ardhshme. Praktikantet profesionale, qe jane pjese e programit te formimit te studenteve, nen kujdesin e Qendres se planifikimit te karrieres, japin shprehi te nevojshme studenteve qe do lehtesojne orientimin ne punet e ardhshme.

Përputhja me legjislacionin në fuqi (procesi i Bolonjës, Kreditet)

Programi ka të llogaritura dhe të paraqitura kriteret e transferimit, menyren se si pranohen studentet ne fillim te nje cikli apo ne mes te tij, menyren se si behet njohja e krediteve, nota qe jepet ne rastet e transferimit horizontal nga nje institucion tjeter i arsimit te larte, dhe leshimi i dokumenteve qe lejojne largim te studentit nga ky institucion ne te tjera. Gjithashtu eshte percaktuar dhe njesia administrative (Keshilli administrativ i Fakultetit) pergjegjese per vendimmarrjen ne lidhje me barazvlefshmerine e krediteve dhe notave.

Gjuha angleze ne te cilen zhvillohet gjithë procesi i mesimdhenies ne SHLPE eshte nje favor me shume per levizshmerine e studenteve ne universitete te tjera europiane apo amerikane me te cilat Universiteti Epoka ka mardhenie institucionale akademike.

Personeli akademik

Nga takimi i zhvilluar prej grupit të vlerësimit me personelin akademik, rezulton se aktualisht Departamenti i Administrimit te biznesit ne Fakultetin e shkencave ekonomike dhe administrative ka 7 pedagogë të brendshëm (me kohe te plote) dhe 7 pedagoge me kohe te pjesshme.

Universiteti Epoka i ka kushtuar vëmendjen e duhur përgatitjes së personelit akademik duke krijuar mundësi që pedagogë të Fakultetit të shkencave ekonomike dhe administrative, posacerisht te Departamentit te Administrim biznesit të specializohen e të punojnë për përgatitjen e doktoraturave, etj. E rëndësishme është që orientimi i temave dhe fushave të studimit të jetë në përputhje me orientimet dhe zhvillimet e pritshme të Universitetit Epoka, në mënyrë që burimet financiare të përdoren sa më efektivisht.

Duke u mbështetur në tabelen analitike te fq. 168 të Raportit të vetëvlerësimit, si dhe ne tabelat e ngarkesave ne auditor, mund të komentohej që raporti pedagogë të brendshëm/pedagogë të jashtëm është i favorshem për përmbushjen cilësore të objektivave të këtij programi studimi. SHLPE ka te lidhura kontrata te perhershme me pedagogë të brendshëm (nga keto 2 femra), dhe kontrata te perkohshme me pedagogë të jashtëm.

Duke parë CV e pedagogëve të angazhuar në Departamentin e Administrim biznesit vihet re se ne 7 te brendshem, dy prej tyre kane titullin Profesor, graden Doktor, nje eshte me titullin Profesor i asociuar, grada Doktor, dy jane me graden doktor, te tjere kane perfunduar studimet master.

Filozofia e organizimit të SHLPE kërkon që sa më i kualifikuar të jete pedagogu, aq më shumë ore të japë në auditor. Mesatarisht një punonjes i brendshëm jep 2-3 lende mesimore në vit.

Mësimdhënia

Mësimdhënia është e organizuar me formën standarde dy simestra për vit shkollor, të quajtura I vjeshtë dhe II pranverë, me lëndë me kohëzgjatje simestrale, me formën leksion/seminar. Shtrirja faktike është 15 javë një sëmester, **50 minuta/orë mësimi**. Rezulton që përdoren forma të larmishme mësimdhënieje që synojnë integrimin sa më të mirë të studentëve në procesin e nxënies. Në programin e studimit janë parashikuar ngarkesa në auditor dhe jashtë për çdo lëndë. Nga takimi me studentë të degës së Administrimit të Biznesit rezulton se ka në një masë të madhe (rreth 90% e të pyeturve) pëlqim dhe pranim nga ana e studentëve për metodat dhe cilësinë e mësimdhënies. Studentët janë në përgjithësi të kënaqur me metodat e kontrollit të dijeve, me drejtësinë që karakterizon procesin dhe sidomos me vëmendjen që marrin nga pedagogët.

Çdo student i është caktuar një supervisor dhe një mentor, supervizori është pjesë e stafit akademik dhe i caktohet studentit që vitin e parë, ndërsa mentori është nga tregu i punës dhe caktohet në vitin e tretë.

Pjesëmarrja efektive e studentëve në proces sigurohet duke e thyer notën në disa kategori, për të cilat studentit duhet të përgjigjet gjatë simestrit. Në program janë parashikuar kohë të posaçme për feedback dhe ndihmë nga pedagogu i lëndës.

Vlerësuesja konstaton se tezat paraqiten në përputhje me programin e lëndëve përkatëse, me nivel të arsyeshëm vështirësie.

Procesi mbështetet në literaturë në gjuhën angleze, me libra origjinale të autoreve të njohur të fushave përkatëse. Në ndonjë rast mësimdhënies janë edhe autore, por kryesisht punohet me libra të autoreve të njohur të fushës përkatëse. Literatura blihet nga universiteti në [amazon.com](https://www.amazon.com) me synimin që në fund të periudhës së përdorimit të nxiten studentet që ta blejnë. Biblioteka e institucionit ka 5 kopje për çdo tekst të nevojshëm. Kopjet e nevojshme për përdorim mësimor fotokopjohen në mënyrë private nga studentet jashtë institucionit. Pavarësisht se gjithë praktika synon uljen e kostos së arsimit, shumëfishimi pa lejen e autoreve nuk është një fenomen i lavdëruar.

Nuk mund të shprehem për diplomantët, pasi Universiteti akoma nuk ka arritur në këto eksperiencë, por nga Raporti i vetëvlerësimit duket që janë parashikuar modalitetet përkatëse.

Biblioteka on-line (EBSCO) e vënë falas në dispozicion të studentëve është një pasuri që ndihmon në përgatitjen e detyrave që bazohen në kërkime në literaturë. 69% e studentëve të Degës së Administrimit të Biznesit të pyetur me qëllim për të vlerësuar, raportojnë se përdorin burimet e bibliotekës së SHLPE.

Kërkimi shkencor

SHLPE ka një politikë të deklaruar të kërkimit shkencor. Në zbatim të kësaj politike, çdo botim në revistë shkencore shpërblehet me 750 EUR deri në 1000 EUR nëse behet në revistë të kuotuar. Për më

teper, institucioni mbulon shpenzimet e pjesmarrjes ne konferenca shkencore. Gjithashtu ne zbatim te kesaj politike, parashikohet qe nje individ nuk mund te jape mesim ne vitin pasardhes nese nuk ploteson nje numer te caktuar botimesh/pjesmarrjesh/referimesh. Pare ne kete kendveshtrim, Departamenti i Administrimit te biznesit zbaton kete politike. Anetare te ketij departamenti kane publikime ne konferencat e organizuara nga Universiteti (Konferenca Nderkombetare per Menaxhimin dhe Ekonomiksin, Konferenca nderkombetare mbi studimet europiane) gje qe pasqyrohet ne materialet publike te vena ne dispozicion te grupit te vleresimit te jashtem.

Studentët

Studentët në SHLPE janë nga Shqipëria, Turqia, Maqedonia, Kosova. SHLPE punon për të përhapur imazhin e vet me qëllim tërheqjen e studentëve. Ky institucion ka të parashikuara qartë kriteret me të cilat pranohen kandidatët.

Ne programin e studimeve universitare per Administrim biznesi jane te regjistruar 41 studente ne tre vitet e para.

Nuk mund të vlerësohet cilësia finale e studentëve të Administrim biznesit dhe pranueshmëria e tyre në tregun e punës, pasi asnjë nuk është diplomuar akoma. Vihet re nga të dhënat në fq. 44 të Raportit të vetëvlerësimit, që ka një qëndrueshmëri të mesatares në vjeshtë dhe ne pranvere (2008-2009), por ka vetëm dy të dhëna, e pamjaftueshme për të nënkuptuar tendencë. Duke krahasuar noten ne hyrje (nga shkolla e mesme) me mesataren e departamentit, duket qe ruhet ne nje mase te konsiderueshme cilesia e studentit.

Fasilitetet

Në përgjithësi fasilitetet në SHLPE jane në përshtatje me kërkesat e punës që bëjnë studentët dhe pedagogët. Hapsira ne ndertesen e re ku eshte vendosur perkoheisht Departamenti i administrim biznesit ofron mundesi per te gjitha llojet e aktiviteve mesimore e kerkimore. Auditoret jane ndertuar me teknologjine e nevojshme per mesimdhenie dhe me formate hapsinore te mjaftueshme per te akomoduar ndarjet e nenndarjet e grupeve te studenteve. Mediset per personelin mesimdhenes me kontrate te perhershme e te perkohshme jane te qeta, konforte dhe japin mundesi akomodimi profesional.

Kudo ne ambjente ka sherbim interneti uaierles. Ne ambiente te perbashketa-korridore jane instaluar kompjutera ku cdo i interesuar mund te marre akses ne intranet. Cdo student ka llogarine personale ne web ku mund të marrë informacione, vleresime, material shtese per te lexuar, etj. Gjithashtu ne webin e universitetit studentët mund të njihen me syllabusin e çdo lënde, pedagogun që do të japë lëndën, CV e pedagogut, etj.

Investimi i bere se fundmi ne ndertesen ne Rinas eshte pjese e nje kampusi qe projektohet te ndertohet ne zone, ku do te akomodohen ne ndertesa te vecanta fakultete te ndryshme, dhe do te kete konvikt per studentet jo rezidente. Kjo flet per nje strategji zhvillimi afatgjate zhvillimi te mbeshtetur vec te tjerash edhe nga investimet ne fasilitete.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë

Sipas raportit të vetëvlerësimit, në SHLPE sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe ka funksionuar me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e lartë në RSH. Kështu në nivel njësie bazë siç është departamenti analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij.

Nga ana e vlerësueses u konstatua se në fakultet janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet përkatëse.

- Në menyre institucionale janë percaktuar kriteret për vlerësimin e aktiviteteve akademike të kandidateve për t'u përfshirë në personelin akademik.
- Në periudhën 2007-2010 asistencë për kërkimet shkencore, mbështetja për pjesëmarrje në takimet shkencore dhe stimulimi i publikimeve shkencore janë tre zera me rritje të qëndrueshme në buxhetin e institucionit.
- Universiteti Epoka ka vendosur kriteret për kontrollin e hyrjeve në universitet dhe ka të specifikuar kriteret në lidhje me cilësinë e notës. Gjithashtu ka percaktuar kriteret të qarta cilësore për vazhdimin e mardhënies së studentit me institucionin deri në marrjen e titullit të studimit.
- Në fakultet është i institucionalizuar procesi i marrjes së feedback-ut nga studenti. Duke filluar nga viti shkollor 2008-2009 organizohen për çdo semester pyetësore për lëndet dhe menyrën e shpjegimit. Rezultatet e tyre të përpunuara kanë një menyrë të percaktuar trajtimi, me qëllim informimin e paleve për kontroll dhe përmirësim. Ky feedback shërben dhe për vendimmarrje në lidhje me vazhdimësinë e mardhënies së pedagogut me institucionin.
- Në rregulloren e studimeve një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve. Forma e vlerësimit të dijeve të studentëve për çdo lëndë është e percaktuar në syllabuset e programit të studimit, ku në një masë të konsiderueshme të vlerësimit përfundimtar (pothuajse 50%) e zë vlerësimi që merr studenti për elementët e lëndës përkatëse si dhe vlerësimet e marra në kontrollet e ndërmjetme. Në arkivën e departamentit ruhen për një kohë të percaktuar të gjitha kontrollet e kryera të studentit, procesverbalet e mbajtura nga ana e pedagogut në lidhje me vlerësimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare të studentit duke siguruar një gjurmueshmëri të qëndrueshme në të gjitha hallkat e mekanizmit të vlerësimit të ngritur, për të eliminuar çdo lloj inflacioni institucional të notës.

Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Kontaktet dhe bashkëpunimi i Departamentit brenda dhe jashtë vendit dhe koordinimi i aktiviteteve. Departamenti i administrimit biznesit ka bashkëpunim me departamentet e tjera brenda universitetit për të realizuar programet e studimit. Ka një angazhim të burimeve të kualifikuara njerëzore të universiteteve publike e private brenda e jashtë vendit në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të këtij departamenti. Në kuadrin e gjithë institucionit, edhe ky departament ka pjesën e vet të mardhënies së bashkëpunimit me universitete dhe institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Mobiliteti i Stafit akademik brenda sistemit të Arsimit të lartë në vend. Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, qeveritare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Stafi akademik

është ngazhuar në dhënien e cikleve të trainimeve për disa kompani private të rëndësishme në vend, por kjo brenda institucionit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar. SHLPE ka marrëdhënie institucionale me 17 Universitete të huaja. Me e fundit prej tyre u realizua në ditët e vizitës në praktike të grupit të vlerësimit. Duket që ka përpjekje dhe interesim të vazhdueshëm për rritjen e kontakteve dhe bashkëpunimit me universitete jashtë Shqipërisë. Ky bashkëpunim është parë në kuadrin e politikës së përgjithshme që ndjek SHLPE. Vecanërisht evident është bashkëpunimi në bërjen e praktikave profesionale të studentëve kryesisht jashtë vendit në kompani me të cilat institucioni ka marrëveshje institucionale. Nga vlerësimi i pyetësoreve të bera nga grupi i vlerësimit të jashtëm me studente të degës Administrim biznesi, bie në sy kërkesa e tyre për shtimin e lidhjeve institucionale me universitete të huaja në Europë e me tutje në përfundim.

Një analizë SWOT për Departamentin e Administrimit të biznesit.

Duke pasur parasysh gjithë sa u konstatua gjatë procesit të vlerësimit, mund të thuhet se SHLPE paraqitet në një situatë që mund të përshkruhet si më poshtë. Pak a shumë të njëjtat mund të thuheshin për Departamentin e Administrimit të biznesit.

Anët e forta (S)

1. Ka një mision të qartë.
2. Punon duke patur në qendër të vëmendjes përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
3. Është i orientuar nga klienti (ka përqasje bashkëkohore në mënyrën e bërjes së biznesit, komunikim i afërt pedagog-student, mesimdhënie bashkëkohore).
4. Ka një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë së mesimdhënies.
5. Ka një sistem treguesish të integruar të kontrollit të dijeve të studentëve.
6. Ofron mundësinë që diploma të njihet jashtë vendit.
7. Ka sistem shumë të mirë bursash.

Anët e dobëta (W)

1. Profesoret vizitues jo gjithmone arrijnë të mbulojnë në shtrirje normale ngarkesën semestrale, duke krijuar mbledhje që sjellin vështirësi për punën e studentëve.

Mundësira (O)

1. Gëzon imazh pozitiv tek klientët aktualë.
2. Tregu është në zgjerim për llojin e produktit që ofrohet.
3. Legjislacioni po favorizon gjithnjë e më shumë zhvillimin e aktiviteteve të këtij lloji.
4. Bashkëpunimi midis universiteteve krijon burime të pallogaritshme.
5. Në Shqipëri ekziston një rrjet i konsoliduar shkollash të mesme të cilat kryejnë mesimdhënien vetëm në anglisht. Ata janë një kontingjent i pashtërrshëm për SHLPE.
6. Fakti që studentët punojnë në gjuhën angleze, hap mundësi shumë të mëdha pjesëmarrjeje reale në aktivitete kurrikulare/ekstrakurrikulare në gjithë vendet e botës.

Rreziqe të mundshme (TH)

1. Nuk ka mbaruar akoma një cikël i plotë. Programet nuk janë të provuara akoma në praktikë për vlerën e tyre të plotë.
2. Mesimdhënia vetëm në anglisht, mund të rrezikojë të lere të kufizuar kontingjentin e aplikanteve për studime në këtë universitet edhe për shumë kohë.

Mendoj që anët e forta të identifikuar në analizën SWOT mund të konsiderohen si **gjetje pozitive gjatë vlerësimit**. Me këtë arsyetim mund të flitet edhe për **anët e dobëta** të përfshira në analizën SWOT.

7-Programi i studimit ne Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si pjese e Universiteti Epoka, dDuke themeluar një sistem te menaxhimit te njohurive, ne përputhje me parimet e njohura universale, se bashku me stafin akademik dhe ndihmës ka një strukture dinamike dhe organizative.

Stafi akademik (brendshëm & jashtëm)i EPOKES në vitin universitar 2008-2009 kishte një personel prej 29 anëtarësh dhe në vitin akademik 2009-2010 numri i personelit akademik u rrit në 92, ku Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka një personel prej 47 anëtarësh, nga të cilët 15 në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare funksionon si departament me disa programe studimi. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marredhenie Nderkombetare ofron programe universitare dhe pasuniversitare ne Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare. Programi universitar eshte i bazuar ne sistemin katervjecar dhe studentet diplomohen me titullin Bachelor ne Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare. Programi pasuniversitar perfshin Diplomen e Nivelit te Dyte ne Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare (DND), Master i Nivelit te Dyte ne Shkenca Politike dhe Marredhenie Nderkombetare (MND) dhe Masterin e Nivelit te Dyte ne Studime Europiane (MND).

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike ka strukturë akademike në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të vitit 2007 dhe Kartës së Bolonjës. Shkolla e Lartë private Epoka ka filluar aktivitetin mësimdhënës në vitin akademik 2008-2009. Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi ndiqet me vëmendje dhe janë ndërmarrë hapa për zbatimin e tyre në praktikë. Ka një vullnet të mirë për të menaxhuar departamentin sipas standardeve ligjore, falë cilësisë së stafit.

Puna mësimore dhe shkencore e Departamentit vlerësohet nëpërmjet Senatit, që është një njësi vendimmarrëse kolegjiale e Universitetit. Departamenti është njësi baze mësimore-kërkimore, qe përfshin fusha kërkimi dhe grupe te mësimdhënies homogjene ne disiplinat përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor te Departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (DSHPMN) ka aktualisht gjithsej 15 pedagogë, të cilët e kanë fituar këtë status në vitin akademik (2008-2009). Nga kjo trupë pedagogjike, 5 kanë titullin asistent profesor dhe 10 lektorë. Në DSHPMN, 10 janë pedagogë të brendshëm dhe 5 te jashtëm, prej te cilëve 3 janë femra (2 të brendshme). Rreth 60 % e pedagogëve efektivë janë në grup-moshën 25-34 vjeç dhe 40 % janë të grup-moshës 35-44 vjeç. DSHPMN ka deklaruar se ka 5 pedagogë me gradë shkencore Doktor (33 %) dhe 9 (60 %) me gradën Master. Mendoj se nga pikëpamja numerike departamenti plotëson standardet e kërkuara në ligjin e arsimit të lartë.

DSHPMN kryesohet nga përgjegjësi i departamentit i cili ka një eksperiencë pune pranë universitetit prej 3 vitesh qysh nga themelimi i tij. Çdo pedagog i brendshëm i departamentit kryen detyrat e mësimdhënies si dhe të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore që organizon universiteti. Aktivitetet në fjalë konceptohen në funksion dhe si ndihmesë e procesit mësimor.

Departamenti kryen analizë të procesit mësimor të paktën një herë në vit me pjesëmarrjen e të gjithë stafit akademik në të cilën diskutohen të gjitha problemet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Objekti i punës së departamentit konsiston në ripunimin dhe miratimin e programeve të lëndëve, ndjekja dhe zbatimi i programeve mësimore, propozimi i strategjisë së zhvillimit, kërkimit shkencor, kalendarit mësimor vjetor dhe organizmi i veprimtarive ekstra-kurrikulare me studentët. Diskutimi i programeve të lëndës i strategjive të zhvillimit dhe planeve të kërkimit shkencor brenda grup lëndëve të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është në përputhje me detyrat që duhet të kryejë një njësi bazë shkencore në institucionet e arsimit të lartë.

DSHPMN ofron diplome me titull Bachelor. Programi akademik mbulon katër nëndege të mëdha të kësaj disipline:

1. politika krahasuese
2. marrëdhëniet ndërkombëtare
3. teoritë politike
4. politika shqiptare.

DSHPMN ka si objektiv kryesor të sigurojë një edukim të balancuar e të hapur për diversitet. Përveç programeve që përfshijnë kurrikulat e këtij departamenti, studenteve u është dhënë mundësia të kryejnë hulumtime për çështje bashkëkohore, si Bashkimi Evropian, ekonomia politike, demokratizimi, të drejtat e njeriut, përkatësia gjinore dhe politika. Fale stafit mjaft të kualifikuar ku një kontribut i veçantë u takon profesorëve vizitues nga jashtë vendit, DSHPMN ofron një game të gjere programesh të zgjedhura, në mënyrë që t'u krijojë mundësinë studenteve të specializohen në atë drejtim që ata dëshirojnë të zgjedhin.

DSHPMN ofron mundësi studentëve të diplomuar të bëjnë karriere si brenda dhe jashtë vendit, në sektorin privat dhe atë publik, në veçanti në organizatat ndërkombëtare, si: Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, në Ministrinë shqiptare të Punëve të Jashtme, në universitetet dhe mediat, si dhe në kompani private. Filozofia e mësimdhënies së Departamentit është që t'i pajisë studentet me kapacitet intelektual dhe me mjetet e nevojshme për të menduar në mënyrë të pavarur, në pyetje dhe kritike, të angazhohen në punë në grup dhe të jenë pa paragjykimë. Departamenti ka miratuar për këtë arsye një program me perspektive ndërdisiplinore dhe një afim shumëdimensional për akumulimin e njohurive. Kjo u vu re edhe nga vëzhgimi konkret në një orë mësimi ku studentët merrnin pjesë aktive në diskutimin e tematikës së propozuar nga pedagogu.

Programi i studimit në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare reflekton një ndërthurje ndërdisiplinore si shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Krahas anëve pozitive që ka një përafrim i tillë në formimin kompleks e multidisiplinar të studentit, kjo përbën dhe një mundësi për një orientim më të drejtë në veprimtaritë praktike dhe akademike të të diplomuarve. Vlen të përmendim se kombinimi i dy fushave të studimit shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare justifikon për mendimin tonë titullin për një diplomë të nivelit të parë. Por për të ardhmen, mendoj se veçanërisht në ciklin e dytë të studimeve Master, mund të ketë vend për një specializim më të dallueshëm sipas dy fushave, që të reflektoj edhe në organizimin funksional të departamentit, i cili të shoqërohet me krijimin e seksioneve dhe specializimeve brenda tij. Lëndët e programit të cilat janë formuese shërbejnë si një mbështetje e mirë për të lehtësuar punën dhe nivelin e përvetësimit të dijes.

Mësimdhënia është e organizuar kryesisht në leksione e seminare, që përbëjnë ngarkesën totale të procesit mësimor, ndërsa praktika mësimore ose staxhe nuk figurojnë në ngarkesën mësimore. Nga evidenca e departamentit del se ka disiplina të Programit të Studimit ku ende nuk figurojnë emra të pedagogëve që mbulojnë lëndët, si p.sh. lëndët: *Historia e Integrimit Evropian, Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, apo Lëvizjet Sociale në Botë*, e ndonjë tjetër. (Course Syllabi, fq.87-92.)

Procesi mësimor monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga departamenti dhe administrata. Para fillimit të procesit mësimor organizohet puna për rikonfirmimin e programeve të lëndëve, literaturën që do të përdoret. Administrata organizon anketimin e studentëve dhe departamenti realizon analizën semestrale e vjetore të procesit mësimor. Këto elementë janë mjaft pozitivë në lidhje me monitorimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.

Programi i studimit ka të përcaktuar format e vlerësimit të dijeve të studentëve i cili merr parasysh të gjithë aktivitetin vjetor të studentit. Provimet janë të sekretuara dhe zhvillohen korrekte sipas mënyrës së përcaktuar. Mënyra e vlerësimit i bëhet e njohur studentit që në fillim të lëndës. Provimet ruhen disa vite në arkivin e universitetit. Grupi i vlerësimit konstatoi seriozitet gjatë zhvillimit të provimeve, rregullsi në administrimin e fletëve të provimit si dhe ruajtjen e kontrolleve të ndërmjetme dhe provimeve finale. Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk kanë qenë prezentë në ndonjë provim të mbajtur në departamentet në fjalë kështu që kjo pjesë e raportit është bazuar tek bisedat me studentët dhe pedagogët e departamentit.

Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, siç dihet kanë natyrë ndërdisiplinore. Ato kryesisht mbështeten në katër fusha kryesore: sociologji, ekonomi, histori dhe drejtësi. Pikërisht këto katër shtylla dhe një raport me i baraspeshuar mes tyre shërbejnë si baze e përcaktimit të lendeve të parashikuara në planin mësimor për ciklin e parë të studimeve. Në këtë cikël studimesh, studentëve u jepet mundësia të njihen me konceptet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave politike. Lëndët që zhvillohen në departamentet përkatëse janë të përqendruara në konceptimin e analizave të ndryshme politike, historike e diplomatike çka e bën studimin e lëndëve përkatëse të perceptueshme nga ana e studentëve.

Programi i studimit

Në DSHPMN ka një Program Studimi (PS) : *Shkenca Politike & Marrëdhënie Ndërkombëtare (SHPMN)*. Ky PS ka gjithsej 48 disiplina, prej të cilave 30 janë të detyrueshme dhe 18 janë me zgjedhje. Numri relativisht i madh i lendeve mësimore (48) lidhet me sistemin 4 vjeçar të studimeve dhe natyrën integruese të një pjese prej tyre, të cilat janë të përbashkëta në rang fakulteti. Kjo është pozitive dhe i jep një kohezion me të madh procesit mësimor për tërë Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Administrative, duke u mundësuar studenteve një mobilitet me të madh dhe formim interdisiplinar. Kjo është një praktike e njohur dhe e zbatuar me tepër në universitet amerikane. Por, mendoj se do të kish qënë më mirë që, numri i përgjithshëm i disiplinave me zgjedhje të ishte disi më i përqendruar në një ose dy drejtime, në mënyrë që studentet të orientohen më mirë në një treg pune, që në vendin tonë nuk është dhe aq i zhvilluar dhe divers në kërkesat e tij. Ky sugjerim vlen vetëm për ata studentë që do të gjejnë punë në tregun shqiptar.

Struktura mësimore e PS është e organizuar sipas Udhëzimit nr. 15 dt. 04.04. 2008 “Për organizimin e studimeve ne Institucionet e Arsimit te Larte”. Në mënyrë te specifikuar kjo strukturë ndahet në disa kategori lendesh: disiplina te formimit te përgjithshëm ose bazë (20%), disiplina te formimit karakterizues ose te detyrueshme (50%), disiplina formuese te ngjashme ose integruese (10%), disiplina formuese te zgjedhura (7-8 %) dhe disiplina formuese me karakter praktik si mësim gjuhe e huaj, praktik ose stazh (10%), pjesa që mbetet shkon për llogari të punës përgatitore për diplomën. Kjo mënyre jep mundësi për një formim të përgjithshëm por dhe profesional te studenteve. Kjo ndikon pozitivisht ne orientimin me te mire te studenteve ne tregun e punës dhe përzgjedhjet qe bëhen nga pune marrësit ne drejtim te kërkesave te tyre.

Raporti gati ½ midis lendeve te detyrueshme me ato me zgjedhje në një kënd vështrim të përgjithshëm duket korrekt, pasi nuk le shumë shteg për shpërndarje te vëmendjes dhe punës se studenteve ne drejtim te orientimit te aftësive te tyre individuale për edukim dhe formim profesional. Por puna e tyre individuale mendoj se duhet të stimulohet më shumë gjate zhvillimit te procesit mësimor, duke i dhëne përparësi punës individuale të studentëve, si ese te ndryshme, prezantime para grupit, ne raport me aspektin didaktikë e teorik, si leksioni.

Numri relativisht jo i madh i studenteve është një anë pozitive e procesit mësimor, gjë qe siguron një pune individuale me cilësore dhe seleksionuese me studentet. Ne këtë aspekt, një vlere pozitive përbën dhe literatura bashkëkohore që u rekomandohet studenteve, e cila mund te gjendet pjesërisht ne Bibliotekën e universitetit.

Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor është në fazat e para, pasi detyra parësore e departamentit në këto tre vjet ka qenë stabilizimi i programit të studimit, konsolidimi i aktivitetit mësimdhënës dhe stabilizimi i stafit. Megjithatë, organizimi i stafit të brendshëm dhe cilësia profesionale e tij ka sjellë përparësi në organizmin e kërkimit dhe studimeve shkencore të mirëfillta në departament.

Kërkimi shkencor nxitet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve shkencore në kuadrin e Qendrës se Studimeve Evropiane. Misioni i Qendrës se Studimeve Evropiane është per te përparuar te kuptuarit e ngjarjeve qe formojnë Evropën bashkëkohore përmes zhvillimit te individit, i cili kështu mund te realizoje reduktimin e tij te mundshëm dhe per te përmirësuar jetën e tij, zhvillimin e shoqërisë, me nxitjen e demokracisë, duke ulur pabarazinë midis individëve dhe promovimin e diversitetit kulturor dhe zhvillimin e ekonomisë, duke siguruar qe forca punëtore te korrespondoje me evolucionin e marrëdhënieve evropiane.

Gjatë tre viteve të veprimtarisë së Universitetit Epoka, janë organizuar aktivitetet shkencore të rëndësishme në drejtim të trajtimit të problematikës së integritit të vendit tonë në rajon dhe më gjerë, si p.sh. dy konferenca ndërkombëtare për studime ballkanike dhe evropiane, e para me temë: *“Integrimi i Ballkanit Perëndimor në Strukturat Euro-Atlantike-Sfidat e Ardhshme”* organizuar në 7-8 nëntor 2008 dhe e dyta me temë: *“Sfidat Politike, ekonomike, sociale të vendeve të Ballkanit në procesin e integritit evropian”*, organizuar në 6-7 nëntor 2009.

Stafi akademik

Numri i pedagogëve, të brendshëm dhe të jashtëm (15) të angazhuar në procesin mësimor në raport me numrin e studenteve (52) është në një raport 1 pedagog për 3.4 student. Pra ka një mbulim të mire të procesit mësimor me pedagogë, gjë mendoj se siguron një angazhim me serioz të pedagogeve dhe për pasojë dhe një cilësi me të mire të procesit të mësimdhënies.

Stafi akademik efektiv mbulon pjesën më të madhe të ngarkesë mësimore. Nga evidenca e ngarkesës mësimore në DSHPMN, konstatohet se stafi i brendshëm mbulon (full-time) 73% të ngarkesës mësimore në auditor, ndërsa pjesa tjetër 27% nga stafi i jashtëm (part-time).

Personeli i brendshëm ka kontratë të rregullt pune me punëdhënësi dhe secili prej tyre punësohet pas kalimit të një procedure të rregullt konkurrimi. Pedagogët synohet të punësohen në rastin kur ata kanë grada shkencore dhe tituj akademikë, konform ligjeve në Republikën e Shqipërisë.

Stafi mësimdhënës dhe mbështetës është me cilësi shumë të mirë. Drejtuesi i njësisë në bashkëpunim me drejtuesit e universitetit tregojnë kujdes në përzgjedhjen e tyre. Ka pedagogë me tituj dhe grada shkencore dhe një numër i konsiderueshëm pedagogësh në kualifikim të lartë.

Rregulli dhe disiplina karakterizon mësimdhënien dhe kontrollin e dijes. Organizimi formal dhe përmbajtja janë në nivele shumë të mira.

Administrimi i dokumentacionit të programeve të studimit të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është shumë i mirë. Sekretaria mësimore, salla e internetit dhe biblioteka i shërbejnë mjaft mirë ngritjes së cilësisë së punës. Drejtuesi i njësisë garanton një mbarëvajtje të administrimit të saj.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera janë zhvilluar dhe kanë shërbyer si bazë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, por ka nevojë të zgjerohen dhe të institucionalizohen.

Pika të forta të DSHPMN:

Programi studimit ka përmbajtje shkencore e moderne për sa i përket shpërndarjes semestrale të lëndëve dhe krediteve.

Kurrikulat e fakultetit janë bashkëkohore e me tipare integruese dhe mendoj se në tërësi janë në funksion të tregut të punës.

Programet dhe mësimdhënia bazohet në disiplina shkencore me karakter formues, të mbështetura në përvojën më të mirë të universiteteve të huaja. Organizimi i strukturës mësimore në disa kategori lëndesh, si disiplina të formimit të përgjithshëm ose bazë, disiplina të formimit karakterizues ose të detyrueshme, disiplina formuese të ngjashme ose integruese, disiplina formuese të zgjedhura, jep mundësi për një formim të përgjithshëm por dhe më profesional të studenteve.

Numri relativisht i konsiderueshëm i lendeve mësimore me natyrë integruese, të cilat janë të përbashkëta në rang fakulteti, është një aspekt pozitiv dhe i jep një kohezion me të madh procesit mësimor duke u mundësuar studenteve një mobilitet me të madh për formimin e tyre.

Angazhimi serioz i një stafi pedagogjik të kualifikuar siguron një mbulim të mirë të procesit mësimor dhe për pasojë një cilësi të shumë të mirë të procesit të mësimdhënies.

Raportet midis lendeve të detyrueshme me atyre me zgjedhje nuk lenë shteg për shpërndarje të vëmendjes dhe punës së studenteve në drejtim të orientimit të aftësive të tyre individuale për edukim dhe formim profesional.

Infrastruktura, metoda dhe teknologjitë e reja të mësimdhënies janë një pikë e fortë për departamentin e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Numri aktual relativisht jo i madh i studentëve është një pikë tjetër pozitive e procesit mësimor, gjë që siguron një punë individuale me cilësore dhe seleksionuese me studentet.

Sistemi i informacionit është i përshtatshëm dhe hyrja në internet u garantohej si personelit akademik dhe administrativ dhe studentëve. Administrimi i dokumentacioneve nga stafi administrativ është tepër korrekt.

Pika të dobëta të DSHPMN:

Procesi i Bolonjës në të cilin mbështetet departamenti nuk ka krijuar mundësi për një ndarje më korrekte të ngarkesës mësimore me atë shkencore tek pedagogët 50 me 50 (50% e kohës në mësimdhënie dhe 50% e kohës në hulumtime shkencore).

Numri i përgjithshëm i disiplinave, kryesisht i atyre me zgjedhje të jetë me i kufizuar dhe i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentet të jenë me komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.

Literatura shkencore me natyrë politike, diplomatike, sociale e historike vendase dhe e huaj në bibliotekë është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.

Punë individuale e studenteve duhet të stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi orëve të veçanta të seminareve, prezantimeve me gojë dhe eseve të ndryshme.

Shtimi i numrit të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar një mbulim të plotë dhe më të mirë të procesit mësimor.

ANEKS 2

REZULTATET E PYETSOREVE PËR STUDENTET

Mostra 24 student

Viti i II 5 student

Viti i III 18 student

Viti i IV 1 student

Pyetja		PO	JO	Nuk e di	Tjeter
Për programin e studimit					
1	Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e drejtimit tuaj të studimit?				
	a. Interesimi personal në drejtimin e studimit të zgjedhur	92%			
	b. Influenca e prindërve/miqve/mësuesve	0 %			
	c. Lehtësia për t'u pranuar	0 %			
	d. Lehtësia për të marrë shkollën e lartë	0 %			
	e. Mundësia e marrjes së një burse për studimet	0 %			
	f. Lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve të larta	0 %			
	g. Tjetër	8 %			
2	Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e shkollës suaj ?				
	a. Interesimi personal	50%			
	b. Influenca e prindërve/miqve/mësuesve	0 %			
	c. Lehtësia për t'u pranuar	0 %			
	d. Lehtësia për të marrë shkollën e lartë	0 %			
	e. Lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve të larta	0 %			
	f. Tjetër (ju lutemi specifikoni) _____	33 %			
		17 % cilesia e mesimdhenies, eksperienca e mire ne kolegjet turke			
3	Për çdo lëndë që ju studjoni, pedagogu përgjegjës ju prezanton në fillim qëllimin dhe objektivat e programit të lëndës, format e realizimit të tij (leksione, seminare, pune praktike laboratorike, etj.) materialet me të cilat do të studjoni, etj. A bëhen prezantime të tilla të rregullta për çdo lëndë që ju studjoni?	100 %	0 %	0 %	
4	A janë qëllimet dhe objektivat e lëndëve që keni studjuar deri tani në përputhje me qëllimet dhe objektivat e drejtimit të studimit të zgjedhur nga ju?	96 %	0 %	0 %	4 %

5	A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë viteve të studimit dhe në dy semestrat e një viti akademik? a. PO, mendoj se numri dhe shpërndarja e lëndëve është e arsyeshme b. JO, sepse ka semstra kur jemi shumë të ngarkuar dhe të tjerë shumë më të lirë në ngarkesë mësimore c. Tjetër, (ju lutemi specifikoni)_____	100%	0%	0%	0%
Mësimdhënia					
6	A jeni të kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies si leksione/seminare/ushtrime/praktike/ etj. - PO. Ka lëndë nga të cilat jam shumë i kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies. - Pjesërisht. Ka lëndë studimi në të cilat mendoj se ka vënd për përmirësime në drejtim të mësimdhënies. - JO. Ka lëndë nga të cilat nuk jam i kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies .	96% Makroekonomi Kontabilitet financiar, Teori dhe politika monetare, Tregu dhe insti financiare, Operacione bankare, Ligje biznesi, Hyrje ne ekonomi, Mikroekonomi	0%	0%	4 %
7	Çfarë mendoni për ngarkesën mësimore gjatë kohës së studimeve? a. Ngarkesa mësimore është e arsyeshme b. Ka lëndë ku e gjykoj të arsyeshme të zhvillohen në më shumë orë mësimore, c. Ka lëndë të cilat mund të zhvillohen në më pak orë mësimore d. Nuk e di	92 % 4% 4 % 0 %			
8	Si e gjykoni ngarkesën e studentit: raportin midis kohës së të ndjekurit të orëve mësimore me kohën e punës së pavarur në shtëpi ? a. Të arsyeshëm b. Duhet zhvilluar më shumë orë teorike c. Duhet zhvilluar më shumë orë praktike d. Tjetër (ju lutemi specifikoni)_____	62.5 % 0% 37.5 %			

		0 %			
9	Çfarë mendimi keni lidhur me cilësinë e mësimdhënies? a. Ka lëndë në të cilat mësimdhënia është shumë cilësore si psh: b. Ka lëndë në të cilat cilësia e mësimdhënies lë për të dëshiruar si p.sh., c. Nuk e di	a. Tregjet financiare, Kontabilitet, Hyrje ne Kontabilitet, Hyrje ne ligje, Teori dhe politike monetare, Institucioni dhe tregu financiar, Shërbimet dhe operacionet bankare, Makroekonomi, ligje biznesi, Menaxhim dhe organizim, Makroekonomi, Statistikë, b. Kontabilitet financiar, Mikroekonomi, statistikë			
10	Si e vlerësoni ju nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste, leksione, etj.)? a. Shumë të mirë b. Mesatar c. Të dobët d. Shumë të dobët	100 % 0 % 0 % 0 %			
11	A përdoren teknologjitë bashkëkohore (kompjuter, mjete audiovizive, etj) gjatë procesit të mësimdhënies Po, në shumicën e rasteve Pjesërisht, vetëm në disa prej tyre Jo, në asnjërin prej lëndëve të zhvilluara	100 %	0 %	0 %	
12	Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja? a. Format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme b. Mendoj se mund te aplikohen forma të reja, më efektive për kontrollin e njohurive c. Tjetër	96 % 4 % 0 %			
13	A i përmbahen testimet dhe provimet programit të zhvilluar të lëndës?	100%			
14	Vlerësimi i lëndëve është? a. Vlerësim i shtrirë dhe i plotë gjithëvjetor, b. Vlerësim që përqëndrohet vetëm tek provimi përfundimtar c. Tjetër	100 % 0 % 0 %			
15	A mendoni se është e drejtë kjo mënyrë vlerësimi (shif përgjigjen e pyetjes 14)? Nëse JO, shpjegoni arsyen _____	100%	0 %	0 %	
16	A tregohen të drejtë/objektivë pedagogët në vlerësimin tuaj?	100 %	0 %	0 %	

17	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 16 është “Jo”, ju lutem të shpjegoni arsyen e mungesës së objektivitetit në vlerësimin tuaj, mundësisht me shembuj konkret (lënda dhe emri i pedagogut që ju ka vlerësuar)?	-			
18	A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuar me komente që ju ndihmojnë?	100%	0%	0%	
19	A ju ndihmojnë pedagogët tuaj edhe jashtë orëve të mësimi?	100%			
20	A ka pedagogë apo persona nga stafi ndihmës të cilët kërkojnë vlera materiale apo financiare për të vlerësuar pozitivisht përgjigjet tuaja në provime?	0 %	100 %	0 %	
21	A ka caktuar institucioni një pedagog përgjegjës/mentor me të cilin këshilloheni për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasni gjatë periudhës së studimit tuaj?	100%	0 %	0 %	
Për fasilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera					
22	Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit? a. Më ndihmojnë shumë b. Shumë të vështira për të marrë ndihmën e nevojshme c. Indiferente d. Tjetër (ju lutemi specifikoni) _____	100% 0% 0% 0%			
23	A shfrytëzoni literaturë profesionale?	100 %	0 %	0 %	
24	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 23 është “Jo”, cilat janë arsyet? a. Nuk njihni mirë një gjuhë të huaj b. Pedagogët nuk ju rekomandojnë përdorim të literaturës shtesë c. Nuk e ndjeni të nevojshëm përdorimin e literaturës së huaj d. Biblioteka e IAL nuk është e pasur e. Tjetër	-			
25	A jeni i/e kënaqur me kushtet që ju ofron IAL ku ju studjoni: a. Cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve? b. Cilësinë e laboratorëve, pajisjen e tyre me aparatura, materiale pune, etj? c. Me sallat e studimit ku ju mund të studjoni gjatë kohës suaj të lirë? d. Cilësinë e sallave të bibliotekës dhe me sasinë e titujve që ajo disponon?	100 % 100 % 92 % 92 %	0 % 0 % 4 % 4 %	0 % 0 % 4 % 4 %	
26	A e shfrytëzoni bibliotekën e IAL si një burim të rëndësishëm informacioni?	67 %	0%	0 %	33%
27	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 26 është “jo”, cila është arsyeja? a. Nuk jeni i/e interesuar b. Biblioteka nuk është e pasur me letërsi teknike c. Shërbimi në bibliotekë nuk është cilësor	-			

	d. Tjetër(nuk e di)	
--	---------------------	--

Komente

- *Komente pozitive*
 1. Stafi akademik i kualifikuar
 2. Metoda dhe teknologji të mira të mësimdhënies.
 3. Literatura shumë e mirë
 4. U pëlqen ndihma personale si konsultimet sa herë që studentët dëshirojnë nga stafi akademik.
- *Sugjerime për përmirësim*
 1. Të vazhdohet të punësohen pedagog të kualifikuar
 2. Notat e provimeve të mos jepen me vonesë
 3. Çmimet e kantinës janë të larta
 4. Të ndërtohen ambiente sportive

Mostra 19 student

Viti i II 10 student

Viti i III 9 student

Pyetja		PO	JO	Nuk e di	Tjeter
Për programin e studimit					
1	Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e drejtimit tuaj të studimit? h. Interesimi personal në drejtimin e studimit të zgjedhur i. Influenca e prindërve/miqve/mësuesve j. Lehtësia për t'u pranuar k. Lehtësia për të marrë shkollën e lartë l. Mundësia e marrjes së një burse për studimet m. Lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve të larta n. Tjetër	63% 0 % 5 % 0 % 0 % 0 % 32 % 0%			
2	Cili ishte faktori përcaktues në zgjedhjen e shkollës suaj ? g. Interesimi personal h. Influenca e prindërve/miqve/mësuesve i. Lehtësia për t'u pranuar j. Lehtësia për të marrë shkollën e lartë k. Lehtësia për të gjetur punë mbas përfundimit të studimeve të larta l. Tjetër (ju lutemi specifikoni)	68% 11% 5 % 16% 0%			
3	Për çdo lëndë që ju studjoni, pedagogu përgjegjës ju prezanton në fillim qëllimin dhe objektivat e programit të lëndës, format e realizimit të tij (leksione, seminare, pune praktike laboratorike, etj.) materialet me të cilat do të studjoni, etj. A bëhen prezantime të tilla të rregullta për çdo lëndë që ju studjoni?	90 %	5 %	5 %	
4	A janë qëllimet dhe objektivat e lëndëve që keni studjuar deri tani në përputhje me qëllimet dhe objektivat e drejtimit të studimit të	95 %	0 %	0 %	5 %

	zgjedhur nga ju?				
5	A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë viteve të studimit dhe në dy semestrat e një viti akademik? d. PO, mendoj se numri dhe shpërndarja e lëndëve është e arsyeshme e. JO, sepse ka semstra kur jemi shumë të ngarkuar dhe të tjerë shumë më të lirë në ngarkesë mësimore f. Tjetër, (ju lutemi specifikoni)_____	84%	16%	0%	0%
Mësimdhënia					
6	A jeni të kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies si leksione/seminare/ushtrime/praktike/ etj. - PO. Ka lëndë nga të cilat jam shumë i kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies. - Pjesërisht. Ka lëndë studimi në të cilat mendoj se ka vënd për përmirësime në drejtim të mësimdhënies. - JO. Ka lëndë nga të cilat nuk jam i kënaqur me organizimin dhe format e mësimdhënies .	90% Kontabilitet i Financiar, Statistika, ligje biznesi, Menaxhim, Anglisht Biznesi, Marketing, Menaxhimi i burimeve njerezore	5%	0%	5%
7	Çfarë mendoni për ngarkesën mësimore gjatë kohës së studimeve? e. Ngarkesa mësimore është e arsyeshme f. Ka lëndë ku e gjykoj të arsyeshme të zhvillohen në më shumë orë mësimore, g. Ka lëndë të cilat mund të zhvillohen në më pak orë mësimore h. Nuk e di	74 % 16% 5 % 5 %			
8	Si e gjykoni ngarkesën e studentit: raportin midis kohës së të ndjekurit të orëve mësimore me kohën e punës së pavarur në shtëpi ? e. Të arsyeshëm f. Duhet zhvilluar më shumë orë teorike g. Duhet zhvilluar më shumë orë praktike h. Tjetër (ju lutemi specifikoni)_____	58 % 5% 37 % 0 %			
9	Çfarë mendimi keni lidhur me cilësinë e mësimdhënies? d. Ka lëndë në të cilat mësimdhënia është shumë cilësore si psh: e. Ka lëndë në të cilat cilësia e mësimdhënies lë për të dëshiruar si p.sh., f. Nuk e di	a. Kontabilitet, Ligji i biznesit, Statistikë, Kontabilitet financiar, Menaxhim, Ekonomi, Marketing, Sjellje konsumatore, Menaxhim i			

		burimeve njerezore			
		b. Sociologji, Shkenca të sjelles, Ligje biznesi			
10	Si e vlerësoni ju nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste, leksione, etj.)? e. Shumë të mirë f. Mesatar g. Të dobët h. Shumë të dobët	53 % 47 % 0 % 0 %			
11	A përdoren teknologjitë bashkëkohore (kompjuter, mjete audiovizive, etj) gjatë procesit të mësimdhënies Po , në shumicën e rasteve Pjesërisht , vetëm në disa prej tyre Jo , në asnjërin prej lëndëve të zhvilluara	100 %	0 %	0 %	
12	Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja? d. Format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme e. Mendoj se mund të aplikohen forma të reja, më efektive për kontrollin e njohurive f. Tjetër	95 % 5 % 0 %			
13	A i përmbahen testimet dhe provimet programit të zhvilluar të lëndës?	100%			
14	Vlerësimi i lëndëve është? d. Vlerësim i shtrirë dhe i plotë gjithëvjetor, e. Vlerësim që përqëndrohet vetëm tek provimi përfundimtar f. Tjetër	100 % 0 % 0 %			
15	A mendoni se është e drejtë kjo mënyrë vlerësimi (shif përgjigjen e pyetjes 14)? Nëse JO , shpjegoni arsyen _____	90%	10% Janë shumë të ngarkuar me provime dhe kuice	0 %	
16	A tregohen të drejtë/objektivë pedagogët në vlerësimin tuaj?	90%	0 %	10 %	
17	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 16 është “Jo” , ju lutem të	-			

	shpjegoni arsyen e mungesës së objektivitetit në vlerësimin tuaj, mundësisht me shembuj konkret (lënda dhe emri i pedagogut që ju ka vlerësuar)?				
18	A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuara me komente që ju ndihmojnë?	85%	10%	5%	
19	A ju ndihmojnë pedagogët tuaj edhe jashtë orëve të mësimi?	95%	5%		
20	A ka pedagogë apo persona nga stafi ndihmës të cilët kërkojnë vlera materiale apo financiare për të vlerësuar pozitivisht përgjigjet tuaja në provime?	0 %	100 %	0 %	
21	A ka caktuar institucioni një pedagog përgjegjës/mentor me të cilin këshilloheni për hapat e ndryshëm dhe vështirësitë që hasni gjatë periudhës së studimit tuaj?	90%	10 %	0 %	
Për fasilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera					
22	Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit? e. Më ndihmojnë shumë f. Shumë të vështira për të marrë ndihmën e nevojshme g. Indiferente h. Tjetër (ju lutemi specifikoni)	95% 5% 0% 0%			
23	A shfrytëzoni literaturë profesionale?	100 %	0 %	0 %	
24	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 23 është “Jo”, cilat janë arsyet? f. Nuk njihni mirë një gjuhë të huaj g. Pedagogët nuk ju rekomandojnë përdorim të literaturës shtesë h. Nuk e ndjeni të nevojshëm përdorimin e literaturës së huaj i. Biblioteka e IAL nuk është e pasur j. Tjetër	-			
25	A jeni i/e kënaqur me kushtet që ju ofron IAL ku ju studjoni: e. Cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve? f. Cilësinë e laboratorëve, pajisjen e tyre me aparatura, materiale pune, etj? g. Me sallat e studimit ku ju mund të studjoni gjatë kohës suaj të lirë? h. Cilësinë e sallave të bibliotekës dhe me sasinë e titujve që ajo disponon?	90 % 95 % 85 % 85 %	0 % 0 % 0 % 5 %		10% 5 % 15 % 10 %
26	A e shfrytëzoni bibliotekën e IAL si një burim të rëndësishëm informacioni?	69 %	5%	0 %	26%
27	Nëse përgjigja juaj për pyetjen numër 26 është “jo”, cila është arsyeja? e. Nuk jeni i/e interesuar f. Biblioteka nuk është e pasur me letërsi teknike g. Shërbimi në bibliotekë nuk është cilësor h. Tjetër(nuk e di)	a. b. 100 % c. d.			

--	--	--

Komente

- *Komente pozitive*
 5. Universitet shumë i mire, me kushte moderne
 6. Staf i akademik i kualifikuar dhe i gatshëm të ndihmojë studentët
 7. Mundësi shumë të mira që me mbarimin e universitetit të punësohen në firma turke në shqipëri dhe jashtë.
- *Sugjerime për përmirësim*
 1. Me shumë kohë ndërmjet 2 provimeve
 2. Të lidhen marrëveshje dhe me universitete perendimore dhe jo vetem lindore

ANEKS 2

REZULTATET E PYETSOREVE PËR STUDENTET (... STUDENTE TE ANKETUAR)